
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti IV (XVIII) - Nr. 16 (169) ISSN: 2305-655X

SHKËNCIA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

16

2016

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI IV (XVIII) 2016, NR. 16 (169)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2016

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI IV (XVIII), korrik, gusht, shtator 2016 nr. 16 (169)

Nën kujdesin e kryetarit të KMSH-së: H. Skender Bruçaj

Drejtore: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Ali Zaimi
Prof. dr. Ayhan Tekinesh
Prof. dr. Ferdinand Gjana
Prof. dr. Hajri Shehu
Prof. dr. Njazi Kazazi
Prof. dr. Qazim Qazimi
Prof. dr. Rahim Ombashi
Dr. Brikena Smajli
Dr. Fahredin Ebibi

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame
Tefsir
Hadith
Fikh
Sociologji
Filozofi
Gjuhësi
Letërsi
Psikologji
Histori
Kulturë
Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Xhamia e Pazarit, Krujë

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. "George W. Bush", Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al
www.zanimalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Sëmundjet e shpirtit dhe trajtimi i tyre sipas Gazalit
- **Dr. Milud Hamidat, Universiteti Laghouat - Algjeri**5

Studime

2. Regjistrimet më të hershme në folklorin muzikor shqiptar (ca. 1650)
- **Prof. dr. Bardhyl Demiraj, Gjermani**16
3. Fjalë e zbritun, Gjuhë e nâltsueme
- **Fatos A. Kopliku MS/MA, Washington, SHBA**30

Jurisprudencë Islame

4. Një vështrim në familjen ligjore islame. Aspekte juridiko – penale të mbrojtjes të së drejtës së pronës
- **Prof. asoc. doc. dr. Engjëll Likmeta, Qemal Likmeta**45

Pedagogji

5. Idetë pedagogjike në krijimtarinë letrare dhe veprimtarinë aplikative të Mehmet Akif Ersojit
- **Prof. dr. Musa Kraja**65

Letërsi

6. Aspekti fetar (me theks islam) në poezi. Poezia një rrugë drejt shpirtit.
- **Msc. Entela Hidri,**72

Histori

7. Kontributi i Piri Reis-it dhe Evlija Çelebi-ut në zhvillimin e shkencës së gjeografisë
- **Msc. Artan S. Mehmeti**78

Personalitete

8. Profilet e Islam Dizdarit si pedagog, studiues dhe qytetar shembullor
- Prof. dr. Vehbi Hoti, Prof. dr. Njazi Kazazi85

Retrospektivë

9. Zoti dhe Evoluzioni95
10. Abstracts in English99
11. Rregullat e shkrimit104



Sëmundjet e shpirtit dhe trajtimi i tyre sipas Gazalit

Dr. Milud Hamidat

Departamenti i Psikologjisë dhe Shkencave të Edukimit
Universiteti Laghouat - Algjeri

Abstrakt

Ndër shkaqet themeltare të sëmundjeve shpirtërore, ose sëmundjeve të zemrës siç i quan Gazali, është konflikti mes forcave të së mirës dhe forcave të së keqes, mes arsyes dhe mes instinktit, mes nevojës për kënaqësi dhe kërkimit të saj. Paralelisht me këtë, është dhe ndjesia e fajit në çastin kur u bindesh kërkesave të trupit dhe kur shkel urdhrat e arsyes. Që këtu lind stresi, tensioni, zemërat, agresiviteti, frika dhe hakmarrja. Sjelljet pësojnë çrregullim me t'u shfaqur emocionet e mësipërme. Me përsëritjen e tyre, ato shndërrohen në ves dhe zakon, të cilat e shtojnë në sjellje të tjera e që kanë ndikim akoma më të thellë në shpirtin e njeriut.

Filozofët myslimanë i kanë kushtuar vëmendjen e duhur shpirtit dhe sëmundjeve të tij. Ata u shquan për diagnostikimin dhe trajtimin e këtyre sëmundjeve. Një ndër personalitetet që është shquar për metodologjinë e tij në këtë fushë është dhe Ebu Hamid Gazali, mendimet e të cilit dallojnë nga mendimet e filozofëve grekë, por edhe të filozofëve të tjerë myslimanë.

Dallimi mes Gazalit dhe filozofëve të tjerë, është se ai i merr bazat e filozofisë së tij nga Islami, duke shtuar përvojën e tij personale me sufizmin. Vlen të theksohet se sufizmi ka lidhje të ngushta me psikologjinë, dijen e shpirtit dhe Gazali është një nga hulumtuesit dhe studiuesit e shpirtit. Sufizmi përmban një lëndë të vyer lidhur me shpirtin, e cila josh çdo studiues në këtë fushë. Përvoja personale e

Gazalit pati ndikimin më të thellë në shkrimet e tija mbi psikologjinë e njeriut, analizën e sëmundjeve, perceptimin e drejtë të motiveve dhe reagimeve, njohjen e emocioneve dhe devijimeve dhe, për rrjedhojë, diagnostikimin dhe trajtimin e duhur.

Prandaj vendosëm që në këtë artikull, të ndjekim analizën e Gazalit lidhur me disa tematika të shpirtit, si natyrën e emocioneve dhe kontrollin e tyre, sëmundjet e zemrës, shkaqet dhe mënyrën e trajtimit. E gjitha kjo, në kuadrin e krahasimit me teoritë moderne, duke nxjerrë në pah metodën e Gazalit në analizë, metodë që është e përafërt me metodat moderne, sidomos në pikënisjen e njohjes së vetes me anë të reflektimit dhe meditimit, si dhe falë vëzhgimit dhe eksperimentimit. E gjitha kjo, bazohet në rastet e treguara nga vetë Gazali dhe përvoja e tij personale.

Besojmë se nga e gjithë trashëgimia e pasur që ka lënë pas Gazali, do të sjellim sadopak nga metodologjia e tij në trajtimin e sëmundjeve të shpirtit, me të cilën ai u ka paraprirë shumë prej teorive moderne.

Thelbi i sëmundjeve të shpirtit

Ebu Hamid el-Gazali (1056 – 1111) është nga mendimtarët më të shquar myslimanë, të cilët i kanë kushtuar një vëmendje të madhe shpirtit të njeriut. Ai u ndal te shumë mekanizma që e kontrollojnë atë,

diagnostikoi shumë sëmundje dhe patologji dhe u përpoq të ofrojë trajtimin e duhur për to.

Nuk gabojmë aspak nëse themi që te Gazali gjejmë konturet e para të teorisë së psikoanalizës, teori të cilën ai e bazon tek Islami. Ne do i qasemi veçorive më karakteristike të teorisë së Gazalit rreth shpirtit, instinktit dhe emocioneve dhe ndikimit të tyre në aktivitetin e shpirtit, sëmundjeve të shpirtit, shkaqeve dhe mënyrës së trajtimit. Kjo do të na ofrojë një imazh të plotë të ideve pararendëse të Gazalit.

Gazali flet për sëmundjet e shpirtit, të cilat i emërton si sëmundje të zemrës. Në arabisht, zemra dhe shpirti vijnë me të njëjtin kuptim ndonjëherë. Këto sëmundje lindin kur prishet ekuilibri mes përbërësve të shpirtit të njeriut, kur njëri element dominon mbi të tjerët nga njëra anë, si dhe nga paaftësia e arsyes për të ruajtur kontrollin nga ana tjetër. Kjo çon në raste devijimi të sjelljes dhe bindje të verbër ndaj epsheve, të cilat e marrin në kontroll të plotë jetën e njeriut dhe janë ato që e orientojnë.

Gazali ka folur për sëmundjet e shpirtit, të cilat nuk janë shtjelluar sot në psikologjinë moderne, por edhe nëse është folur, nuk janë përcaktuar saktësisht, ose nuk janë konsideruar aq emergjente saqë të kërkojnë trajtim. Prandaj ai konsiderohet si prijatar në këtë fushë, pasi përveçse u është qasur këtyre sëmundjeve, ka vendosur dhe mënyrën e trajtimit. Edhe pse Gazali ka përfituar shumë

nga feja në eksplorimin e këtyre sëmundjeve, atij i mbetet merita e aftësisë së diagnostikimit, emërimit, përshkrimit, diagnostikimit dhe eksplorimit të shkaqeve të këtyre sëmundjeve, por edhe ofrimit të recetës për trajtimin e tyre. Atij i takon merita e zbulimit të metodës së eksplorimit të këtyre sëmundjeve, nga të cilat mund të përmendim: “Mendjemadhësinë, vetëpëlqimin, smirën, gënjeshtërinë, koprracinë, dyfaqësinë etj...”

Shkaqet e sëmundjeve shpirtërore

Ndër shkaqet themeltare të sëmundjeve shpirtërore, ose sëmundjeve të zemrës siç i quan Gazali, është konflikti mes forcave të së mirës dhe forcave të së keqes, mes arsyes dhe mes instinktit, mes nevojës për kënaqësi dhe kërkimit të saj. Paralelisht me këtë, është dhe ndjesia e fajit në çastin kur u bindesh kërkesave të trupit dhe kur shkel urdhrat e arsyes. Që këtu lind stresi, tensioni, zemëratat, agresiviteti, frika dhe hakmarrja. Sjelljet pësojnë çrregullim me t'u shfaqur emocionet e mësipërme. Me përsëritjen e tyre, ato shndërrohen në ves dhe zakon, të cilat e shtojnë në sjellje të tjera e që kanë ndikim akoma më të thellë në shpirtin e njeriut.

Imam Gazali mendon se shkak i përhapjes së sëmundjes së zemrave më shumë se sëmundjet e trupit, janë tre gjëra:

E para, mosdija e të sëmurit se është i sëmurë.

E dyta, kur sindromat dhe pasojat e sëmundjes nuk janë të prekshme dhe të shkueshme, siç ndodh me sindromat e sëmundjeve fizike, të cilat kanë si përfundim vdekjen që shihet dhe konstatohet.

E treta, mungesa e doktorit. Në këtë rast, doktori është dijetari, i cili edhe vetë mund të jetë i sëmurë.

Emocioni i zemërimit dhe trajtimi i tij

Analiza e shpirtit dhe trajtimi i sëmundjeve të tij, për të cilat flet imam Gazali, është diçka e thellë. Ai thotë se para se të japim recetën e trajtimit, duhen njohur shkaqet që çuan te këto sëmundje. Vetëm pas kësaj bëhet ballafaqimi me simptomave dhe të kundërtave të tyre. “Kam kuptuar se trajtimi i çdo sëmundjeje bëhet duke përcaktuar prerazi burimin e saj dhe pastaj luftimin e shkaqeve”, thotë Gazali.

Për shembull, lidhur me zemërimin, imam Gazali bën një përshkrim të detajuar, i cili nuk është më pak se analiza e shkollës fiziologjike. Në analizën që bën ai sqaron raportin e ngushtë mes trupit dhe shpirtit në aktivizimin e emocioneve, duke theksuar se trupi është pasqyra dhe imazhi i ndryshimeve të brendshme. Ai thotë: “Ndër shenjat e jashtme të zemëratës është ndryshimi i ngjyrës, dridhjet e forta të gjymtyrëve periferike,

sjellje të pakontrolluara, çrregullimi i lëvizjes, shkumëzimi i gojës, fryrje e damarëve të qafës, shpërfytyrimi i mimikës, fryrje e vrimave të hundë. Nëse personi që është pushtuar nga zemërimi do të mund ta shihte çfarë pamje të shëmtuar ka marrë, do i qetësohej vala e zemëratës në vend nga turpi. Megjithatë, shëmtia e brendshme është më e madhe se ajo e jashtme, pasi aparenca është titulli i të brendshmes. Është shëmtuar e brendshme fillimisht, gjë e cila pasqyrohet dhe përhapet edhe në shëmtinë e imazhit të jashtëm. Kështu, ndryshimet fizike të jashtme, janë fryt i ndryshimeve të brendshme. Prandaj, për të kuptuar se çfarë ngjet në shpirtin e njeriut, vrojto ndryshimet e tij të jashtme. Ky ishte ndikimi që ushtronte në trup.”

Pas këtij përkrahimi kaq të saktë dhe të detajuar të reagimit fizik dhe marrëdhënieve mes tij dhe zhvillimeve të brendshme, Gazzali vazhdon të analizojë rezultatet e valës së zemëratës që shoqërojnë personin e zemëruar dhe deri në ç’nivel të çrregullimit në sjellje mund ta çojë. Ai thotë: “Kjo ushtron ndikimin e saj në gjuhë, e cila shpërthen në sharje dhe fjalë banale, prej të cilave i vjen turp një njeriu me arsye të shëndoshë, madje i vjen turp vetë personit pasi të jetë qetësuar. Ai nuk di çfarë flet dhe si e shpreh. Ndikimi i zemëratës te gjymtyrët, gjë e cila shfaqet tek agresiviteti

fizik, kacafytja, shqyerja e rrobave, plagosja dhe vrasja, pa e bërë qejfin qeder. E nëse personi prej të cilit është zemëruar, arrin t’ia mbathë, ose për shkak se nuk e shkarkon dot mbi të zemërimin, shkarkimi bëhet ndaj vetë vetes, duke shqyer rrobat dhe duke ndëshkuar veten. Ai mund të qëllojë tokën me pëllëmbë, rend si i marrë dhe i dehur, mund të përplaset përtokë pa ndjenja dhe pa mundur të ngrihet. E gjitha kjo për shkak të intensitetit të valës së zemëratës. Ai mund të qëllojë sendet dhe kafshët, duke ua shkarkuar atyre tensionin, mund të hedhë enët përtokë, të thyejë tavolinën... Ai mund të sillet si i marrë, duke u folur dhe sharë kafshët dhe sendet, sikur t’i fliste një qenie racionale. E nëse e shqelmon kafsha, ai ia kthen me një duzinë shqelmash. Sakaq, ndikimi i zemëratës në zemrën e tij, është urrejtja, smira dhe zilia ndaj personit me të cilin është zemëruar. Ai fsheh mllef të madh në zemër kundër tij, i bëhet qejfi kur vuan dhe ndjen neveri kur gëzohet, tallet, shkel nderin e tij etj... Të gjitha këto ishin tregues të një zemërate të ekzagjeruar.”

Pas këtij përkrahimi shkencor të detajuar, i cili tregon deri në çfarë ekstremi agresiviteti dhe dhune ndaj vetes dhe të tjerëve mund të arrijë emocioni i zemëratës, vjen radha e zgjidhjes dhe trajtimit, me qëllim që njeriu të mund ta kontrollojë veten në rast shpërthimi të këtij emocioni. Fillimisht, Gazzali mendon

që njeriu duhet të bëjë çmos që të ruajë të mesmen e artë dhe ekuilibrin në shprehjen e emocioneve të brendshme. Lidhur me zemëratën, ekuilibrin dhe e mesmja mbetet gjëja më e mirë. Kështu, nëse vala e zemëratës e ftoh njeriun, e mpin dhe e bën të gatshëm për të pranuar nënshtrimin dhe poshtërimin, ia heq çdo formë burrërie dhe qëndrese, ai duhet të trajtohet dhe të merret me veten derisa të fuqizohet. Me këtë nënkuptojmë që të ruajë dinjitetin dhe respektin. Trajtimi lipset edhe nëse zemëratat është në ekstremin tjetër, saqë e bën të shkelë të gjithë kufijtë. Njeriu duhet të ruajë kufijtë e të mesmes dhe ta ftojë veten.”

Në rastet e zemëratës së madhe, imam Gazali ofron recetën e tij, e cila fokusohet te parandalimi i krizës, duke iu shmangur zemëratës dhe shkaqeve të saj dhe kjo me edukimin e shpirtit që të maturohet, të bëjë durim dhe të ushtrohet me urtësinë. Por edhe kur aktivizohen shkaqet e zemëratës, Gazali fton për maturi dhe rezistencë, me qëllim që njeriu të mos bëjë gjëra të pamenduara dhe të dënueshme. Aktivizimi i zemërimit trajtohet me përzierjen e dijes dhe punëve të mira.

E gjitha kjo është e ngjashme me terapinë bashkëkohore, atë konjitive emocionale.

Lidhur me dijen, ajo bazohet te gjashtë gjëra:

1. Të meditojë rreth sevapit të frenimit dhe kontrollit të vetes, faljes,

maturisë dhe durimit, gjë e cila do ia shtojë dëshirën për shpërblimin.

2. Ta frikësojë veten nga ndëshkimi i Zotit nëse i bie në qafë dikujt. Nëse ai është më i fuqishëm se kundërshtari, duhet ta dijë se Zoti është më i fuqishëm se ai.

3. T'i kujtojë vetes pasojat e zemërimit në këtë botë.

4. Të sjellë ndërmend shëmtinë e imazhit të vet kur zemërohet, duke kujtuar imazhin dhe mimikën e personave të tjerë kur zemërohen. Ta përngjasojë personin e zemëruar me një egërsirë.

5. Të meditojë rreth shkaqeve dhe faktorëve që e zemërojnë dhe e nxisin të hakmerret.

6. Të kujtojë se zemërimi i Zotit mbi të do të jetë më i madh se zemërimi i tij. Kështu, vullneti i Zotit triumfon ndaj vullnetit të vetes.

Sakaq, lidhur me punën dhe të vepruarit:

Të kërkojë mbrojtje te Zoti nga shejtani i mallkuar, të kërkojë falje nga Zoti (istigfar) dhe të lutet.

Nëse është në këmbë, të ulet, e nëse është i ulur, të shtrihet.

Të marrë abdes ose të lahet për ta shuar zjarrin e zemërimit.

Nga e gjitha kjo, konkludojmë se imam Gazali e bazon terapinë e tij psikologjike mbi dy pika:

E para, është diçka teorike, ose “dija” siç e quan ai.

E dyta, është praktike.

Kjo që thotë Gazali nuk ndryshon fort nga tezat dhe teoritë

bashkëkohore të terapisë konjitive, e cila bazohet te ndërjegjësimi dhe njohja e sëmundjes, vendosmëria për t'u trajtuar dhe kuruar dhe pastaj vjen ndërhyrja praktike dhe pjellore si plotësuese e terapisë, që konkretizohet me punën vetjake për t'u shëruar.

Kështu, shohim që Gazali i ka paraprirë terapisë konjitive bihejviorale. Kjo terapi mund të praktikohet në mënyrë vetjake dhe me përpjekje individuale, të cilat i bën vetë personi. Ose mund të kërkohet ndihma e një eksperti dhe orientuesi, i cili i njeh sëmundjet e zemrës, ose të shpirtit, siç ka qejf t'i emërtojë Gazali.

Metodat e trajtimit të sëmundjeve të shpirtit sipas Gazalit

1. Rituale ose adhurimet

Adhurimet në Islam nuk janë rituale të mbushura me simbolika të pakuptueshme. Ato nuk bëhen as për qëllime materiale të kësaj bote. Në fakt, ato janë rituale që kanë një lidhje të ngushtë me shëndetin mendor dhe fizik të individit nga njëra anë, por edhe me stabilitetin moral, social dhe vleror të komunitetit. Që këtu, imam Gazali dhe filozofët e tjerë myslimanë, e kuptuan funksionin dhe rolin e madh të këtyre ritualeve në trajtimin e shumë problemeve dhe devijimeve të individit dhe shoqërisë. Le të shohim qetësinë dhe paqen e brendshme që të fal namazi. Kësaj,

shtoji higjienën e trupit. Agjërimi garanton shëndetin e fizikut, zekati rrit përkrahjen dhe solidaritetin social mes komunitetit. Falë mbështetjes sociale që garantojnë këto rituale dhe thelbit që përmbajnë praktikën e përditshme mes individëve, shkohet drejt një shoqërie të virtytshme e të drejtë, ku reduktohen në minimum dobësitë. Edukimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet edukimit të individit. Kushdo që i studion vargjet e Kur'anit dhe thëniet e Profetit a.s, e konstaton lehtësisht këtë. Zoti thotë në Kur'an: **“Fale namazin, pasi namazi ndalon nga veprat e liga dhe të shëmtuara...”** **“Merr nga pasuritë e tyre sadaka, e cila i pastron dhe dëlirëson.”**

Profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Kush nuk heq dorë nga dëshmia rrejshëm dhe veprat sipas saj, Zoti nuk ka nevojë që të heqë dorë nga ushqimi dhe pirja (gjatë ramazanit).”

Nëse ndjekim modelin që ofron Gazali për adhurimet dhe ritualet, kuptojmë analizën e detajuar të shpirtit që ai bën, si dhe këndvështrimin e tij ndaj adhurimit, si baza dhe themeli për raportet me Zotin. Vetëm kështu shpirti arrin ekuilibrin, qetësinë dhe harmoninë. Imam Gazali mendon se shpirti i namazit është në prezencën e zemrës. E nëse zemra nuk është prezente, ndërkohë që gjuha lexon në mënyrë automatike, nuk arrihet plotësia e namazit, i cili është legjitimuar për kalitjen e zemrës, rifreskimin e

përmendjes së Zotit dhe rrënjosjen e besimit.

Duke e njohur natyrën njerëzore, imam Gazali mendon se përhumbja e plotë është e pamundur, pasi njeriu nuk mund të shkëputet totalisht nga impenjimet e kësaj bote dhe nga instinktet. Prandaj dhe ai bën çmos që të njihet me çdo qoshe të shpirtit të njeriut, pasi kështu përcakton shkaqet që e mbajnë peng larg përhumbjes, duke iu përmbajtur metodës shkencore. Në të njëjtën kohë, ai na ofron dhe ilaçin dhe mënyrën e përdorimit të këtij ilaçi në shpërqendrimin e mendjes sonë. Këtu shfaqet gjenialiteti i Gazalit, në analizimin e shpirtit, kur thotë: “Shkaku i vërsimit të mendimeve është ndonjë ngacmues i jashtëm ose i brendshëm. Ngacmuesit e jashtëm mund të vijnë nëpërmjet dëgjimit ose shikimit, gjë e cila e tërheq vëmendjen e që jepet pas ngacmimit fillestar. Kështu, mendimet ndjekin njëri-tjetrin në një zinxhir të gjatë. Shikimi bëhet shkak për të menduar dhe mendimet bëhen shkak të njëri-tjetrit. Ai që ka nijet të fortë dhe vullnet të palëkundur, nuk i ndjen ngacmuesit e jashtëm të shqisave. Por për një të dobët, sigurisht që këta ngacmues ia shpërqendrojnë vëmendjen.”

Në këtë analizë dhe përshkrim Gazali përcakton natyrën e faktorëve të brendshëm dhe konkretë, të cilët ndikojnë në vëmendjen e personit që po falet dhe që e largojnë nga

përhumbja. Ai nuk mjaftohet me prezantimin e ngacmuesve të ndryshëm, por ofron edhe zgjidhjet.

“Zgjidhja për të mos rënë pre e këtyre ngacmuesve është ulja e shikimit, ose kryerja e ritualit të faljes në një vend të errët, duke eliminuar ngacmuesit vizualë. Mund të afrohet edhe pranë një muri, me qëllim që ta ngushtojë në maksimum hapësirën për shikim. Ai duhet të shmangë namazin në rrugë, apo në vendet ku rrethohet nga stoli e sixhade të bukura. Por, shkaqet dhe ngacmuesit e brendshëm mbeten më të fuqishëm. Për të triumfuar ndaj tyre, ai duhet të parapërgatitet para se të fillojë namazin, duhet t’ia rifreskojë vetes kujtimin e botës tjetër, nevojën që ka për Zotin, qëndrimin para Zotit në ahiret, faktin që Zoti e sheh dhe e ndjek në çdo lëvizje. Ai duhet ta boshatisë zemrën nga çdo mendim dhe angazhim tjetër para se të fillojë namazin, duke mos lejuar asgjë që t’ia tërheqë vëmendjen.”

Siç vihet re, ai propozon zgjidhje të cilat na ndihmojnë që të mos prekemi nga ngacmuesit e jashtëm, si dhe flet për çlirimin e shpirtit nga ngacmuesit e brendshëm, gjë e cila na ndihmon pastaj për ta mbajtur zemrën të lidhur me namazin. Në analizën e tij vihet re qartësisht perceptimi i drejtë lidhur me faktorët e ndryshëm të cilët ushtrojnë ndikimin e tyre në shpirtin e njeriut.

2. Ekuilibri dhe balanca

Imam Gazali dhe filozofë të tjerë myslimanë, si Ibnu Sina dhe të tjerë, e kishin parasysh rëndësinë e ekuilibrit në jetë. Imam Gazali thoshte: “Ruajtja e ekuilibrit në morale dhe virtyte është shëndet i shpirtit, kurse tendenca për ta prishur ekuilibrin, është sëmundje... Ashtu si trupi i cili nuk lind i plotë, por rritet dhe fuqizohet në mënyrë të përshkallëzuar falë kujdesit dhe ushqimit, ashtu dhe shpirti starton me mangësi dhe me prirje për t’u perfeksionuar falë edukimit, moraleve dhe dijeve.”

Imam Gazali thekson rëndësinë e parimit të ekuilibrit dhe balancës si në nivel fizik ashtu dhe në atë shpirtëror. Ashtu siç kërkon që të ruhet ekuilibri fizik, ai kërkon që të ruhet edhe ekuilibri shpirtëror mes forcave të shpirtit dhe kjo, duke e marrë arsyen si gjykatës. Njëkohësisht imam Gazali nuk beson në shtypjen dhe represionin e instinkteve dhe emocioneve, por i konsideron ato si një pjesë të domosdoshme të njeriut. Ai kërkon që ky aktivitet shpirtëror të disiplinohet.

“Nëse dikush gjendet përballë një instinkti dhe emocioni të papërballueshëm, siç është epshi apo nervozizmi, duhet ta luftojë dhe t’i rezistojë, por jo ta mbysë, pasi “mbretëria” nuk stabilizohet veçse me këto instinkte dhe emocione. Nëse arrin t’i frenosh, do të jetosh i lumtur dhe ke shlyer detyrimet ndaj

mirësive dhe begative. Përndryshe, je i vuajtur.”

Ashtu siç është i rëndësishëm ekuilibri dhe ruajtja e një vije të mesme në arritjen e shërimit dhe konfrontimin me gjendje psikologjike si frika e tepërt, demoralizimi, humbja e shpresës dhe për rrjedhojë dhe depresioni. Gazali thotë se trajtimi bëhet sipas rastit. “Ai që është mbërthyer nga frika dhe ka hequr dorë totalisht nga çdo kënaqësi e kësaj bote, duke e mbingarkuar veten me jetesë të vështirë, i thyhet imazhi i krijuar i frikës duke i folur për shpresën, me qëllim që t’i kthehet ekuilibrit dhe të mesmes. E njëjta gjë vlen për atë që është zhytur në gjynahe, por që dëshiron të pendohet dhe që nuk është penduar vetëm për shkak të gjynaheve të mëdha dhe faktit se ndjehet i demoralizuar. Kështu atij i mundësohet dhe lehtësohet pendimi.”

Këtu duket qartazi metoda e terapisë së bazuar në udhëzimin, bindjen dhe rikthimin e besimit të personit që vuan, gjë e cila e ndihmon të rivendosë ekuilibrin e tij psikologjik dhe për rrjedhojë të shërohet. Është e njëjta metodë që përdoret sot në teoritë bashkëkohore.

3. Frenimi dhe mbajtja nën kontroll e instinkteve

Gazali thekson se emocionet dhe ndjenjat janë pjesë e jetës shpirtërore. Ato nuk mund të zhbëhen totalisht,

por mund të vihen në kontroll dhe të maturohen. Ai thotë: “Disa hamendësojnë se nervozizmi mund të shuhet totalisht. Ata pretendojnë se përsosmëria synon pikërisht këtë gjë. Disa të tjerë mendojnë se ky emocion nuk mund të maturohet, me pretekstin se moralet janë si krijesat, mbi të cilat nuk mund të vihet dorë dhe të ndryshohen. Në fakt, të dy mendimet janë të gabuara dhe të pabaza. E vërteta është se, përderisa njeriu i do disa gjëra dhe i urren të tjerat, është e pamundur që ai të boshatiset nga emocion i urrejtjes dhe mllëfit. Përderisa pajtohet me diçka dhe bie ndesh me diçka tjetër, s’ka se si ta pëlqejë atë me të cilën pajtohet dhe ta urrejë atë me të cilën bie ndesh.”

Përderisa këto emocione janë pjesë e gjallë e njeriut, ai nuk ka rrugë tjetër përveçse t’i mbajë nën kontroll dhe t’i kanalizojë në rrugën e drejtë, pasi zhbërja dhe fshirja e tyre totale është e pamundur. “Ushtrimi për të arritur përsosmërinë, - vijon Gazali, - nuk shërben për të shuar urrejtjen e zemrës, po për të rritur aftësinë për të mos iu bindur emocionit të nervozizmit dhe që ta përdorë si energji për diçka të pëlqyeshme nga feja dhe nga logjika. Kjo arrihet me rezistencë, përpjekje, duke ushtruar urtësinë dhe duke duruar, derisa matura dhe urtësia të rrënjosen si virtyte. Sakaq, shuarja absolute e urrejtjes dhe pastrimi total i zemrës nga ky emocion, nuk përkon me

natyrën e njeriut, është diçka e pamundur. Por është i mundur kufizimi, vënia fre dhe dobësimi i tij.”

“Gjithashtu, nervozizmi duhet të jetë nën pushtetin e arsyes. Nuk duhet bërë gjë veçse me miratimin e saj. Nëse arrin ta bëjë këtë, ka arritur shkallën e moralit të mirë, një nga tiparet e engjëjve dhe bërthama e lumturisë.”

4. Terapia praktike te Gazali

Në dy mënyra optimale mund të realizohet edhe heqja dorë edhe përvetësimi, pra heqja dorë nga ligësitë dhe përvetësimi i virtyteve.

Terapia me heqjen dorë nga ligësitë, të cilat imam Gazali i quan “shkatërrueset – muhlikat”. Te këto ligësi ai rendit smirën, syfaqësinë, mendjemadhësinë etj...

Terapia me përvetësim të virtyteve përbën bazën e terapisë sipas Gazalit. Për virtytet ai ka shkruar kapituj të tërë në librin “Ringjallja e shkencave të fesë”, të cilët i quan si shpëtuese. Ato konsistojnë në manifestimin e durimit, dëlirësisë, të folurit drejt, amanetit etj...

Me të gjithë ai përdor metodën e këshillimit dhe orientimit për heqjen dorë nga ligësitë dhe përfitim të virtyteve, por kjo bëhet sipas gjendjes së personit, pra duke ekuilibruar mes frikës dhe shpresës.

“Ai që është mbërthyer nga frika dhe ka hequr dorë totalisht nga çdo kënaqësi e kësaj bote, duke e mbingarkuar veten me jetesë të

vështirë, i thyhet imazhi i krijuar i frikës duke i folur për shpresën, me qëllim që t'i kthehet ekuilibrit dhe të mesmes. E njëjta gjë vlen për atë që është zhytur në gjynahe, por që dëshiron të pendohet dhe që nuk është penduar vetëm për shkak të gjynaheve të mëdha dhe faktit se ndjehet i demoralizuar. Kështu atij i mundësohet dhe i lehtësohet pendimi.”

5. Ekuilibri personal te Gazali

Gazali përdor një term të rëndësishëm për të treguar arritjen e ekuilibrit psikologjik dhe përshtatjes personale me mjedisin, ky term është “të qenët i kënaqur – razillëku”, term që përdoret në psikologjinë moderne.

Te Gazali, të qenët i kënaqur është fryt i dashurisë, pra dashurisë së robit karshi Zotit dhe Krijuesit të tij, është fryt i bindjes së robit ndaj Zotit. Të qenët i kënaqur, përfytyrohet nga dy aspekte:

I pari, largon ndjesinë e dhimbjes, duke mos u lënduar. Kështu, njeriu i pranon ngjarjet e jetës megjithëse janë lënduese dhe të dëmshme, duke e shtuar karburantin e durimit të vetja. Një shembull për ta ilustruar këtë, është personi që po lufton i mbërthyer nga nervozizmi dhe gjaknxehtësia. Në këto momente, ai nuk i ndjen plagët që merr dhe dhimbjet që i shkaktojnë ato.

E dyta, e ndjen dhimbjen dhe e percepton atë, por e pranon dhe

është i kënaqur. Ai e pranon me mendje, edhe pse në natyrë e refuzon. Një shembull për ta ilustruar, është ai i një udhëtari në kërkim të rizkut. Ai e ndjen lodhjen e udhëtimit, por dashuria e tij për frytet e këtij udhëtimi, ia zbut lodhjen dhe e bën ta pranojë dhe të jetë i kënaqur me ato që heq.”

Të qenët i kënaqur, sipas Gazalit, është një gjendje ku arrihet triumfi ndaj instinkteve dhe pasioneve, sigurisht pas një konflikti mes stimujve të epshit dhe atyre të virtytit. Përvetësimi i durimit në këtë fazë dhe përkushtimi ndaj ushtrimeve për përsosjen e shpirtit për të hequr dorë nga ligësitë, i jep njeriut lirinë për të marrë në dorë veten dhe për ta udhëhequr atë. “Kur njeriu e kontrollon pasionin dhe zemëratën e tij, duke iu bindur stimujve të fesë... ai bëhet njeri i lirë.”

E nëse ndodh e kundërta dhe njeriu nuk ia del dot që ta kontrollojë veten dhe pushtohet nga instinktet “ai shndërrohet në një skllav i nënshtruar, si një kafshë, një rob që orientohet kollaj me kapistrën e epshit dhe që shkon nga ta urdhërojë instinkti.”

Që asokohe, imam Gazali e kuptonte metodën e terapisë së plotë, e cila bazohet te paralelizmi mes terapisë vetjake të cilën e bën vetë individi dhe terapisë objektive që bëhet nga jashtë, si një mësues dhe udhëzues. Ai thotë: “Njeriu gafil (i shkujdesur) i cili nuk e dallon dot

të vërtetën nga e pavërteta dhe të bukurën nga e shëmtuara, i cili ka mbetur në natyrën e parë, krejt bosh nga besimet dhe bindjet... një i tillë e pranon shumë shpejt terapinë. Ai nuk ka nevojë tjetër përveçse për një mësues, orientues apo për një stimul të brendshëm, i cili e nxit për t'u përpjekur. Kështu, morali dhe virtyti i tij pësojnë përmirësim në kohë rekord.”

Përfundim

Pa frikën më të vogël mund të themi se, Imam Gazali është themelues i psikologjisë islame, se ai u ka paraprirë të tjerëve në themelimin e kësaj shkence në metodologji dhe subjekt. Këtë gjykim e mbështesim në bazë të fakteve që lartpërmendëm, të nxjerra nga burimet origjinale. Në fakt, nga gjithë ai masiv faktesh, kemi sjellë shumë pak të tilla, ato që na u dukën më të rëndësishme.

Nga modelet e përmbledhura, duket që Gazali ka pasur një perceptim të drejtë mbi shumë probleme dhe patologji të shpirtit, të cilat i ka përshkruar në mënyrë objektive.

Ai ka qenë i ndërgjegjshëm edhe me rolin e aspektit shpirtëror në trajtimin dhe suksesin e terapisë psikologjike, duke mos i injoruar faktorët psikosocialë dhe psikosomatikë.

Nuk e teprojmë nëse themi se Gazali është një nga pionierët e parë të psikologjisë dhe edukimit. Ndoshta studimet shkencore dhe serioze të mëvonshme do të nxjerrin në dritë shumë nga xhevahiret e trashëgimisë sonë të lënë pas dore.¹

Përktheu: Elmaz Fida

1 . Artikulli i marrë dhe përkthyer nga adresa: <http://www.kalema.net/v1/?rpt=953&art>

Regjistrimet më të hershme në folklorin muzikor shqiptar (ca. 1650)

Prof. dr. Bardhyl Demiraj, Gjermani

Abstrakt

Objekt i këtij punimi janë tri këngë folklorike shqip si pjesë e trashëgimisë në dorëshkrim të muzikologut 'Alī Ufkī (1610 - 1677 ?), të cilat i qëmtoi para do kohësh si të padeshifrueshme studiuesja e artit muzikor oriental Judith Haug, edhe pse për ndonjë syresh ishte më se e bindur se duhej të ishte shqip, meqë emërtohej si i tillë (: <ARNAV. TURKI.>). Synimi i punimit tonë është sa i thjeshtë aq edhe domethënës. Është pikërisht përpunimi filologjik dhe botimi kritik i materialit gjubësor shqip që përcolli natyrshëm kërshtëria e saj me u përditësuar doemos me përmbajtjen e tyre. Dhe rezultati i këtij reaksioni zinxhir është po aq fatlum: trashëgimisë së kulturës shqiptare i shtohen tash do përmendore të reja me vlerë disafishe, meqë: a) kemi të bëjmë me regjistrimet deri sot me të hershme në folklorin muzikor shqiptar – aty rreth vitit 1650 (!) dhe b) tri këngë i përcjellim me tekstin shqip dhe me notacionin muzikor përkatës.

1. Fjalë hyrëse

Shkrepimë fatlume në qiell të kthjellët: kështu e perifrazuam dikur ngazëllimin tonë me do tekste këngësh e frazash në dorëshkrim, të cilat nuk kishte arritur t'i zbërthente

studiuesja muzikologe Judith Haug, edhe pse për ndonjë syresh ishte më se e bindur se duhej të ishte shqip, meqë emërtohej si i tillë (<ARNAV. TURKI.>), ndërsa për do të tjera dikush ishte shprehur nëpër dhëmbë se mos kushedi i afroheshin disi



shqipës. Fatmirësisht edhe këto ishin shqip.¹ Veçse atë çka nuk ishte ende në gjendje të përsiaste kjo njohëse e thelluar në historinë e artit muzikor oriental, ishte bash ai reaksion zinxhir që do të përcillte natyrshëm kërshtëria e saj fanmirë me u përditësuar doemos me përmbajtjen e tyre. Dhe rezultati është po aq fatlum: trashëgimisë së kulturës shqiptare i shtohen tash do përmendore të reja me vlerë disafishe, meqë kemi të bëjmë jo thjesht dhe vetëm me regjistrimet deri sot më të hershme

1. Korrespondencë (via *e-mail*) me të dhënat elektronike përkatëse më dt. 5 prill 2016.

në folklorin muzikor shqiptar - aty rreth vitit 1650 (!) -, por plot tri sosh i përcjellim qoftë si tekste këngësh shqip, ashtu edhe me notacionin muzikor përkatës. Në këtë mënyrë, nuk ekzagjerojmë aspak, nëse u shtojmë njëherësh këtyre fjalëve hyrëse dëshirën tonë sa të mirë aq edhe realiste për ta përjetuar dikur gjithkush ndër ne atë ditë, kur këto këngë të hershme të debutojnë në skenën e muzikës sonë folklorike.

Asgjëmangut, synimi i shkrimit tonë mëton të ndihmojë në mënyrë sado anësore edhe në këtë pikë, ani pse ka të bëjë më fort me hetimin dhe përpunimin filologjik e së fundi me edicionin kritik të tekstit të këtyre këngëve, duke bërë të mundur e saktësuar kështu edhe vendin e tyre në historinë e larmishme të kulturës së shkrimit shqip përgjatë shek. XVII. Sigurisht që kjo punë e mirëfilltë filologjike parakupton së pari qëmtimin e detajuar të kuadrit paratekstual, ndër të tjera: a) njohja me autorin, në rastin tonë me regjistruesin e tyre; b) përshkrimi sado i thukët i mjedisit historik e social-kulturor, në të cilin ai jetonte, si edhe c) përditësimi me kushtet a rrethanat që e nxitën atë në ndërmarrje të kësaj natyre. Për fatin tonë të dytë, që vjen me thënë: po aq fatlum, këtë punë paraprake e ka përcjellë në kohë dhe ndërkohë në mënyrë thuajse shteruese zbuluesja *de jure* e këtyre teksteve, Judith Haug dora vetë, në disa studime të

thelluara, ku është marrë në mënyrë intensive qoftë me prurjet në varg të ‘Alī Ufkī-ut në kulturën osmane të shek. XVII, ashtu edhe me literaturën shkencore, të botuar deri sot për të dhe veprën e tij në dorëshkrim.² Kështu që nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të kompilojmë thukët për lexuesin sqimatar të “Zanit [tonë] të Naltë” këto përshkrime të saj.

2. ‘Alī Ufkī dhe prurjet e tij në kulturën osmane të shek. XVII

2.1. Jeta dhe karriera profesionale

Emri i tij i parë ishte Wojciech Bobowski (= i latinizuar <Albertus Bobovius>), si pinjoll i një familjeje fisnike me origjinë polake, i cili lindi aty rreth vitit 1610 në Lwow (Lemberg: sot në territorin e Ukrainës). Mendohet të ishte duke studiuar dikur muzikë në atdheun e vet të parë deri aty nga mosha 20 vjeç, shi kur u zu rob prej tatarëve

2. Khs. ndër të tjera: *Der Genfer Psalter in den Niederlanden, Deutschland, England und dem osmanischen Reich (16.-18. Jahrhundert)*. Tutzing 2010 (= Tübinger Beiträge zur Musikwissenschaft 30). Shkruesi i këtyre radhëve falënderon përzemërsisht me këtë rast autoren, e cila i vuri në dispozicion edhe studimet e saj, ende në shtyp: Representations of uşul in ‘Alī Ufukī’s Manuscripts, në: Zeynep Helvacı & Ralf Martin Jäger (bot.), Rhythmic Cycles and Structures in the Art Music of the Middle East (in print); Being more than the sum of one’s parts: Acculturation and biculturalism in the life and works of Alī Ufukī, in: *Proceedings of the 21st CIEPO Symposium* (in print).

të tmerrshëm të Krimesë, në mos vetë osmanëve gjatë rrethimit të Kameniec-it (Poloni) dhe u transportua si i tillë në Stamboll, në oborrit e Sulltan Murad-it IV. Aty i bënë vend sigurisht në suitën e çunave të oborrit (: *ıçoğlanlar*), shërbyes këta meshkuj e pa të drejta qytetare, të cilët merrnin formimin përkatës në sarajet e Sulltanit e që ishin në zanafillë kryesisht të besimit të krishterë. Dikur Alberti erdhi e na u konvertua, ashtu siç edhe pritej, në fenë islame. Andaj mori edhe emrin: ‘Alī (= shq. Ali).

Menjëherë ranë në sy në oborr aftësitë e tija në njohjen e gjuhëve të huaja e sidomos talenti i tij i (pa) zakonshëm në fushën e muzikës, andaj edhe u orientua qysh në fillim të studionte (këngë dhe psallter) në shkollën e muzikës së pallatit (: *meşkhāne*), ku u dallua menjëherë si nxënës i shkëlqyer, madje ngadhënjeu po aq shpejt edhe ofiqin *Şantūri* ‘Alī Bey. Mbiemri Ufkī (= alternativ Ufukī), me të cilin njihet më shumë, është sajuar pas gjase prej atij vetë, meqë e përdorte rregullisht kur vjershëronte. Burimet dokumentare parapëlqejnë gjithsesi më fort emrin zyrtar ‘Alī Bey. Si i tillë ai fitoi shpejt respekt dhe nderim të veçantë te kolegët dhe eprorët e vet, të cilët i caktuan pozicionin e mbikëqyrësit dhe mësuesit të çunave muzikantë të oborrit (: *erbaşı*). Aty rreth vitit 1650 u shpall - siç pritej - shtetas i lirë i perandorisë, pasi kishte shërbyer për

20 vjet rresht në oborrit e sulltanit, duke u akulturuar plotësisht si pinjoll i bindur i perandorisë dhe njëherësh i kulturës orientale.

Faza e tretë dhe e fundit e jetës së tij nuk njihet në detaj. Aty rreth vitit 1650 mendohet të ketë pasë filluar si karrierë të dytë atë të përkthyesit për ambasadorin anglez pranë Portës së Lartë. Në të njëjtën kohë mori edhe detyra përkthimi prej kancelarisë së oborrit të sulltanit, madje me fermanin e dt. 12 të muajit Şaban më 1079 (= 5 janar 1669) u emërua edhe si përkthyes zyrtar në atë kancelari, ku bëri karrierë deri në rangun e përkthyesit të dytë të *Divân-it* e duke veshur kështu një pozicion relativisht të lartë në oborr. Me të fituar këtë status, pati mundësi të zhvillonte kontakte të shumta me vizitorë, kronikanë, hulumtues, artdashës, tregtarë, misionarë dhe diplomatë evropianë. Por jo vetëm kaq: për më tepër ai u shërbeu shumëve syresh edhe si mësues i gjuhës turke. E bash prej sosh, çoku na shfaqet atëbotë edhe ndonjë fjalë a thashetheme ligaçe, se gjoja Aliut tonë sikur ia paskësh pasur ënda “t’ia mbathte me të katra” dikur drejt Perëndimit (pas gjase në Londër) e aty të rikonvertohej si i krishterë.

Këto historiza pa bukë sikur i vijnë përshtat fundit të tij gjithsesi i trishtë, meqë Aliut i paskan dhënë duart prej oborrit, pas gjase, për punë konsumi të paepur alkooli. Por jo vetëm kaq, sepse duhet të ketë nisur

jetë të mirëfilltë bashkëshortore në një moshë paksa të thyer, aty rreth vitit 1671, edhe kjo një punë që me sa duket nuk i solli aspak fat: mbylli sytë për të fundit herë pas do motesh në rrethana krejt të panjohura, ndërmjet viteve 1672-1679, edhe pse më i besueshëm tingëllon të ketë qenë viti 1677.

2.2. Trashëgimia në dorëshkrim

Aliu filloi të hidhte në letër shënimet e veta muzikore rreth vitit 1650, pra në prag ose menjëherë pas ngadhënjimit të statusit të ri si shtetas i lirë në perandorinë osmane. Bëhet fjalë në rastin tonë për një tip almanaku me shënime të konsiderueshme të kësaj natyre, ku përfshihen jo më kot edhe ditare të ndryshëm udhëtimi, udhëzime e receta të shumta ilaçesh popullore, sindëkur edhe shënime të tjera, p.sh. vjersha të veta e të autorëve të ndryshëm në një numër të madh gjuhësh. Ky vëllim në dorëshkrim me titull “Përmbledhje me vjersha dhe këngë“ (: *Şiir ve şarkı mecmû‘ası*), i depozituar në Bibliothèque Nationale të Parisit është përgatitur ndërkohë për shtyp prej muzikologes Judith Haug dhe pret të shohë dita me ditë dritën e botimit.³

Aliu përgatiti më vonë në dorëshkrim, por në formë thujse

3. Judith I. Haug: Ottoman and European Music in ‘Alî Ufuķî’s Compendium, Ms. F-Pbn Turc 292: analysis, interpretation, cultural context (c. 1650), Volume 2: Edition (April 5, 2016).

të përfunduar një përmbledhje muzikore që përmban vetëm notacione, të cilën e titulloi “Përmbledhje tërësore e muzikës instrumentale dhe vokale” (: *Hāzā Mecmū‘a-yl Sāz ü Söz*).⁴ Të dyja vëllimet përfunduan dikur në Perëndim, pas gjithë gjasash menjëherë pas vdekjes së autorit: i pari në Paris dhe i dyti në Londër.⁵ Në këtë mënyrë, edhe ndikimi i tyre i mundshëm në praktikën muzikore osmane të kohës do vështruar me lupën e historianit si tejet modest, në mos aspak gjurmëlënës. Padyshim, këto përmbledhje të pasura me forma dhe stile të ndryshme muzikore janë dhe mbeten burimi më i hershëm i muzikës osmane - i regjistruar me notacionin përkatës - e për këtë arsye ruajnë sot vlera të pallogaritshme sa i përket praktikës muzikore të kësaj kulture në shek. XVII, e cila rezultoi të jetë fiksuar si e tillë në letër vetëm te ky autor, duke zbatuar me këtë rast shi praktikën perëndimore të shkrimit me nota muzikore.⁶

4. Sipas Haug (2010) *Mecmū‘a* është emërtimi tradicional për një përmbledhje këngësh me të dhënat kryesore për *makām* (modus, mënyra) dhe *uṣūl* (cikli ritmik).

5. Signaturat: Supplément Turc 292 dhe GB-Lbm Ms. Sloane 311418. Vëllimi i dytë përjetoi në Perëndim qysh atë shekull e në vazhdimësi disa botime me titullin latinisht *Tractatus de Turcarum Liturgia*. (Haug *vep. cit.*)

6. Sipas Haug (*vep. cit.*), para dhe pas shek. XVII shkolla muzikore orientale nuk praktikonte aspak fiksimin në letër të repertorit muzikor, pasi muzikantët i përmbaheshin me besnikëri traditës me përcjellje gojore brez pas brezi. Sipas saj,

3. Tekstet shqip në dorëshkrimet e ‘Alī Ufki-ut

Mjafton t’i referohemi pikërisht kësaj veçorie të fundit në shënimet muzikore të ‘Alī Ufki-ut me kuptuar siç duhet pikërisht atë vlerë të paçmueshme që mëtojnë në historiografinë e folklorit muzikor shqiptar të paktën ato këngë shqip, të regjistruara po prej tij qoftë me tekstin, ashtu edhe me notacionin muzikor përkatës. Krahas dy këngëve, të cilat, falë tekstit dhe përmbajtjes, lejohemi t’i klasifikojmë lehtë si këngë dashurie (: *erotica* – shih më poshtë T[ekstet] II / III), në almanakun e autorit ndeshim gjithashtu një përpjekje sado modeste për një përkthim vargëzimi muzikor me notacionin përkatës (: I). Së fundi vëmë re se, në këto dorëshkrime, ngjërojmë edhe ndonjë dialog shqip, sigurisht aspak joshës për sytë e veshët tanë, thënë saktë: kemi të bëjmë me sharje e fyerje të dhunshme në formën e kërcënimit të tjetrit në mexhllis, të cilat i takojnë si të tilla regjistrimit gjuhësor tejet vulgar në situata po aq vulgare të diskursit bastard (: *folklor i xji* – T IV). Sigurisht që shkruesi i këtyre radhëve nuk cilëson aspak si ngushëllues faktin, që tekste të kësaj natyre nuk shfaqin kurrfarë shmangieje në formë e përmbajtje, sa i përket situatave të ngjashme në mbarë hapësirën shqipfolëse/ ballkanike

vetëm në shek. XIX filloi të përvetësohej në këtë kulturë praktika europiane perëndimore me notacion muzikor.

në kohën tonë.⁷ Kështu që në këtë punim i kemi anashkaluar me vetëdije shprehje të kësaj natyre, duke mbajtur gjithsesi hapur opsionin e botimit dhe interpretimit të tyre në revista ndërkombëtare të specializuara në filologji dhe antropologji sociale.

Përpos këtyre katër teksteve nuk mësojmë dot diçka më shumë shqip në këtë almanak të vëllimshëm. Shpërndarja e tyre në së paku tri folje me distancë të konsiderueshme nga njëra-tjetra (fol. 33r/15a; 276r/122a; 350v/192b) lejon të përsiatet gjithsesi një mëdyshje e parë e më se e motivuar, se mos ndoshta informanti/rapsodi shqipfolës nuk ka qenë patjetër i njëjti person. Këtë mëdyshje sigurisht që nuk e kemi bërë objekt studimi në këtë punim, por, siç do të përpiqemi ta verifikojmë në një hulumtim të ardhshëm ballor, atë e tumir në njëfarë mënyre edhe praktika e ndryshme e aparatit grafik që ka përdorur ‘Alī Ufkī-u për të fiksuar grafikisht në letër


materialin gjuhësor gojor në njërin apo tjetrin tekst shqip, përkatësisht në një gjuhë, të cilën ai, pas gjase, nuk e ka njohur drejtpërsëdrejti.

Mjafton pak a shumë kumti i saktë i rrethanave paraprake, në mënyrë që të ndërmarrim tash si hap të parë riprodhimin diplomatik të këtyre teksteve shqip (§ 3.1.), përkatësisht aso pjesësh që rezultojnë të tilla në këtë almanak që trashëgojmë në dorëshkrim prej autorit tonë. Një hap i dytë është ai i përpunimit filologjik dhe i tejkshkrimit kritik të tekstit (§ 3.3), çka parakupton përditësimin me kodin alfabetik që ka zbatuar autori/regjistruesi në këtë rast, përkatësisht përshtatjen e tij me kodin alfabetik të shqipes standarde të kohës sonë (§ 3.2.)

3.1. Riprodhimi diplomatik i teksteve shqip

Kalojmë kështu natyrshëm në riprodhimin diplomatik (= shkronjë për shkronjë) të teksteve shqip ashtu siç na paraqiten ato më poshtë në faksimilet origjinale të dorëshkrimit në fjalë:

7. Khs.: Robert Elsie, Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid). Leiden, New York, Cologne 2000 (passim).



Teksti I (faksimile: fol. 33r/15a)

Studime

Her sheharile wente te drita ://:
[...]

Me ßinde tifalem; selam ti
dergon ://: [...]

Derdimendu kulij muderi iunij
://: [...]

(majtas)

Dilberî sute te zeiez Dilberî Sut
ete zeies ://:

O i naltî Hidarelez Oin alti
hidareles ://:

A to zemer plasu nato ://:

da ie llan na fenetano ://:

Ate poszto dehaneto ://:

B aka hiie perd uweto ://:

Kondona bilbil kondona ://:

Mora krahat exti ferit ://:

Ja bukura si d o weto ://:
(djathtas)

Uri ciel sekeriu indes hie

Naru wai te da ßu na ti Hie

Rana fialete bo tesu hie

Poperhel mit meiu grane hie


Bike karafili weto hie

Âßtö guzowaz torito hie


Dina marte giumi kiona hie

Lutorowa pas dilberit hie

Kußtokato ßkoni ai ete Hie



Teksti II (Faksimile: fol. 276r / 122a: <ARNAVUT. TURKI.>)



Tekstet III/IV (Faksimile: fol. 350b / 192b)

(Teksti III – lart)

Eβk ola dilber eβk ola | Eβa
pikemi ke mola | Cheikemola ke
zerdelia | ke piketi βeftelia.

Kur marigne bobrek wis[ej]ij
mezambu ghianje ingise meβtata holu
selwise Met[??]oni ghian ghemise.

Reine khendoinu βtati bulbulji
| Teβtati kraha ieβili | Tekei kenu
kekamuni | E pasti guri delumi
[Sumi] Sa i forta du | roβumi

(Teksti IV – poshtë)

Bre ti kiufa ti t amo, pse ma
derde bosijn, \portinizon/ taβtit
biie me czamczit di kruet

[...]

Bre to kiwβa pize kurwisi

[...]

3.2. Kodi alfabetik i përdorur në regjistrimin e teksteve shqip

Riprodhimi diplomatik i katër teksteve shqip në almanakun në fjalë na mundëson tash të japim një gjykim të parë lidhur me praktikën e regjistrimit gjuhësor të tekstit nga një autor, i cili nga njëra anë: a) pas gjase nuk e njeh traditën ekzistuese perëndimore të shkrimit shqip me alfabet latin, pra qoftë atë traditë në arealin kulturor shqiptar të Veriut katolik (Buzuku, Budi, Bardhi), ashtu edhe atë në diasporën arbëreshe (Matranga); e nga ana tjetër: b) është një shtetas (i akulturuar) i Perandorisë Osmane që operon me përvojën e fituar falë formimit në të ri të vet në një shkollë me akses të fuqishëm në kulturën perëndimore, ku sundonte

riprodhimi me alfabet latin i teksteve në ato gjuhë të panjohura ose pak të njohura të Evropës. Dhe shqipja ishte dhe është njëra sosh. Për më tepër, të mos i anashkalojmë aspak edhe faktit që ky Aliu ynë ishte një njohës i përsosur i disa gjuhëve (ndërkombëtare) edhe të Evropës së kohës: latinishtes, italishtes, anglishtes, frëngjishtes, polonishtes etj.

Asgjëmangut, zberthimi i kodit alfabetik që përdor ‘Ali Ufk̑i-u në riprodhimin me shkrim të kumtit shqip, na shpie natyrshëm në regjistrimin e një kodi të ri me alfabet latin/italisht të shkrimit të shqipes. Në këtë mënyrë thellohet vetiu edhe më shumë ai hendek që mbizotëron sot bindshëm në *Guinness of World Records* midis vendit të parë (= shqipes) dhe vendit a vendeve të dyta, të treta etj., sa i përket larmisë së kodeve në historinë e alfabetizimit të gjuhëve që fliteshin e fliten sot në botë. Është bash ky konstatim i patëkeq që na lejon tash të përditësojmë në vazhdim lexuesin me kodin alfabetik të përdorur prej Aliut tonë.

Tabela e mëposhtme lehtëson edhe tejshkrimin e këtyre teksteve, pasi përshtat në mënyrë proporcionale elementet grafike në kodin alfabetik të përdorur prej autorit me syresh në kodin në fuqi të shkrimit të shqipes, të fiksuar njëherë e përgjithmonë në Kongresin e Manastirit (nëntor 1908). Shtylla

Studime

Alf. Manast.	API	Kodi i ·Alfi Ufuk ⁷	Shembuj
a	[a]	<a>	<Ate>, <Baka>, <drita>
b	[b]		<Bre>, <bilbil>, <bobrek>
c	[ts]	[mungon]
ç	[tʃ]	<cz>	<czamczit> (?)
d	[d]	<d>	<de> <dilberi>, <kondona>
dh	[ð]	<d>, <ɜ>	<derde> (= [derðe]), <ɜambu>, <pis>
e	[e]	<e>	<eβ>, <wente te>, <ke>
ë	[ə]	<a>, <e>, <i>, <u>, <o>, *<ij>, *<ji>	<ta ho <u>tu</u> >, <marte>, <dergon>, <te>, <to>, <por>, <βtati>, <uni>, <khendoinu>, <iunij>, <bulbulji>
f	[f]	<f>	<fi <u>ale</u> >, <karafil <u>i</u> >, <βeftelia>
g	[g]	<g>	<guri>, <dergon>, <ngrane>
gj (~ xh)	[ʃ]	<gi>, <gh>	<giumi>, <ghemise>, <ghian>
h	[h]	<h>, *<ch>	<Hidarclez>, <krahat>, <hanete>, *<chei>
i	[i]	<i>	<i nalti>, <bike>, <karafil <u>i</u> >
j	[j]	<i>	<hi <u>ie</u> >, <bi <u>ie</u> > (= ['hije], ['bijel])
k	[k]	<k>, *<kh>	<kondona>, *<khendoinu>, <kur>, <eβk>
l	[l]	<l>, *<ɫ>	<lumi>, <falem>, <bilbil>, <selam>
ll	[ʎ]	<l>	<ola>, <mola>
m	[m]	<m>	<me>, <mora>, <helmit>, <kam>
n	[n]	<n>	<ndes>, <na>, <iunij>, <ghian>, <rein>
nj	[ɲ]	<gn>	<gne>
o	[o]	<o>	<O>, <ato>, <po>, <poszt-o>
p	[p]	<p>	<plasanat-o>, <per>, <pas>
q	[c]	<k>, *<ki>, *<ik>	<pikemi>, <ke>, *<kiona>, *<Te keiken>
r	[r]	<r>	<per>, <bukura>, <kraha>, <duroβumi>
rr	[r̥]	?<r>	?<marte>, ?<rein>, ?<mari>
s	[s]	<s>	<Sa>, <selwise>, <ɜeies>, <botes-o>
sh	[ʃ]	<β>, <sz>	<βinde>, <kuβ>, <szana>, <poszt-o>
t	[t]	<t>	<te>, <ti>, <sute>, <helmit>, <βtati>
th	[θ]	[mungon]
u	[u]	<u>	<u>, <uni>, <bukura>, <guri>, <lumi>
v	[v]	<w>, *<u>	<wet>, <selwise>, <kiwβa>, <kiuβa>
x	[dz]	[mungon]
xh	[dʒ]	<g̃>	<ingise>
y	[y]	<u>, *<iu>	<du>, <bulbulji>, <kruet>, *<iunij>
z	[z]	<ɜ> <z>	<ɜeiez>, <ɜerdelia>, <por tini zon>
zh	[ʒ]	[mungon]

ndërmjetëse në këtë tabelë na përditëson me simbolet e përdorura në Alfabetin Fonetik Ndërkombëtar (API) për përshkrimin e tingujve me funksion kuptimdallues (= fonemave) në gjuhë të ndryshme të kësaj bote me / pa traditë shkrimore:

Sqarime të rastit

* = Alograf shkronjë/ togshkronjësh me vlerë fonematike që del/shfaqet vetëm njëherë në tekste, andaj edhe funksioni grafematik përkatës mbetet i dyshimtë.

?<r> = /rr/: vlerë fonetike/ fonologjike e paqartë. Pas gjase autori nuk ka qenë në gjendje të dallojë dysinë funksionale të tingujve vibrantë /r/ vs. /rr/ në shqipe, ose informanti vetë vinte nga një zonë dialektore, ku mungonte një dysi e tillë.

Shqipe standarde <ë> = [ə] = (në tekstet e Ufk̄i-ut) <a, e, i, u ...>: Bëhet fjalë kryesisht për zanoren e rrëgjuar qendrore që përftohet kryesisht në rrokje të patheksuar (= <e-ja pazanë>) e si e tillë zotëron një spektër të gjerë nyjëtimi në bashkëvjajtje me mjedisin tingullor rrethues (: sidomos në varësi të metrikës së vargut në krijimet folklorike shqip), çka e bën të vështirë perceptimin e saj për një folës jonativ të shqipes.

Shumë zgjidhje grafike në kod janë dy ose më shumë funksionale për tinguj karakteristikë të shqipes,

që nuk shfaqen patjetër si të tillë në gjuhë të tjera (përreth), khs.: <u> = shq. [u] ~ [y]; <3> = shq. [z] ~ [ð] ~ [θ] etj. Është ky një tjetër tregues, sipas të cilit regjistruesi ka pasur vërtet vështirësi të konsiderueshme në recepsionin e shqipes së folur, përkatësisht në fiksimin grafik të tingujve me vlerë kuptimdalluese (= fonemave) në gjuhën shqipe.

Për lehtësi leximi prej një rrethi më të gjerë interesuesish nuk kemi përfshirë në tabelë shenja/mjete të ndryshme grafike që përdor regjistruesi për të dalluar ndër të tjera: nuancat tingullore dhe vlerat funksionale të njërit apo tjetrit alograf në një mjedis të caktuar grafematik, si p.sh. tre pika në formë trekëndëshi që vendosen poshtë shkronjës <3> për të fiksuar vlerën e saj si [ð] = shq. /dh/, e cila në të tjera raste në tekste na shfaqet kryesisht me vlerën e grafemës <z>, <3> = /z/ ~ [z]. E njëjta situatë edhe me togshkronjëshin <ia/ja>, të cilit, në dy raste, kur pasqyrohet grafikisht me <ia>, autori i shton poshtë edhe një vijë lidhëse ovale, që dëshmon nyjëtimin e bashkëlidhur të këtij togu me vlerën e një diftongu zbritës: shq. [i^ha].

Me interes është të vihet gjithashtu në dukje edhe përdorimi në një rast - më i pari në historinë e kulturës së shkrimit shqip (!!!) - i theksit majërrethor mbi një shkronjë zanore që arrijmë ta izolojmë si mjet grafik i përdorur vetëdijshtëm prej

regjistruetit sa i përket shënimit të hundorësisë së zanoreve në gegnishte: (Γ II/6 – djathtas) <Âfto> = /ãshhtë/ “është”.

Në riprodhimin diplomatik të tekstit (shkronjë për shkronjë) këto mjete grafike janë marrë në konsideratë vetëm në raste përjashtimore, si p.sh. <ĝ> që na shfaqet si ndërhyrje e vetëdijshme e regjistruetit për të dalluar grafikisht tingullin [dʒ] = shq. <xh> si tingull i veçantë i shqipes (= fonemë) me vlerë funksionale kuptimdalluese.

3.3. Tejshkrimi i teksteve në alfabetin e sotëm të shqipes

Njohja dhe dekodimi i kodit grafik që përdori atëbotë autori në regjistrimin e kumtit gojor shqip, sikurse edhe gjurmimi i kujdesshëm shkronjë për shkronjë e fjalë për fjalë i të katër teksteve, na lejon dhe mundëson tash t’i përcjellim lexuesit në mënyrë të thjeshtëzuar tejshkrimin e tyre sipas kodit të sotëm alfabetik, duke mbajtur parasysh edhe ndarjen korrekte të fjalëve dhe pikësimin sipas normës së sotme gramatikore në shqipen standarde, si vijon:

Tekst I (fol. 33a/15a)

[Her seharile] vente te drita ://:

Me shëndet t’i⁸ falem; selam t’i dërgonj ://:

8. Grafia e vetme <t> në togun /Me shëndet t’i/ shfaqet me funksion të dyfishtë: a) si fundore e fjalëformës /shëndet/ dhe b) si nistore e pjesëzës gramatikore të lidhores /të/. E njëjta rrethanë edhe më poshtë në T III/2 /Me shtat të hollë/.

[Derdimendu kulij muderij] ynë ://:]

Tekst II (fol. 276a/122a)

(majtas)

Dilberi⁹ sytë të zejez; dilberi sytë të zejes.

O, i nalti Hidarelez¹⁰; O, i nalti Hidareles.

Ato zemërplasunat – o!

Dajelan¹¹ në fenë tan – o!

Ate posht – o, te hanet – o!

Baka hije për dy vet – o!

Këndona bilbil, këndona.

Mora krahat e skifterit.¹²

9. Kemi të bëjmë këtu me një fjalë me përdorim në kuptimin e saj zanafillës si huazim prej turq./osm. *dilber* “vajzë e bukur (dhe në moshë të pjekur)”, khs. rr. 3 (majtas): /Ato zemërplasunat – o!>. Këtë kuptim kjo fjalë ruan (ende) në kohën tonë, ashtu siç na shfaqet si emër personal i një personi femër ose mashkull: *Dyllbere* [= “vajzë e bukur”], përkatësisht *Dylber* [= “djale i bukur”]; e që këtej jo rrallë edhe si emër familjar: *Dylberi*. Lejohemi të shtojmë gjithashtu, që këtë kuptim burimor fjala erdhi dhe e rrudhi gradualisht në kohë në disa zona urbane të pejsazhit social-kulturor shqiptar, ashtu siç na shfaqet përgjithësisht në shumë këngë bejtexhinjsh, sidomos pas gjysmës së shek. XVIII e në vazhdimësi në shek. XIX. Janë pikërisht rrethana të kësaj natyre që i bëjnë këto tekste këngësh folklorike të mëhershme një objekt me vlerë të veçantë edhe në studime të mirëfillta gjuhësore me karakter historik-leksikografik dhe etnolinguistik.

10. Turqishte *Hidirelez* „dita/festa e fillimit të verës sipas kalendarit të vjetër”.

11. Ndoshta kemi të bëjmë me turq. *dayal* “i mbështur, i fiksuar”.

12. Shkruar ndoshta gabim prej regjistruetit,

Ja (e) bukura si do vet – o!
 [djathtas]
 [Uri ciel sekeriu] i ndes – hej!
 [Naru] vaj të dashunatë – hej!
 (T')rana¹³ fjalët e botës – o! –
 hej!
 Po për helmit me iu ngranë –
 hej!
 Bike karafili vet¹⁴ – o! – hej!
 Æshtë [guzowaz torito] – hej!
 (N')dë na martë gjumi qona¹⁵ –
 hej!
 (F)lutorova pas dilberit – hej!
 Kush të ka, të shkonjë jetë – hej!

Tekst III (fol. 350b / 192b –
 lart)

Eshk olla¹⁶ dilber, eshk olla!
 | Esh¹⁷, a piqemi ke molla | Hej;
 ke molla, ke zerdelia | Ke piqetë
 sheftelia.

Kur marri një bobrek¹⁸ [wisij]
 | Me dhamb' u gjanjë inxhsë | Me
 shtat të hollë selvisë | [Met??oni]
 gjian gemisë.

në mos kemi me të bëjmë me një fjalëformë
 të pazakonshme me metatezë: /kstiferit/ =
 “skifterit”.

13. /(')rana/ = “të rënda”.

14. /Bike karafili vet/ = ”mbika karafili
 vetë”.

15. /qona/ = “çona (nga gjumi)”.

16. *Eshk* (= ashk) “dashuri shpirtërore” (shih
 Tahir N. Disdari, Fjalor i orientalizmave në
 gjuhën shqipe, Tiranë 2005 43).

17. Turqizëm i hershëm në shqipe: *es* “mik,
 shok, bashkëshort” (shih Tahir N. Disdari,
vep. cit. 257)

18. Fjalë e paqartë. Në të folmet shqipe
 lindore rezulton si fjalë sllave me kuptimin
 organit të veshkës.

Rejn¹⁹ e këndojnë shtatë bylbylë
 | Të shtatë krahajeshilë | Të keqenë
 që kam unë | E pastë guri te lumi |
 Sa i fortë, duroshumi.

Tekst IV (fol. 350b / 192b –
 poshtë)

Bre [...]; Pse ma derdhe bozën?!;
 Për Tinëzon!; tashti t' bije me çamçit²⁰
 (n)dë kryet!

[...]

Bre [...]

[...]

Sqarime të rastit

Një përshkrim i akribtë i
 zgjidhjeve grafike alternative për
 secilin rast në veçanti, sikurse edhe
 fiksimi i sigurt i kufijve të fjalëve
 brendapërbrenda çdo strukture
 grafike: fjale, togu fjalësh, fjalie dhe
 kumti/fraze në përgjithësi, sigurisht
 që do të nxisnin një farë çorientimi
 negativ në rrethin e gjerë të lexuesve
 të “Zanit të Naltë”. Andaj, në
 përputhje edhe me synimin tonë
 modest, të kumtuar qysh në hyrje,
 jemi përqendruar në këtë punim
 të parë në paraqitjen sa më të

19. <Rejn>: grafi e vështirë që mund të
 interpretohet a) si formë dialektore e
 gegnishtes qendrore për foljen *rejn*, ose b)
 më mirë një variante e *vrejn* = “vërejnjë,
 kundrojnë, shohin”.

20. <çamçit> = (?) /çamçit/: lexim i
 vështirë dhe thjesht alternativ (krahas [?]/
 xhamçit/, [?]/xhamxhit/), përderisa edhe
 kuptimi i fjalës nuk zberthehet si duhet.
 Pas gjase kemi të bëjmë me një shformim a
 reception të gabuar të shq. *xhamçik*, *xhamçak*
 < turq./osm. çamçak “kupë druri për të pirë
 (me vesh ose bisht)”.

thjeshtëzuar të atyre veçorive grafike që përcjell tejskrimi i teksteve në alfabetin e sotëm të shqipes standarde së bashku me rregullat e zakonshme të pikësimit dhe të ndarjeve të fjalëve nga njëra-tjetra. Ndër të tjera, vërejmë që:

siç edhe pritet (!), nuk kemi mundur të zbërthejmë gjithçka në vargjet e atyre teksteve që tingëllojnë përgjithësisht shqip. E arsytet janë të ndryshme: a) në këto vargje ndërkalen fjalë e fraza turqisht/osmanisht, si p.sh. T I/1: <Her seharile> = turq. “çdo mëngjes”; po ashtu b) një numër grafish shkruesi i këtyre radhëve nuk ka mundur t’i identifikojë dot me material shqip, khs.: T I/3; T II/1, 2, 6 - djathtas; Tekst III/2. Të gjitha këto raste të vështira janë markuar në tejskrim me kllapa katrore, duke i mundësuar lexuesit të ndërmarrë vetë dikur iniciativën përkatëse me ndihmuar në zgjidhjen e patëmetë të leximeve të kësaj natyre. Siç vumë oroe më lart, kemi lënë vetëdijshtëm pa zbardhur në kodin e sotëm ato pjesë që i takojnë folklorit të zi të shqipes;

autorit/regjistruesisit të teksteve - siç edhe pritet (!) - mund a duhet t’i ketë shpëtuar në ndonjë rast recepsioni i saktë auditiv, përkatësisht të ketë pasur vështirësi në fiksimin grafik të strukturës tingullore të njëres apo tjetres fjalë. Këto rrethana i përcjellim fare mirë: a) në rrëgjimet ase mosfiksimit sidomos të tingujve nistorë të fjalëve

të kumtuara/kënduara prej rapsodit në bashkëvajtje me metrikën e vargut dhe melodinë etj. Mungesa të kësaj natyre jemi përpjekur t’i plotësojmë, duke shtënë tinguj shtesë ndërmjet kllapash rrumbullake, përkatësisht duke u rrekur ta bëjmë tekstin sa më të kuptueshëm për lexuesin e thjeshtë; b) jo rrallë përballemi edhe me pasiguri në fiksimin në shkrim të ndonjë fjale me sekuenca të pazakonshme tingullore, si p.sh. në rastin (T II/8 – majtas) <xtiferit> (= /kstiferit/) për zogun grabitqar /skiferit/; ose edhe në dallimin e vështirë midis bashkëtingëlloreve të zëshme e të shurdhëta në disa pozicione, khs.: (T II/1 – majtas) / të zejez/ pranë /të zejes/; (T II/2 – majtas) /Hidarelez/ pranë /Hidareles/ (tekst III/3) <de lumi> për /te lumi/ etj.

5. Disa karakteristika gjuhësore të teksteve

Një çështje e fundit që duam ta prekim shkurt në këtë studim, ka të bëjë me karakteristikat gjuhësore të teksteve shqip që datohen me siguri në një periudhë që përkon me gjysmën e shek. XVII. Sigurisht që mungesa e shënimeve sqaruese me të dhëna personale të njërit apo tjetrit informant/rapsod, sa i përket qoftë vendlindjes, përkatësisht atij mjedisi kulturor shqiptar, ku jetonte ndërkohë, krijon padyshim vështirësi në izolimin e trevave përkatëse të kulturës muzikore shqiptare. Gjithsesi kemi mundur të qëmtojmë

një numër tiparesh gjuhësore me përhapje dialektore të kufizuar, të cilat na lejojnë në njëfarë mënyre t'i izolojmë me afërsi këto treva.

Prashtu nuk e kemi aspak të vështirë të dallojmë që të paktën tekstet më të gjata (T II/III) i takojnë një zone kulturore gegë. E për këtë nuk na mjafton vetëm vëzhgimi i bërë më lart lidhur me përdorimin sado rastësor të theksit majërrethor si mjet grafik për të shënuar hundorësinë e zanoreve si dukuri tipike e gegnishtes. Në këtë hulli të çojnë, ndër të tjera:

Mungesa e dukurisë së rotacizmit në disa fjalë e fjalëforma, khs.: (T II/3 – majtas) /zemërplasunat/ e jo tosk. */-plasurat/. Këtu hyn në instancë të fundit edhe forma geqe e mbiemrit (T II/2 – majtas) /i naltë/ kundrejt tosk. */i lartë/.

Përdorimi i zanores së theksuar /a/ (edhe përpara një bashkëtingëlloreje hundore) kundrejt së pritshmes /ë/ në toskërishte, khs.: (T II/6 – majtas) /baka/ kundrejt tosk. /bëka/ ose (T III/2) /dhambë/ kundrejt tosk. /dhëmbë/ etj.

Përdorimi i paskajores së tipit *me* + pjesore: /me ... ngranë/ (T II/4 – djathtas) që na shfaqet vetëm në gegnishte.

Është për t'u shënuar gjithashtu që gjuha dialektore e teksteve edhe

pse gegnisht largohet në shumë tipare prej asaj të autorëve të vjetër të Veriut të shek. XVII, si p.sh.: Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani apo letra e Pleqve të Gashit (1689). Pa dashur të ndërhyjmë më hollësisht në këtë hulli studimi, që do t'i kapërcente sinorët e një punimi me karakter kryesisht informues divulgativ, mund të përsiasim një zonë dialektore geqe që i takon Shqipërisë së Mesme, ndoshta në trevat qendrore dhe lindore të saj.

6. Përfundim

Mbyllim këtu studimin tonë me shpresën dhe dëshirën e mirë se i kumtuam lexuesit të “Zanit të Naltë” bash atë synim që i vumë vetes në fjalët hyrëse: ta përditësojmë atë me zbulimet më të fundit të përmendoreve të vjetra të kulturës shqiptare, të cilat rezultojnë të jenë regjistrimet më të hershme (me tekst dhe notacion muzikor) të këngës folklorike shqiptare: ca. 1650. Zbërthimi i kodit alfabetik mundësoi padyshim njohjen paraprake me përmbajtjen dhe klasifikimin e tyre si këngë dashurie të pastër rinore. Urojmë që këtë përçapje të parë ta ndjekë edhe njohja e thelluar e notacionit muzikor, në mënyrë që në një të ardhme sa më të afërt të përjetojmë *live* - përse jo!? - kandin e muzikës folklorike shqiptare në shek. XVII.

Fjalë e zbritun, Gjuhë e nâltsueme*

Fatos A. Kopliku MS/MA
Washington DC, SHBA

Abstrakt

Nëse kujtojmë klishtë italiane traduttore traditore (përkthyes tradhtar), ajo na tregon për pamundësinë e përkthimit të përsosur të çfarëdo teksti, e aq më tepër të një teksti të shenjtë me shtresime kuptimesh. Studiuesi A. J. Arberry me të drejtë e pat quajtur përkthimin e tij të Kur'anit 'interpretim' – Koran Interpreted – dhe në hyrje shprehet kështu: "Retorika dhe ritmi i arabishtes së Kur'anit janë aq të veçanta, aq të fuqishme, aq tronditëse, saqë, për nga vetë natyra e gjërave, çdo version [përkthimi] doemos do të jetë vetëm një kopje e gjorë e madhështisë shkëlqyese të origjinalit." Kjo s'do të thotë se Kur'ani nuk duhet përkthyer në tjetër gjuhë – në fakt krejt e kundërta – por duhet që përkthyesit të jenë njohës të shkëlqyer të gjuhës së Kur'anit dhe asaj në të cilën përkthehet, të traditës shumë të pasur të komentimeve, nuancave, e konteksteve të fjalëve e vargjeve, ndërsa duhet të kihet gjithmonë parasysh se "të gjithë përkthimet përfundimisht janë vetëm qasje".

Nëse kujtojmë klishtë italiane traduttore traditore (përkthyes tradhtar), ajo na tregon për pamundësinë e përkthimit të përsosur të çfarëdo teksti, e aq më tepër të një teksti të shenjtë me shtresime kuptimesh. Studiuesi

A. J. Arberry me të drejtë e pat quajtur përkthimin e tij të Kur'anit 'interpretim' – Koran Interpreted – dhe në hyrje shprehet kështu: "Retorika dhe ritmi i arabishtes së Kur'anit janë aq të veçanta, aq të fuqishme, aq tronditëse, saqë, për nga vetë natyra e gjërave, çdo version [përkthimi]

doemos do të jetë vetëm një kopje e gjorë e madhështisë shkëlqyese të origjinalit.” Kjo s’do të thotë se Kur’ani nuk duhet përkthyer në tjetër gjuhë – në fakt krejt e kundërta – por duhet që përkthyesit të jenë njohës të shkëlqyer të gjuhës së Kur’anit dhe asaj në të cilën përkthehet, të traditës shumë të pasur të komentimeve, nuancave, e konteksteve të fjalëve e vargjeve, ndërsa duhet të kihet gjithmonë parasysh se “të gjithë përkthimet përfundimisht janë vetëm qasje”.

Ishte një natë me qetësi të pazakontë për rrugët e Kajros, rrëfen studiuesi amerikan Michael Sells në hyrjen e librit të tij *Duke in qasur Kur’anit*. Kafenetë ishin mbushur plot, por jo për ndeshje finale futbolli, as për të ndjekur funeralin e ndonjë personaliteti të njohur. Ajo çka kishte magjepsur mori të tëra njerëzish rreth ekraneve të televizorit të kafeneve ishte këndimi i Kur’anit nga një prej recituesve më të njohur të Egjiptit. Jo më pak interes, vazhdon Sells, po tregonin disa të krishterë koptë¹ në lobin e hotelit ku ai rrinte².

Natyrisht lind pyetja se ndërsa

* Kemi ruajtur trajtën gegërisht të titullit ngaqë tema lidhet ngushtë me kuptimin e emrit të revistës “Zani i Naltë”.

1. Koptët gjenden kryesisht në Egjipt dhe janë nga komunitetet më të mëdha të arabëve të krishterë.

2. Michael Sells, *Approaching the Qur’an: The Early Revelations* (Oregon: White Cloud Press, 2007), i.

është e kuptueshme që arabët mund të magjepsen nga gjuha e Kur’anit, ç’duhet të bëjnë ata që nuk dinë arabisht – a nuk duhet të jetë parakusht njohja e arabishtes për të qenë mysliman? Katërbëdhjetë shekuj histori e Islamit dëshmon, pa dyshim, se jo. Megjithatë, njohja minimale e disa vargjeve kur’anore është e domosdoshme, pasi ato nuk mund të recitohen në tjetër gjuhë për të kryer ritualet. Kjo sepse Kur’ani, për myslimanët, nuk është thjesht një kryevepër nga ana letrare e lingvistike, por është *verbatim* Fjalë e Zotit; shqiptimi, dëgjimi e shkrimi i Kur’anit, do të thotë pjesëmarrje në “parfumin” e të shenjtës, e cila burimin s’e ka prej kësaj bote. Vetë tingujt, geramat, forma, përmbajtja e kuptimi i Kur’anit janë Hyjnore. Si rrjedhojë, si të tilla, janë të papërkthyeshme.

Nëse kujtojmë klisheën italiane *traduttore traditore* (përkthyes tradhtar), ajo na tregon për pamundësinë e përkthimit të përsosur të çfarëdo teksti, e aq më tepër të një teksti të shenjtë me shtresime kuptimesh, diçka për të cilën do të flasim më poshtë. Studiuesi A. J. Arberry me të drejtë e pat quajtur përkthimin e tij të Kur’anit ‘interpretim’ – *Koran Interpreted* – dhe në hyrje shprehet kështu: “Retorika dhe ritmi i arabishtes së Kur’anit janë aq të veçanta, aq të fuqishme, aq tronditëse, saqë, për nga vetë natyra e gjërave, çdo version [përkthimi]

doemos do të jetë vetëm një kopje e gjorë e madhështisë shkëlqyese të origjinalit.”³ Kjo s’do të thotë se Kur’ani nuk duhet përkthyer në tjetër gjuhë – në fakt krejt e kundërta⁴ – por duhet që përkthyesit të jenë njohës të shkëlqyer të gjuhës së Kur’anit dhe asaj në të cilën përkthehet, të traditës shumë të pasur të komentimeve, nuancave, e konteksteve të fjalëve e vargjeve, ndërsa duhet të kihet gjithmonë parasysh se, siç pohon autori Sells, “të gjithë përkthimet përfundimisht janë vetëm qasje”.⁵

Sidoqoftë, problemi nuk qëndron vetëm te pamundësia e përkthimit të Kur’anit nga pikëpamja

3. A. J. Arberry, *Koran Interpreted* (New York: Touchstone, 1996), hyrje.

4. Shih esenë nga Joseph E. B. Lumbard, ‘The Quran in Translation’, në *The Study Quran: A New Translation and Commentary*, Ed. Seyyed Hossain Nasr, Caner K. Dagli, Maria Massi Dakake, Joseph E. B. Lumbard, Mohammed Rustom (Harpercollins, 2015), f. 1601-1606. Ky përkthim, fryt i një pune 10 vjeçare dhe i pari i këtij lloji në një gjuhë perëndimore, shoqërohet nga komentimet e ekzegjetëve tradicionalë myslimanë nga epoka të ndryshme si Ṭabarīu (v. 923), Fakhr ed-Din Rāzīu (v. 1210), Ismail Hakkī Bursevīu (v. 1725), Ibn ‘Akhībah (v. 1809), Sejjid Muḥammed Husein Ṭabāṭabā’ī (v. 1981), e shumë të tjerë.

5. Sells, *Approaching the Qur’an*, f. 22. Për sa i përket Kur’anit në shqip, duhet të thuhet se ka akoma shumë punë, pasi përkthimet e disponueshme – ndërsa patjetër të vlefshme si përpjekje fillestare – kanë mangësi serioze në disa nga kushtet që përmendëm, përfshirë edhe njohjen e repertorit të mundësive shprehëse që një gjuhë e lashtë si shqipja është e aftë të ofrojë.

sintaksore apo gramatikore. Ajo çka është pakrahasueshmërisht më e rëndësishme është humbja e hirit hyjnor dhe e transformimit shpirtëror nëse Kur’ani nuk recitohet në arabisht gjatë ritualeve të caktuara. Për myslimanët, këndimi i Kur’anit është prani e një jehone Qiellore, e cila prek trupin, mendjen, e shpirtin, e mbetet realiteti qendror i Islamit dhe “bota në të cilën jeton myslimani. Ai lind me të, përderisa fjalia e parë që i këndohet në vesh myslimanit të sapolindur është Shehadeti, i përmbajtur në Kur’an. Ai mëson pjesë të caktuara të tij që në fëmijëri dhe fillon të përsërisë disa prej formulave të tij qëkur nis të flasë. Ai rishqipton disa nga suret e tij në lutjet ditore. Ai martohet nën këndimin e pjesëve të Librit të Shenjtë dhe, kur vdes, atij i lexohet Kur’an. Kur’ani është pëlhura me të cilën endet jeta e myslimanit; fjalitë e tij janë si fije nga të cilat thuret lënda e shpirtit të tij.”⁶ Për ta qartësuar rëndësinë qendrore të gjuhës së Kur’anit në Islam duhet t’u hedhim një sy traditave të tjera.

Ka tradita të cilat kanë në qendër themeluesin e tyre, që e njohin si “zbritje Hyjnore” – në terma hinduiste, *avatar* – e mishërim të vetë “Fjalës së Zotit”. Tradita të tilla nuk varen nga një gjuhë e shenjtë, pasi vetë themeluesi është zbritja, forma

6. Sejjid Husein Nasr, *Ideale dhe Realitete të Islamit*, shqip. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2008), f. 59.

e jashtme e Fjalës. Për shembull, “në Krishterim vetë Krishti është Fjala e Zotit⁷ dhe nuk ka rëndësi nëse mesha mbahet në greqisht, latinisht e madje arabisht ose persisht, që të mund të merret pjesë në ‘gjakun dhe trupin’ e Krishtit. Në kishën katolike latinishtja ishte gjuhë liturgjike, jo e shenjtë, dhe mbetet liturgjike për katolikët tradicionalë pas Vatikanit II”⁸. Një tjetër shembull, jashtë traditave abrahamike, është Budizmi⁹, tekstet e shenjta të të cilit mund të gjenden në sanskritisht, në gjuhën pale, në atë tamile, tibetiane, kineze, japoneze, tailandeze, e me radhë. Jo se nuk kanë rëndësi tekstet

7. “Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne.” (Gjoni, 1:14).

8. Nasr, *Ideale dhe Realitete*, f. 63.

9. Shpesh i keqkuptuar, Budizmi është quajtur nga shumë studiues perëndimorë traditë ateiste, kur, **në fakt**, ajo është traditë jo-teiste; domethënë, mban heshtje absolute për Polin Objektiv të ekzistencës, heshtje e cila komenton në mënyrë elokuate vargun “Zoti është lart çdo gjëje që ata e përshkruajnë” (XXXVII: 180). Nga ana tjetër, Budizmi thekson kultivimin e shpirtit nëpërmjet një etike të detajuar duke u përqendruar, në terma islame, te fakti se Zoti është më afër njeriut se “damarët e qafës së tij” (L:16). S’mund të ndalemi më gjatë pa u larguar nga tema në fjalë, por mund të shihet eseja ‘Buda në Kur’an?’ nga Hamza Jusuf Hanson në librin e Dr. Reza Shah-Kazemit, *Common Ground Between Islam and Buddhism* (Louisville, KY: Fons Vitae, 2010); si edhe Marco Pallis, *The Way and the Mountain: Tibet, Buddhism, and Tradition* (IN: World Wisdom, 2008), një libër me shpjegime ndër më depërtueset mbi traditën e Budizmit.

e Budizmit, porse përparësia është te *avatar*¹⁰ vetë, Buda. Në traditën budiste vetë forma e trupit të Budës¹¹, shprehja e fytyrës së tij, e shfaqosur nga çdo gjurmë egoje, ka funksion sakramental pasi fton drejt një prehjeje të patundshme, e cila arrihet veç me çlirimin nga vargonjtë e dëshirave pafund që burojnë, sipas Budizmit, nga “tre helmet”: zemërimi, lakmia dhe injoranca¹².

Nga ky këndvështrim, Krishterimi dhe Budizmi ngjasojnë (megjithëse dallojnë në të tjera aspekte), por në tradita si Islami, Judaizmi dhe Hinduizmi¹³

10. Për fat të keq, ky term keqpërdoret e keqinterpretohet rëndom sot në media. Në mënyrë të ngjashme dëgjojmë shprehje të papërshtatshme si meka ose bibla e “sportit”, “tregtisë”, “artit”, e të tjera. Në fakt, këto janë simptoma çoroditjesh të brendshme që doemos pasqyrohen jashtë. Njeriu nuk mund të jetojë pa fe. Në mungesë të feve autentike do të krijojë të rreme, secila me avatarin, mekën, apo biblën e vet të përkohshme.

11. Krejtësisht e diktuar sipas rregullave e kanoneve tradicionale dhe ndryshon kryekëput nga degradimi e idhujtaria e statujave të arabëve para Islamit; shih kapitullin ‘The Image of Buddha’ në librin *Sacred Art in East and West: Its Principles and Methods*, trans. Lord Northbourne (Middlesex: Perennial Books, 1976) nga Titus Burckhardt, autor i cili është përkthyer edhe në shqip; *Arti i Islamit: Gjuba dhe Kuptimet*, shqip. Vehap Kola (Shkup: Logos A, 2012).

12. Këto “helme” burojnë nga shpirti cytës, *nefs’ul ammarah* (XII:53), nëse përdorim një term kur’anor.

13. Në fakt, në Hinduizëm, avatarët shihen

themeluesi¹⁴ është i dërguari me Fjalën e Zotit dhe Shpallja vjen si libër. Gjuha e librit, e shpalljes, është gjuha në të cilën Zoti providencialisht vendosi të flasë dhe, si e tillë, është e shenjtë, qoftë nga përmbajtja, qoftë nga tingujt e fjalëve, qoftë nga kuptimi. Si rrjedhojë, një hebre amerikan në Brooklyn, New York, për shembull, nuk mund të lexojë Teuratin ritualisht në tjetër gjuhë përveç hebraishtes, as nuk mund të shqiptojë të tjera formula rituale në tjetër gjuhë pa i zhveshur ato nga “Prania Hyjnore”. Po ashtu me Vedat në Hinduizëm; një brahmin nuk mund të kryejë ritualet as në gjuhën hindu, që është gjuha e parë e shumë indianëve, as në ndonjë nga qindra gjuhët e dialektet e subkontinentit indian, as në anglisht nëse është nga komunitetet indiane në Britani, por vetëm në sanskritisht. Pra, Budizmi nuk varet nga sanskritishtja, gjuha që foli Buda, e as Krishterimi nuk varet nga aramaikishtja, gjuha që foli Krishti; siç e pamë, në këto tradita ata vetë përfaqësojnë Logosin, Fjalën e Zotit. Ndërsa Islami, Judaizmi dhe Hinduizmi¹⁵ varen nga arabishtja,

edhe si Fjalë e Zotit, edhe si të dërguar me Shpallje.

14. Themeluesi këtu nuk nënkupton krijuesin apo filluesin e diçkaje me kuptimin e cekët të fjalës (citim i redaksisë).

15. Islami si shpallja e fundit është për nga natyra universale e me fuqi integruese providenciale (por jo asimiluese) dhe këtu dallon nga Judaizmi që është kryesisht për hebrejtë, apo Hinduizmi kryesisht për

hebraishtja dhe sanskritishtja, përkatësisht, jo sepse janë gjuhët në të cilat folën Muhamedi e Moisiu, apo Rama e Krishna, paqe qoftë mbi të gjithë ata, por sepse janë gjuhët në të cilat Zoti zbriti Fjalën Hyjnore – Kur’anin, Teuratin, Vedat.

Në këtë kontekst, është krejt pa vend kritika ndaj myslimanëve joarabë, e shqiptarë në veçanti, që kryejnë namazin në arabisht, jo në gjuhë amtare. Këto kritika vijjnë kryesisht, por jo vetëm, nga studiues perëndimorë, ngaqë e kanë të vështirë të kuptojnë rolin qendror të një gjuhe të shenjtë pasi Krishterimi nuk ka një të tillë, siç u përmend edhe më lart. Sejjid Husein Nasr, profesor i studimeve islame në universitetin George Washington, e shpjegon domethënien e arabishtes së Kur’anit duke u shprehur si më poshtë:

Efikasiteti i lutjeve kanonike (şalāh), përgjërimeve (du‘ā) dhe thërritjeve (dhikr) qëndron jo vetëm te përmbajtja, por edhe te vetë tingujt dhe kumbimet e gjuhës së shenjtë. Feja nuk është filozofi ose teologji, e nisur vetëm për rrafshin mendor. Ajo përbën metodë integrimi të krejt qenies, duke përfshirë psikikën e truporen. Gjuha e shenjtë shërben pikërisht si mjet providencial, me anë të të cilit njeriu arrin jo vetëm

hindutë. Themi ‘kryesisht’, sepse ka raste konvertimi në Judaizëm e Hinduizëm nga njerëz që s’janë çifutë apo hindu, por ndryshe nga Islami, ato përbëjnë përjashtime e jo normën.

të mendojë për të vërtetat e fesë, që është vetëm për njerëz të një mendësie të caktuar, por të marrë pjesë me tërë qenien e tij në një Normë Hyjnore. Kjo e vërtetë zbatohet universalisht e shpaloet veçanërisht qartë në rastin e Kur'anit, formulat dhe vargjet e të cilit janë gurë udhëzues për jetën e myslimanit dhe përsëritja e vazhdueshme e të cilave i siguron njeriut një strehë hyjnore në trazirën e ekzistencës së tij tokësore.¹⁶

Efikasiteti dhe qëndrueshmëria e këtyre formulave të shenjta kur'anore demonstron qartë edhe në mbijetesën e të tilla fjalëve në shqipen e përditshme – si *inshallah*, *mashallah*, *kismet*, etj., – me gjithë kundërvënien komuniste ndaj botëkuptimit tradicional, e cila jo vetëm që s'u mjaftua me burgimin dhe eliminimin fizik të dinjitarëve të fesë, por shkoi deri atje sa të ndryshonin apo fshinin fare deri fjalët e këngëve që sillnin ndërmend Zotin. Ky gjenocid gjuhësor e kulturor nuk qe rastësi, sepse këto nuk ishin thjesht fjalë, por latuese të një botëkuptimi të rrënjësor në Hyjnoren, në antitezë të plotë me atë materialist të propaganduar zyrtarisht. Në fjalët kur'anore kumbimi, kuptimi dhe efikasiteti janë të pandara; për shembull, hiq urimin *ma'shallah* (ashtu siç do Zoti) pas refrenit “sa bukur na ka dalë nusja” dhe jo vetëm që kënga nuk është më e njëjta, por as dasma s'është tamam

e plotë. Ose, çdo prind e shqipton fjalën *ma'shallah* edhe si urim për fëmijën e vet, edhe si mbrojtje, por kur *ma'shallah* përkthehet as urimi, as mbrojtja, s'është më e njëjta. Kur ruajtja e formulave të tilla në origjinalin e arabishtes kur'anore është e pandashme nga efikasiteti i tyre dhe hiri që ato teçojnë, atëherë kjo vlen edhe më shumë kur bëhet fjalë për vargje apo sure të tëra. Duhet të jetë e qartë tashmë pse ritualet islame, nëse duhet të jenë operative, s'mund të kryhen në tjetër gjuhë përveçse arabishtes së Kur'anit. Shtojmë se shprehje si *inshallah* (në dashtë Zoti) janë përdorur e përdoren krejt natyrshëm edhe nga besimtarë të krishterë pasi shpirtërorja i flet shpirtërores dhe jo vetëm që nuk stonojnë aspak, por janë në shtëpinë e vet në një univers shpirtëror të krishterë, e jo vetëm¹⁷.

Ka edhe diçka tjetër që e zbeh kritikën ndaj përdorimit të arabishtes si gjuhë adhurimi për shqiptarët, apo për joarabët në përgjithësi. Shpesh në programe e spektakle televizive shqiptare dëgjojmë që këndohet anglisht, ose futen edhe fjalë apo refrene anglisht në këngë shqip, edhe pse shumë e këngëtarë nuk ia dinë fare kuptimin këngëve që këndojnë. Nuk është as e rastësishme që këngët në anglisht janë më të shpeshtat (në

17. Edhe në Indi, p.sh., ka shumë fjalë e shprehje të ngjashme që janë integruar natyrshëm në fjalorin e përditshëm të hinduve.

16. Nasr, *Ideale dhe Realitete*, f. 64-65.

frëngjisht ose italisht më rrallë), jo ato në rusisht, japonisht, apo svahili. Anglishtja është gjuha e shtetit më të fuqishëm në këtë shekull dhe arsyen që shqiptarët, e jo vetëm, e ndiejnë nevojën të këndojnë apo dëgjojnë këngë në këtë gjuhë, qoftë edhe pa ia ditur kuptimin, duhet ta kërkojmë te nevoja për t’iu përshtatur e afruar asaj çka gjykohej si kulturë superiore. Kjo s’është për t’u çuditur, pasi ka ndodhur përgjatë historisë së njerëzimit; gjuhët e kulturat që janë gjykuar superiore¹⁸ janë imituar, ose imponuar. Nga një aspekt, media është mjet tejet më imponues se çdo ushtri dhe nëse epoka e kolonializmit fizikisht ka mbaruar, psikologjikisht është në lulëzim pothuajse kudo, jo vetëm në botën islame.

Patjetër, argëtimi apo spektakli nuk janë në rang me realitetin e adhurimit, por nëse kritika drejtohet ndaj besimtarëve se nuk kryejnë ritualet në gjuhën amtare, atëherë pse kursehet ndaj atyre që po argëtohen e argëtojnë në gjuhë të huaj? Kjo është kritikë selektive, doemos me prapavijë ideologjike, jo logjike. Nëse argëtimi në gjuhë të huaj shihet si pjesëmarrje në *zeitgeist*-in, në shpirtin e ideve të modës së kohës që shkojnë

18. P.sh., *kantigat*, hymnet devocionale për Shën Marinë, që akoma këndohen sot, mbreti spanjoll Alfons i Urti (v. 1284) i kompozoi në formën e *zexhel*-it, një lloj poezie arabe e improvizuar me rimë e ritëm. Titus Burckhardt, *The Moorish Culture in Spain*, trans. Alisa Jaffa (McGraw-Hill, 1972), f. 109.

e vijnë në varësi të rrethanave, për myslimanët adhurimi në arabishten e Kur’anit është pjesëmarrje në Fjalën Hyjnore, pjesëmarrje e cila është e një mode metakohore – nëse mund të shprehemi kështu – e rrënjosur në të tashmen e përhershme, që është përtej kohës, pasi vetë kjo e fundit buron prej saj.¹⁹

Pyetjes se pse Zoti zgjodhi arabishten për Kur’anin, e jo shqipen apo gjermanishten, mund t’i jepet përgjigje me të tjera pyetje: Pse Zoti vendosi që Krishti të lindte në Bethlehem dhe jo në Paris? Pse Moisiu çau më dysh ujërat e Detit të Kuq e jo atij Mesdhe? Pyetje të tilla janë të shtruar keq dhe s’para kanë kuptim. Në një botëkuptim tradicional janë Urtia e Vullneti Hyjnor ato që vendosin se ku lindin profetët apo cilat janë gjuhët në të cilat Librat e Shenjtë “flasim”²⁰ dhe jo rrethanat e kontigjencat historike, ekonomike e sociale, siç pretendojnë disa studiues²¹.

19. Shih Ananda K. Coomaraswamy, *Time and Eternity* (Artibus Asiae, 1947), për një shtjellim mjeshëtor të doktrinës së kohës dhe përjetësisë në traditat e Greqisë së Lashtë, Hinduizmit, Budizmit, Krishterimit dhe Islamit.

20. Shih: Martin Lings, *Ancient Beliefs Modern Superstitions* (Cambridge: Quinta Essentia, 1991), f. 8-15.

21. Nga kjo pikëpamje, feja është thjesht një tjetër fenomen i reduktueshëm te mekanizmat shoqërore, apo te nevojat psikologjike, apo te mizoria e hipokrizia e klasave sunduese, apo te luhatjet e historisë; shkurt, përfundimisht një iluzion, pa asgjë

Siç e thamë, njohja në arabisht e Fatihasë bashkë me tre-katër sure të tjera të shkurtra – doemos, edhe e kuptimit të tyre – janë më se të mjaftueshme për ritualet e përditshme. Për më tepër, gjejmë jo pak shembuj *evlijash* që as dinin të flisnin as të lexonin arabisht.²² Pra, njohja e gjuhës arabe nuk garanton superioritet nga ana shpirtërore; në fakt nuk garanton as besimin vetë, nëse kujtojmë se njerëz si Ebū Xhehli ose Ebū Lehebi, dy nga kundërshtarët më të betuar të Profetit dhe Islamit, jo vetëm e njihnin arabishten, por ishin edhe gojëtarë mjaft të zotë.

Kjo nuk do të thotë assesi që studimi i arabishtes së Kur'anit është lënë pas dore nga myslimanët joarabë, në fakt vërehet krejt e kundërta. Ndërsa kultivimi i arabishtes në myslimanë joarabë ka

qenë pjesë qendrore e arsimit fetar si mjet ndihmës në të kuptuarit e Fjalës Hyjnore dhe pjesëmarrjes në Prezencën e Saj, s'ka pasur asnjëherë parakusht që popullata e grupe etnike të arabizohen për të qenë myslimanë. Arabët janë më pak se %15 e të gjithë myslimanëve dhe historia e Islamit e dëshmon larminë e madhe të kombeve e grupeve etnike, që nga Kina e Azia Juglindore, në Indi e Persi, Levant, Afrikë, Evropë²³, e shekullin e fundit edhe në Amerikën e Veriut e të Jugut²⁴.

Ka pasur përpjekje nga ideologë nacionalistë arabë për ta instrumentalizuar arabishten, pasi nacionalizmi pan-arab (*al-kaumiyya al-`arabijja*), i ngjashëm me atë në Ballkan e gjetkë, duke lartësuar gjuhën, letërsinë e kulturën e arabëve, kërkoi ta përdorte gjuhën e Kur'anit dhe Islamin si mjete për të ndërtuar komb-shtete arabe të lidhura nga një trashëgimi e përbashkët. Kjo

hyjnore, pa asgjë reale. Për një kritikë të premisave të tilla shih edhe Fatos A. Kopliku, Diktatura e Sasisë, *Zani i Naltë*, nr. 12 (165), f. 18-35.

22. P.sh., Abu Hafs al-Haddad (v. 879), një kovaç nga Nishapuri, ose Abu Hassan Kharakāni, një figurë karizmatike, të dy persë analfabetë dhe nuk dinin fare arabisht, konsiderohen nga evlijatë më të mëdhenj të periudhës së hershme të Islamit; shih kapitujt përkatës në Farīd ud-Dīn 'Aṭṭār, *Muslim Saints and Mystics: Episodes from the Tadbkirat al-Auliya (Memorial of the Saints)*, trans. A. J. Arberry (London: Penguin Books, 1990). Të kihet parasysh se analfabetizmi nuk është njëlloj me injorancën; shih Ananda K. Coomaraswamy, *The Bugbear of Literacy* (London, 1949).

23. Kujtojmë se prania e Islamit në Evropë daton nga viti 711 e.s. në Gadishullin Iberik. Pas rreth tetëqind vitesh, rreth shek. XV-të, Gadishulli Iberik me atë Ballkanik “ndërruan dorë”; i pari kaloi nën sundimin e monarkive katolike të Spanjës e Portugalisë, ndërsa Ballkani në sundimin e dinastisë myslimane të Osmanëve. Pra, ka më se 13 shekuj që Islami është pjesë e Evropës; ky është fakt.

24. Për një panoramë të larmisë demografike, etnike e kulturore të Islamit të shihet Seyyed Hossain Nasr, *Islam: Religion, History, and Civilization* (Harper San Francisco, 2003), f. 15-24; Kenneth Cragg, *The House of Islam* (Belmont, CA: Wadsworth, 1975), f. 122.

ideologji ishte në kundërshtim me doktrinën islame, e cila ka një karakter thellësisht supra-nacional, racor, apo lingvistik. Ajo nuk zuri vërtet rrënjë në masat e myslimanëve tradicionalë arabë që ndiqnin udhëzimet kur'anore dhe profetike, të cilat nuk njohin tjetër hierarki përveç diturisë, devotshmërisë dhe veprave të mira²⁵. Ymeti, bashkësia islame, ka qenë e mbetet një mozaik kombesh, me një larmi që secila në mënyrën e vet përpiket të pasqyrojë *teuhîd*-in, unitetin e pandashëm të Zotit.

Si të lexojmë një tekst të shenjtë?

Jo pak njerëz hasin vështirësi kur lexojnë tekste të shenjta, apo edhe vepra me përmbajtje shpirtërore²⁶. Në do të përqendrohemi te libri i shenjtë i Islamit, Kur'ani, një tekst që nuk lexohet thjesht “shtriquar gjatë një fundjave me shi”²⁷, siç thotë historiani i religjioneve, Huston Smith. Kjo ndodh pasi, si çdo tekst i shenjtë, s’para hapet e zbulon kollaj

25. Referencat janë të shumta por po citojmë vetëm dy, një nga Kur'ani, një nga hadithi: “A janë të barabartë ata që dinë me ata që s’dijnë?” (XXXIX:9); “Arabi nuk ka epërsi mbi jo-arabin, sikurse jo-arabi mbi arabin; as i bardhi mbi të ziun e as i ziu mbi të bardhin, përveçse në devotshmëri e vepra të mira”, Imam Aḥmed, 22391; Silsilat al-Sahih, 2700.

26. Shih p.sh. Martin Lings, *The Sacred Art of Shakespeare: To Take Upon Us the Mystery of Things*, 4th ed. (VT: Inner Traditions, 1998).

27. Huston Smith, *The World's Religions* (HarperCollins, 2009), f. 233.

të fshehtat e veta. Imam Xha’fer Şādiku (v. 765) thotë se Libri i Zotit “përmban katër gjëra: shprehjen e shpallur (*ibāreh*), aludimin (*ishāreh*), kuptimin e fshehtë të lidhur me botët mbindijimore (*laṭā’if*), dhe të vërtetat e përsëritshme (*ḥakā’ik*). Shprehja tekstuale është për masën (*awāmm*); aludimi për elitën (*khawāṣṣ*); kuptimi i fshehtë për miqtë e Zotit (*evlijā’*), ndërsa të vërtetat shpirtërore për pejgamberët (*enbijā’*).”²⁸

Kuptimi i shtresuar i teksteve të shenjta konfirmohet edhe nga tradita të tjera. Rabini Ishmael (v. 135), për *shembull*, një nga *Tannaim*-ët, mësuesit e urtë të Judaizmit, duke komentuar vargun biblik “A nuk është fjala ime si zjarri?”, thotë Zoti, “dhe si një çekiç që thyen gurin?” (Jeremia 23:29), thotë se ashtu si çekiçi që kur godet lëshon shumë shkëndija, ashtu edhe një fjalë e vetme hyjnore bart shumë kuptime.²⁹

Dante, në *Komedinë Hyjnore*, për një çast e ndal rrëfimin e u thërret atyre që kuptojnë të vënë re doktrinën e fshehur pas perdes së vargjeve të çuditshme.³⁰ Ndërsa në veprën e tij

28. Cit. nga Nasr, *Ideale dhe Realitete*, f. 75-76. Shih edhe *Spiritual Gems: The Mystical Qur’an Commentary Ascribed to Ja’far al-Şādiq*, trans. & anot. Farhana Mayer (KY: Fons Vitae, 2011), f. 1.

29. Cit. nga Azzan Yadin, *Scripture as Logos: Rabbi Ishmael and the Origins of Midrash* (PA: University of Pennsylvania Press, 2013), f. 70.

30. *Ferri*, 9. 61-63.

Convivio, poeti florentin shpjegon në detaj natyrën e katër kuptimeve të shtresuara në Bibël: atij literal, alegorik, moral dhe anagogjik.³¹ Ky i fundit është interpretim thellësisht shpirtëror, përtej rrokjes së shqisave – për *shembull*, në kuptimin anagogjik eksodi i izraelitëve nga Egjipti përkon me largimin e shpirtit nga gjendja *mëkatore në këtë botë për në “sferat e lavdisë së përbershme”*.

Mewlānā Xhelāl ed-Dīn Rūmīu në *veprën e tij* *Fīhi mā fīhi* shprehet kështu për Librin e Shenjtë:

Kur’ani është si një nuse që s’jua tregon fytyrën, sado t’ia ngrini velin. Të kundruarit tuaj të tij pa arritur dot hare dhe zbulim, është për shkak se vetë akti i ngritjes së velit ju ka larguar e mashtruar, kështu që nusja ju është shfaqur si e shëmtuar, tamam sikur thotë: “S’jam unë ajo bukuri.” Kur’ani është në gjendje të shfaqet në çdolloj forme të dojë. Por nëse nuk ia ngrini velin dhe kërkon veç kënaqësinë e tij të mirë, duke ia ujitur dheun e duke u kujdesur për të nga larg, në kërkim të asaj që e kënaq më shumë, ai do t’jua tregojë fytyrën pa ia ngritur ju velin.³²

Lindin pyetjet: Po si ta lexojmë Kur’anin, apo çdo libër të shenjtë? Cilat janë kushtet apo kualifikimet? A mund ta kuptojë njeriu i thjeshtë, apo tekstet e shenjta janë të mbyllur për shumicën? Përgjigja pjesërisht u dha më lart; në tekstet e shenjta ka diçka për këdo, sipas aftësisë dhe

dëlrësisë së tij/saj. Sachiko Murata dhe William Chittick, profesorë të Studimeve Aziatike në Universitetin Stony Brook të New York-ut, nënvizojnë se “[p]lasuria e gjuhës së Kur’anit dhe aftësia e saj pranuese në raport me interpretimet e ndryshme ndihmon që të shpjegohet se si ka mundur ky libër i veçantë t’i japë trajtë një prej qytetërimeve më të mëdha të botës. Nëse do të kishin kuptuar të gjithë ekzaktësisht të njëjtën gjë prej tekstit, feja nuk do të ishte përhapur kurrë aq gjerësisht sa është përhapur. Sepse Libri duhej t’u drejtohej si të thjeshtit dhe të sofistikuarit, si bariut edhe filozofit, si shkencëtarit edhe artistit”,³³ pavarësisht ç’gjuhë flisnin dhe këtu e kemi fjalën edhe për gjuhët e mendjes e të zemrës, jo veç atë të folur. Ndërsa nxiste unitetin e formës së tekstit në arabisht, Kur’ani nxiste larminë e kuptimit, çdo fjalë si një çekiç që lëshon shumë shkëndija, nëse përdorim metaforën e lartpërmendur.

Mirëpo, kjo “nuk do të thotë se Islami është kakofoni interpretimesh kontradiktore”³⁴, pasi për të depërtuar kuptimet e Kur’anit, që “nusja të na tregojë fytyrën”, ka shumë parakushte. Filozofi dhe mendimtari Şadr ed-Dīn Shīrāzī, i njohur edhe si Mullā Şadrā (v. 1640), rendit disa nga kushtet “absolutisht

33. Sachiko Murata dhe William C. Chittick, *Vizioni i Islamit*, shqip. Sokrat Ahmataj (Tiranë: Fondacioni Rumi, 2008), f. 26.

34. *Po aty*, f. 27.

31. *Convivio*, II.

32. Cit. nga Nasr, *Ideale dhe Realitete*, f. 74.

të domosdoshme për të depërtuar simbolet kur'anore". Sipas tij, interpretuesi ose komentuesi duhet:

(1) Të ketë durim e dëlirësi.

(2) Të pohojë vazhdimisht shehādetin.

(3) T'i nënshtrohet disiplinës shpirtërore.

(4) Të kalojë kohë në halvet³⁵.

(5) Të përmbahet nga dijet dhe tiparet e hallkut.

(6) Të mësojë "shkencën e notimit në Oqean (*baḥr*)".

(7) Ta njohë "gjuhën e zogjve"³⁶ (referim ndaj 27:16 dhe të folurit aluziv të sufive)

(8) Ta kuptojë "gjuhën e Sundimit" (*melekūt*).

(9) Të ketë hyrje tek të fshehtat e "sferave të Hyjnisë (*lahūt*) dhe të Pamposhtjes (*xhabarūt*)."³⁷

Ndërsa Rashīd al-Dīn Majbudūi (v. 1135), autori i komentimit klasik kur'anor *Kashf al-asrār* ("Çvelimi i mistereve"), thotë se kualifikimi

35. Disiplinë intensive shpirtërore ku besimtari veçohet duke u përqendruar në adhurim, lutje e përkujtim (*dhikr*). Ajo mund të zgjasë nga disa orë, deri në disa ditë (me raste edhe 40 ditë).

36. Mbi simbolikën kur'anore të gjuhës së zogjve shih René Guénon, *The Language of Birds, Studies in Comparative Religion*, Vol. 3, No. 2. (Spring, 1969).

37. Mullā Ṣadrā, *Mefāḥih'ul-ghajb*, 78-79. Cit. nga Mohammed Rustom, *Ngadhënjimi i Mëshirës: Filozofia dhe Shkrimi i Shpallur te Mullā Ṣadrā*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Instituti Kërkimor Ndërkombëtar RUMI, 2014), f. 73.

për sipërmarrjen e një komentimi të Kur'anit është zotërimi i dhjetë disiplinave të dijës: leksikografia (*luḡba*), prejardhja e fjalëve (*ishtikāk*), gramatikë e gjuhës arabe (*naḥw*), recitim Kur'ani (*kirā'a*), biografite (*siyar*), Hadithi, parimet e jurisprudencës (*uṣūl-i fiqh*), vendimet ligjore (*ilm-i ahkām*), marrëdhëniet e veprimet (*mu'āmalāt*) dhe dija e dhuntisë (*mawhibā*).³⁸ Nuk ishte e rrallë që një njeri t'i zotëronte të gjitha këto, siç dëshmohet nga Majbudūi vetë, ose edhe nga bashkëkohësi i tij i famshëm, Imam Ghazzāliu, i cili shton se mjeshhtëria vetëm në njërin nga këto disiplina pa u thelluar në të tjerat është shenjë papjekurie.³⁹ Kurse dija e dhuntisë nuk përvetësohet me anë të studimit por është "dhunti hyjnore dhe frymëzim i përzotshëm" (*mawhibat-i ilāhī wa ilhām-i rabbānī*). Parakusht i saj është dëlirësia e brendshme.

Si arrihet ajo? Mullā Ṣadrā, thënien e Imam Aliut, "Zoti e do guximin, qoftë edhe në mbytjen e një gjarpri", e komenton kështu:

Nuk ka gjarpër si nefsi (egoja) yt, ndaj vrite dhe dëlire nga njolla e bindjeve të rreme dhe e opinionëve të shëmtuara të tij; ose nënshtroje

38. Maybudūi, *Kashf al-asrār* 10:679. Cituar nga Rashīd al-Dīn Maybudūi, *The Unveiling of the Mysteries and the Provision of the Pious*, trans. William C. Chittick (Louisville: Fons Vitae, 2015), hyrje, ix. Ky botim gjendet i plotë edhe online në faqen <http://www.altafsir.com/Books/kashf.pdf>.

39. Cit. *Po aty*.

gjersa të bëhet *muslim* në duart e tua. Në fillim flake si shkopin e Mūsāit, atëherë kape me dorën e djathtë pasi të jetë kthyer në “natyrën e vet të kryehershme” [*sīratihā el-ūlā*, 20:21] dhe prirjen e tij burimore [*fiṭrethā el-aṣlije*]. Atëherë do të bëjë jetë intelektuale, duke u përpjekur për Kthimin [*el-me’ād*] dhe banesën përfundimtare [*el-methwā*].⁴⁰

Me pak fjalë, çelësi i kuptimeve të brendshme të një teksti të shenjtë si Kur’ani është zbraza nga egoja (*nefs*) ose paqtimi i saj; kthimi në “natyrën e kryehershme” siç thotë Ṣadrā. Njerëz të tillë, duke pastruar zemrat nga çdo dëshirë⁴¹, i kthejnë ato në pasqyra ku drita e dijes rrezaton shkëlqyeshëm, një e vërtetë që Naim bej Frashëri e shpreh mjaft bukur:

Dlirë shpirtin, o ti miku besëdëlirë,
Që kështu të gjesh pastaj të Zotit
hir!

Ndrite zemrën, mbaje larg nga
ligësitë

Që të bjerë tek ajo e madhja dritë!⁴²

40. Mullā Ṣadrā, *Mefāṭih’ul-ghajb*, 81. Cit. nga Rustom, *Ngadhbënjimi i Mëshirës*, f. 73.

41. Kur e pyetën Bejazid Bestamiun (v. 874), “Çfarë dëshiron?”, u përgjigj: “Të mos dëshiroj” (Farid ud-Din ‘Aṭṭār, *Muslim Saints*, f. 152-153). Zbraza nga dëshirat, ose qerimi i zemrës siç quhet ndryshe, është temë qendrore në traditën e përsheptshme islame si parakusht për njohjen e vetes, botës dhe Zotit. Dëshirat shihen si vel ose perde mes nesh dhe Realitetit.

42. Poezia “Zoti”, Naim Frashëri, *Ëndërrimet* (Tekhajjulāt), shqip. Vexhi Buharaja (Tiranë: Fondacioni ‘Saadi Shirazi’, 2005). Poezisë së

Në Islam drita konsiderohet *texheli*, vetë-shpalosje hyjnore – “Zoti është drita e qiejve dhe tokës” (XXIV:35) thotë Kur’ani – dhe një nga format e këtij manifestimi është drita e diturisë. “O Zot vendos në zemrën time një dritë” lutej shpesh Profeti.⁴³ Është kjo dritë, thotë Ibn ‘Arabū, që “largon errësirën e injorancës nga shpirti”.⁴⁴ Naimi i quan ata që u gufon kjo dritë në zemër “rrugënjohësit e dijes, zbulimtarët”,⁴⁵ ndërsa Kur’ani “të rrënjosurit thellë në dije” (III:7). Pas Profetit të Islamit, pikërisht interpretimet e njerëzve të tillë janë njohur si udhërrëfyes të vërtetë drejt thellësive të Librit të Zotit.⁴⁶

Naimit i janë projektuar shumë mentalitete e ide, krejtësisht të divorcuara nga tradita shpirtërore e intelektuale islame, së cilës ai i përkiste. Nëse shihen nën këtë dritë atëherë vargjet e tij fillojnë e flasin si interpretuese të kësaj tradite, siç edhe e dëshmojnë në këtë rast vargjet e lartcituara.

43. “O Zot, vendos në zemrën time një dritë, në dëgjimin tim një dritë, në shikimin tim një dritë, në të djathtën dorë një dritë, në të majtën dorë një dritë, para meje një dritë, pas meje një dritë, mbi mua një dritë, poshtë meje një dritë dhe cakto për mua një dritë” (Muslimi, *Musāfirin* 187). Shih edhe Ahmed I 284 për një version të ngjashëm të kësaj lutjeje.

44. *Futūḥāt al-Mekkejje*, II 154.27. Cit. nga William C. Chittick, *The Sufi Path of Knowledge: Ibn Al-Arabi’s Metaphysics of Imagination* (State University of New York Press, 1989), f. 196; shih *po aty*, f. 216-220.

45. Nga poezia “Gjuha e Zemrës”, Naim Frashëri, *Ëndërrimet*.

46. P.sh., ekzegjetët tradicionalë, bashkë me veprat madhore – prozë ose poezi – të

Shtojmë se këto komentime, pa asnjë përjashtim, nuk bien assesi në kundërshtim me kuptimin literal të Librit të Shenjtë dhe as “nuk mund të kenë kurrë as efektin më të vogël mbi urdhëresat dhe ndalimet e Ligjit të shpallur”.⁴⁷ Në fakt, konformiteti me kuptimin literal është edhe prova e vërtetësisë së tyre, qofshin ato edhe më hermeneutiket.

Siç e pamë, ka një sërë parakushtesh për të ndërmarrë interpretimin e Kur’anit. Mirëpo, kur këto nuk përmbushen, kur thellësia e kuptimeve të Kur’anit injorohet ose mohohet fare, atëherë natyrisht përpjekjet e shumë autorëve përëndimorë, ose myslimanë të modernizuar,⁴⁸ për ta studiuar Kur’anin “objektivisht” apo në

mënyrë “akademike”, japin rezultate sipërfaqësore dhe përfundime që shpesh janë projektme të mendësisë së tyre mbi tekstin në fjalë. Por, “...ka prova të mjaftueshme, që i ka sjellë qytetërimi islam, si edhe filozofët, teologët e poetët e mëdhenj, që kanë bërë komente për tekstin e tij, të cilat sigurojnë se problemi qëndron te lexuesit, jo te libri. Nuk ka dyshim që teksti është ndër më të jashtëzakonshmit... Por pikërisht pse është i jashtëzakonshëm, ai nuk ndjek modelet që njerëzit shpresojnë të gjejnë në një libër”.⁴⁹ Theksojmë këtu se shtresimin e kuptimeve të Kur’anit e mohojnë edhe fundamentalistët islamikë, duke injoruar kështu katërmbëdhjetë shekuj traditë shpirtërore e intelektuale islame,⁵⁰ e duke arritur po ashtu në përfundime në kundërshtim me këtë traditë. Është domethënëse se në një shtet si Arabia Saudite librat e Ibn ‘Arabiut, një nga kolosët e traditës shpirtërore e intelektuale të Islamit, veprat e të cilit “janë në thelb hermeneutikë kur’anore”,⁵¹ ndalohen me ligj.

shenjtoreve si Junus Emreja, Rümü, *Hāfezi*, Ibn al-Fāridi, Ibn ‘Arabī, Xhamū, e shumë të tjerë, kanë qenë e mbesin çelësa në qasjen ndaj Kur’anit. Shih edhe esetë nga Walid Saleh, “Quranic Commentaries” në *The Study Quran*, f. 1645-1658; dhe Toby Mayer, “Traditions of Esoteric and Sapiential Quranic Commentary”, *po aty*, f. 1659-1678.

47. Chittick, *The Sufi Path of Knowledge*, hyrje xvi. Ebū Naşr as-Sarrāxh (v. 988), një nga dijetarët e hershëm, thotë se “[n] ganjëherë e Vërteta troket në zemrën time për dyzet ditë, por nuk e lejoj të hyjë pa sjellë dy dëshmitarë, Kur’anin dhe traditën Profetike”; nga *Kitāb al-luma’ fi’-taşawwuf*. Ed. Reynold A. Nicholson (Leiden and London, 1914), 104. Cit. nga Annemarie Schimmel, *Mystical Dimensions of Islam* (Chapel Hill: The University of North Carolina Press, 1975), f. 35.

48. Mund të përmenden autorë si Irshad Manji ose Mohammed Arkoun (v. 2010).

49. Murata dhe Chittick, *Vizjoni i Islamit*, f. 29.

50. Shih esetë nga Timothy J. Winter, ‘Varfëria e Fanatizmit’; dhe nga Joseph E. B. Lumbard, ‘Rënia e dijes dhe shfaqja e ideologjisë në botën islame moderne’ në librin *Islami, fundamentalizmi dhe tradhëtimi i traditës*, ed. Joseph E. B. Lumbard, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Shkup: Logos-A, 2016).

51. Chittick, *The Sufi Path of Knowledge*, hyrje xvi.

Në një departament fizike, për shembull, është normale që profesorët e stafi shkencor të jenë fizikanë. Sigurisht ata s'mund të kritikohen se u mungon objektiviteti në lidhje me fizikën ngaqë vetë janë fizikanë dhe se ia kanë kushtuar jetën studimit të saj. Po ashtu nuk mund të pretendohet se një biolog apo një historian mund ta njohë më me asnjësi e objektivisht fizikën se një fizikan ngaqë mund ta studiojë atë nga "jashtë". Por sipas kritikave moderne, dijetarët tradicionalë myslimanë s'mund të jenë objektivë ngaqë i kanë kushtuar jetën studimit të Librit të Shenjtë. Prandaj, vazhdohet, Kur'ani mund të kuptohet më mirë nga studiues objektivë e asnjans që e studiojnë atë nga "jashtë". Nuk themi se të gjitha studimet nga perëndimorët janë të pavlefshme,⁵² por shumica i qasen Kur'anit me një mori presupozimesh e hipotezash si për shembull: Kur'ani është sajim i Muhamedit, huazim nga traditat hebraike e kristiane, përpilim i mëvonshëm, ose mohohet fare realiteti i shpalljes, jo veç në Islam, por parimisht. Bazuar në presupozime të ngjashme, studime të tilla kanë arritur në përfundime

52. Çdo studiues i qytetërimit islam, mysliman apo jo, i detyrohet mirënjohje të thellë punës kolosale të eruditëve si Louis Massignon, Sir Hamilton A. R. Gibb, Reynold A. Nicholson, Henry Corbin, A. J. Arberry, Annemarie Schimmel, e të tjerë, të cilët trajtuan përherë seriozisht burimet tradicionale.

që janë të papranueshme jo vetëm nga besimtarët, por edhe nga çdo lloj logjike e shëndoshë. Një **Majbudī**, një Imam **Ghazzālī**, apo një **Mullā Şadrā**, autorë të tillë do i konsideronin të pakualifikuar si interpretues të Kur'anit.

S'duhet harruar se subjekti njohës e objekti që njihet nuk janë dy realitete të shkëputura por të ndërlidhura; një Sër Aleks Ferguson e njuh futbollin shumë më mirë se një ushtri gazetarësh enciklopedikë, ose një veteran di diçka shumë më thelbësore për luftën sesa shumë historianë që vetëm kanë shkruar vëllime për të... Arsyeja qëndron në atë se njohja vërtet objektive nuk kufizohet te vëzhgimi, por kërkon pjesëmarrjen e subjektit njohës, dhe grada e njohjes është në varësi të kësaj pjesëmarrjeje. Si rrjedhojë, sado e thellë të jetë njohja e violinës, për shembull, nga një akademik apo kritik arti, kjo njohje mbetet e lëvozhgët në krahasim me njohjen thelbësore të një mjeshtri si Ethem Qerimi, për të cilin violina është pothuajse gjymtyrë e tij. Njohja e llojeve të drurit të bredhit për violinë, ose njohja e historikut të saj, bart rëndësinë e vet, por është pakrahasueshmërisht inferiore ndaj njohjes dhe aftësisë për ta bërë violinën të "qajë" – dhe publikun bashkë me të – sepse një Ethem Qerim e njuh violinën duke jetuar vetë çdo melodi të saj.

Edhe pse analogjia nuk është e të njëjtit rang hierarkie të realitetit, prapë besojmë se e qartëson faktin se askush s'mund ta njohë Kur'anin më mirë se vetë Profeti Muhamed dhe ata urtarë e evlia që e pasojnë brez pas brezi, të cilët jo vetëm i njohin, por edhe i jetojnë mësimet e Librit të Shenjtë. Kur'ani nuk mund të studiohet seriozisht, qoftë nga myslimanë apo jo, pa u këshilluar me thëniet e Profetit e komentimet e figurave madhore shpirtërore e intelektuale të traditës islame. Nëse për të kuptuar thellë një art violine

duhet të ndjekim me aq sa është e mundur qasjen e një virtuozi, atëherë, aq më tepër, për të kuptuar sa më mirë Kur'anin, duhet të respektojmë, në mos ndjekim, fjalët e Profetit, evliave e urtarëve⁵³ – virtuozyt *par excellence* të Fjalës së Zotit.

53. Logjikisht, kjo vlen edhe për qasjen ndaj çdo tradite: p.sh., një Shën Agustin (v. 430), ose një Shën Gregor i Palamës (v. 1359) është pikë referimi për të kuptuar traditën autentike të krishterë. Nuk mund të pretendohet njohja e doktrinës së krishterë duke injoruar apo kundërshtuar çfarë shenjtoret e kësaj tradite kanë thënë e shkruar për të.

Një vështrim në familjen ligjore islame. Aspekte juridiko – penale të mbrojtjes të së drejtës së pronës

Prof. asoc. doc. dr. Engjëll Likmeta
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Qemal Likmeta*

Abstrakt

Legjislacioni është një nga themelet më të rëndësishme të familjes ligjore islame. Ligji islam ka të bëjë me vënien në praktikë të mesazhit islam që synon drejtësinë dhe paqen, pavarësisht nga vendi apo koha në të cilën jetojmë. Thelbi i mesazhit islam është ndërtimi me dashuri e pastërti i urave të dialogut të lirë dhe të respektuar në mes të dërguarve të Zotit dhe të kundërtave të tyre në fe. Islami, në vetvete, është një dialog i lirë, i moralshëm dhe logjik, që ndër të tjera sanksionon mospërdorimin e veprimeve kriminale në asnjë aspekt jetësor, duke sanksionuar me të drejtë se “Nuk ka dhunë në fe”. Ndaj, të jesh mysliman, nga një këndvështrim, është më e vështirë, kërkon më shumë përgjegjësi, por edhe po aq delikatesë dhe lartësi, sepse krabas respektimit të parimeve shoqërore, kërkohet dashuri dhe mirëkuptim, dhembshuri dhe butësi, krabas durimit dhe tolerancës kërkohet dije, vullnet, urtësi, ekuilibër, si dhe aftësi sintetizuese e sendërtuese.

1. Hyrje

Familja islame është një ndër familjet kryesore të së drejtës. Ajo është një e drejtë fetare. Rregullat e kësaj të drejte burojnë nga Kur’ani dhe tradita

e jetës së Profetit (a.s.)¹. Vendosja e drejtësisë nuk është një parim të cilin

* Studiuës.

1. Fromont, M., *Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës*, shtëpia botuese “Papyrus”, Tiranë, 2009, f. 15.

e konfirmoi dhe e filloi vetëm Islami, por traditë dhe moto e të gjithë të dërguarve, të cilët predikuan ligjin dhe shpalljen e Zotit².

Legjislacioni është një nga themelet më të rëndësishme të familjes ligjore islame. Ligji islam ka të bëjë me vënien në praktikë të mesazhit islam që synon drejtësinë dhe paqen, pavarësisht nga vendi apo koha në të cilën jetojmë³. Thelbi i mesazhit islam është ndërtimi me dashuri e pastërti i urave të dialogut të lirë dhe të respektuar në mes të dërguarve të Zotit dhe të kundërtave të tyre në fe. Islami, në vetvete, është një dialog i lirë, i moralshëm dhe logjik, që ndër të tjera sanksionon mospërdorimin e veprimeve kriminale në asnjë aspekt jetësor, duke sanksionuar me të drejtë se “Nuk ka dhunë në fe”⁴. Ndaj, të jesh mysliman, nga një këndvështrim, është më e vështirë, kërkon më shumë përgjegjësi, por edhe po aq delikatesë dhe lartësi, sepse krahas respektimit të parimeve shoqërore,

2. El Gazali, *Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë, Tefsir*, shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2007, f. 89.

3. Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i parë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011, f. 4-6.

4. Sytari, M., “Fanatizmi është një entuziazëm që djeg jo një e vërtetë që ndriçon”, *Gazeta MAPO online*, datë 11.08.2014, Për më tepër shih: <http://mapo.al/2014/08/fanatizmi-eshte-nje-entuziazem-qe-djeg-jo-nje-e-vertete-qe-ndricon/> aksesuar online datë 19.08.2014.

kërkohet dashuri dhe mirëkuptim, dhembshuri dhe butësi, krahas durimit dhe tolerancës kërkohet dije, vullnet, urtësi, ekuilibër, si dhe aftësi sintetizuese e sendërtuese⁵.

Caku më i shpeshtë i ligjeve islame është edukimi dhe përsosmëria e personalitetit të individit⁶. Islami konsideron se jurisprudenca është në relacion të pakëputur me autoritetin e Zotit, si dhe që sovraniteti i pushtetit të gjithmbarshëm dhe të padiskutueshëm të Zotit e përfshin të gjithë jetën e njeriut dhe të gjitha punët e tij. Qëllimi i besimit Islam është të vendosë të vërtetën dhe drejtësinë në të gjitha punët dhe nivelet e komunitetit njerëzor⁷.

Po çfarë është ligji në vetvete sipas së drejtës islame?

Ligji është mishërim i Vullnetit Hyjnor lidhur me mësimet specifike, pranimi dhe zbatimi i të cilave i garanton njeriut jetë të harmonishme në këtë botë dhe lumturi në tjetrën. Në Islam, ligji është Hyjnor e jo njerëzor, ngase përbën trupëzimin konkret të Vullnetit të Zotit, sipas të cilit duhet jetuar edhe si individ edhe si pjesëtar i shoqërisë. Ligji përbën udhëzuesin e veprimit njerëzor dhe përfshin çdo aspekt të jetës; duke jetuar sipas tij, njeriu e trajtëson

5. Gylen, F., *Lëkundjet që sollin shënkullin*, shtëpia botuese “Prizmi”, Tiranë, 2012, f. 12.

6. Llari, S., *Islami dhe civilizimi perëndimor*, shtëpia botuese “Drita e jetës”, Prizren, 2004, f. 73.

7. Po aty, f. 76.

ekzistencën e vet sipas vullnetit të Zotit⁸.

Ideja ndërmjet të drejtës dhe besimit është krejtësisht e huaj për botëkuptimin islam dhe pikërisht është kjo arsyeja që si ligji material ashtu dhe ai formal trajtohen të pashkëputur nga besimi fetar⁹. Ligji përmban normën për jetën ideale njerëzore. Në përputhje me natyrën e vërtetë të gjërave, është njerëzorja ajo që duhet t'i përshtatet Hyjnosës e jo anasjelltas¹⁰.

Duke pasur parasysh rolin e madh të njeriut në funksion të dhënies së drejtësisë, në një hadith, thuhet se: “Një ditë drejtësi, është sa dyzet vjet adhurim”¹¹. Në çdo rast, Zoti urdhëron për të gjykuar me drejtësi mes njerëzve¹².

Drejtësia kërkohet në çdo kohë. Nisur nga kjo, në një ajet të sures Maide, Zoti urdhëron, për bashkëveprimin midis njerëzve duke u udhëhequr nga drejtësia dhe korrektësia në marrëdhëniet mes

tyre si dhe, duke tërhequr vëmendjen ndaj veprimeve të padrejta, të kundërligjshme, kur thotë se: “[...] *Ndihmobuni mes veti me të mira dhe në të mbara, e mos bëni mëkate e armiqësi [...] Allahu është ndëshkues i fortë.*”¹³

1.2 Veçori të së drejtës islame

Nëse do t'i referohemi Legjislacionit Islam, mund të themi se Zoti përcakton mirë faktin se çdo person, individ duhet të udhëhiqet nga ligji në jetën e tij. Kështu, shprehimisht, në një ajet kuranor¹⁴ Zoti ka përcaktuar se: “*Për secilin prej jush, ne caktoam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit)*”¹⁵.

Lidhur me liritë mund të themi se, liritë, të gjithë parimet e etikës dhe të dinjitetit njerëzor, në shtetin islam, kanë të njëjtë vlerë, si për shtetasit myslimanë, po ashtu dhe për ata jomyslimanë. Paprekshmëria mbi personalitetin njerëzor është themeli i barazisë ndërnjerëzore e urdhëruar nga Zoti i madhëruar¹⁶.

8. Sistani, S., *Përmbledhje e ligjeve islame*, Tiranë, 2012, f. 15.

9. Shegani, A., *E drejtë penale e krabasuar*, shtëpia botuese “Darmisa” Fier, 1999, f. 37.

10. Po aty, f. 16

11. Kethir, I., *Kandili Ndrriqes, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit, Vol. II*, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor 2008, f. 318.

12. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madhërisbëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 144.

13. Kethir, I., *Kandili Ndrriqes, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit, Vol. II*, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor 2008, f. 466.

14. Do të thotë një ose më shumë fjalë. Ajeti zakonisht është një fjali e thjeshtë ose një fjali e zgjeruar.

15. Kethir, I., *Kandili Ndrriqes, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit, Vol. I*, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 390.

16. Kethir, I., *Kandili Ndrriqes, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit, Vol. I*, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 172.

Parimi që s'ka veprë penale e as dënim përveç asaj të parashikuar në legjislacion, është një parim që vjen i parashikuar edhe në legjislacionin e së drejtës islame. Ky parim zbatohet më përpikëri për sa i takon veprave të tilla penale si vjedhja, plaçkitja etj., vepra këto që janë sanksionuar shprehimisht në librin e shenjtë Kur'anin dhe sunetin, duke përcaktuar edhe dënimin përkatës për to¹⁷.

Në lidhje me shkencën penale mund të themi se, në Kur'an, ndër të tjera, cilësohet edhe përgjegjësia penale. Ligji islam parashikon përgjegjësinë individuale për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme. Kështu, Zoti në Kur'an thotë: “[...] *dëmi i secilit person është kundër vetes. Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit [...]*”¹⁸, dhe se, “*Secili njeri është peng i veprës së vetë*”¹⁹. Pra, sipas këtij formulimi të hershëm mund të themi se: “Çdokush është përgjegjës vetëm për veprat vetjake [...]”²⁰ dhe “[...] askush nuk mund ta bartë barrën e

tjetrit”²¹. Sipas këtij ajeti kuranor na bëhet me dije se askush nuk mund të merret në përgjegjësi civile a penale për veprimet a mosveprimet kriminale të tjetrit. Në vetvete ky është një lajmërim që u drejtohet njerëzve që të mos ndër marrin veprime të kundërligjshme, pasi në ditën e dhënies së llogarisë për to do të lindë përgjegjësia. Kjo urdhëresë vë në dukje parimin themelor në të drejtën penale, përgjegjësinë personale dhe dënimin në bazë të fajësisë dhe refuzon çdo formë të përgjegjësisë për tjetrin.

Ligji islam sanksionon edhe parimin e ndëshkueshmërisë së çdo veprimi kriminal. Askush nuk mund t'i fshihet përgjegjësisë penale e civile nga vepra e kryer në kundërshtim me normat e ligjit islam. Këtë përfundim ne e nxjerrim nëse i referohemi dispozitës kuranore: “*A mos menduan ata që bëjnë vepra të këqija (krime) se do të na shpëtojnë (t'u ikin dënimeve)? Sa i shëmtuar është gjyqimi i tyre!*”²²

1.3 Deklarata e Kajros për të Drejtat e Njeriut në Islam

Islami është një fe për sigurinë, qetësinë dhe paqen²³. Në këtë

17. Sulejmani, Sh., *E drejta penale islame*, pjesa e përgjithshme, Shkup, 2012, f. 70-71.

18. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madhbërishëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 196.

19. Për më tepër shih Kur'an-i, Suretu El-Mudeththir, 38, faqe 802, I.R.C. Dubai, U.A.E.

20. Ramadani, S., *E drejta islame, burimi dhe zhvillimi*, shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2007, f. 65.

21. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madhbërishëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 196.

22. Kethir, I., *Kandili Ndrifues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. VI, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, tetor, 2010, f. 125.

23. Gylen, F., *Dashuri dhe tolerancë*, shtëpia

vështrim, Deklarata e Kajros për të Drejtat e Njeriut në Islam është një mekanizëm ligjor, që ofron një pasqyrë të perspektivës islame për të drejtat e njeriut. Ajo pohon Sheriatin Islam si burim të saj. Qëllimi i kësaj deklarate është të qenët e saj si një udhëzues i përgjithshëm në fushën e të drejtave të njeriut. Sipas kësaj deklarate, në nenin 14 të saj, theksohet se: “Çdokush ka të drejtë në përfitime ligjore pa monopolizim, mashtrim apo dëmtim ndaj vetes apo të tjerëve. Fajdeja është absolutisht e ndaluar”²⁴. Ndërsa në lidhje me të drejtën e pronës deklarata sanksionon se: “Çdo njeri ka të drejtën e të pasurit pasuri të fituar në mënyrë të ligjshme dhe i gëzon të gjitha të drejtat e pronësisë, pa rënë ndesh me veten, të tjerët, ose me shoqërinë në përgjithësi. Shpronësimi nuk është i lejuar me përjashtim të rasteve kur kryhet nxitur nga kërkesat e interesit publik dhe kundrejt një dëmshpërblimi të menjëhershëm dhe të drejtë”²⁵. Po ashtu, në germën “b” të këtij neni theksohet se: “konfiskimi dhe marrja e pasurisë është e ndaluar me përjashtim të një domosdoshmërie të diktuar nga ligji”²⁶.

botuese “Prizmi”, Tiranë, 2012, f. 92.

24. The Cairo Declaration on Human Rights in Islam, article 14. Për më tepër shih: <http://www.oic-oci.org/english/article/human.htm> (aksesuar më datë 07.06.2014)

25. Po aty, Neni 15.

26. Po aty.

Deklarata e Kajros për të Drejtat e Njeriut në Islam mbron edhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Kështu në nenin 16 të saj thuhet se: “Secili ka të drejtë të gëzojë frytet e prodhimit të tij shkencor, letrar, artistik e teknik dhe të drejtën për të mbrojtur interesat morale dhe materiale që rrjedhin prej tij, me kusht që prodhimi i tillë të mos bie në kundërshtim me parimet e Sheriatit”²⁷.

2. Mbrojtja e të drejtës së pronës

Pa ngurrim mund të shprehemi se, Feja islame e respekton të drejtën e pronës dhe pasurinë, sepse ajo është baza e jetës. Nga ana tjetër, e drejta islame e respekton të drejtën e njerëzve për pronë. E drejta e pronës konsiderohet e shenjtë. Askush nuk mund ta cenojë në çfarëdo mënyre qoftë, këtë të drejtë. Janë këto arsyt përse ligji islam e ndalon rreptësisht vjedhjen, grabitjen, përvetësimin e pasurisë së huaj, mashtrimin, dredhinë, mashtrimin gjatë matjes dhe në peshë. Pasuria e fituar në rrugë të paligjshme është e ndaluar për t’u përdorur²⁸.

Sipas traditës profetike, njeriut i bëhet e mundur mbrojtja e pasurisë nga dispozitat kuranore vetëm nëse është besimtar dhe në çdo rast nëse

27. Po aty, Neni 16.

28. Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i dytë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011, f. 563.

pasuria nuk bie ndesh me parimet themelore të së drejtës islame²⁹.

Po ashtu, i dërguari i Zotit, Muhamedi (a.s.) ka urdhëruar: “*Luftoni mos besimtarët por në asnjë rast mos plaçkitni, mos mashtroni, mos masakroni dhe mos vritni fëmijë e as murgjit në manastire*”³⁰. Sipas këtij udhëzimi profetik, kuptohet fare qartë se, ligji islam është i mirë larguar nga veprimet kriminale si vjedhja, mashtrimi, dëmtimi i pasurisë apo i jetës së njerëzve. Njëkohësisht, ai shërben si një mburojë e fortë për kategori të posaçme sikurse janë fëmijët e murgjit. Pra, në rrezen e tij të mbrojtjes përfshihet dhe pasuria e cilitdo person, besimtar ose jo, si dhe fëmijët e përfaqësuesit e besimeve të ndryshme fetare.

1.1 Krimet

Me krim në traditën e legjislacionit nënkuptohet çdo vepër e ndaluar. Vepër e ndaluar është çdo veprim që Ligjvënësi e ka ndaluar të kryhet për shkak të dëmit që ajo sjell në fe, në vetë njeriun, në mendjen, nderin apo pasurinë e tij³¹.

29. Kethir, I., *Kandili Ndriques, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 468.

30. Kethir, I., *Kandili Ndriques, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht 2007, f. 466.

31. S Sabik, S., *Fikbus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i tretë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam,

Sipas këndvështrimit të Sheriatit Islam, veprat penale konsiderohen veprimet ligjërisht të ndaluara, për të cilat Zoti ka vendosur sanksione shprehimisht të përcaktuara apo të papërcaktuara³².

Veprat penale të cilat ndëshkohen me dënimin e përcaktuar “Hudud” mund të ndahen në tri kategori:

1. Delikti kundër jetës dhe trupit, ku bëjnë pjesë:

- a) vrasja; dhe
- b) lëndimet trupore.

2. Delikti kundër familjes dhe moralit, ku bëjnë pjesë:

- a) adulteria (kurorë-shkelja); dhe
- b) akuza e pabazë për adulteri.

3. Delikti kundër pasurisë, ku bëjnë pjesë:

- a) vjedhja; dhe
- b) kusaria.

2.1.1 Deliktet kundër pasurisë

Në deliktet kryesore kundër pasurisë janë vjedhja, vjedhja e pasurisë së jetimit, fqinjët, e pasurisë publike, etj. Sipas dijetarëve të shquar të së drejtës islame, nisur nga vlera e objektit të cenuar nga veprimi kriminal, vjedhja ndahet në dy lloje: lloji i vjedhjes që duhet të qortohet si dhe lloji i vjedhjes që duhet të ndëshkohet. Vjedhjet që

Tiranë, 2011, f. 11.

32. Sulejmani, Sh., *E drejta penale islame*, pjesa e përgjithshme, Shkup, 2012, f. 7.

duhet të ndëshkohen ndahen në dy lloje: në vjedhje të vogla dhe vjedhje të mëdha³³.

Interesant është fakti se, në gjykimin tim, kam arritur të dalloj, nga leximi dhe studimi i ajeteve kuranore, disa lloje vjedhjesh që për objekt studimi po i radhis si më poshtë.

2.1.1.1 Vjedhja

Sipas ligjit islam, vjedhja është marrja e një sendi në mënyrë të fshehtë. Fjalori i gjuhës arabe e ka përkufizuar fjalën “serika” (vjedhje) në këtë mënyrë: “Marrja e pasurisë së dikujt tjetër nga vendi ku ajo është ruajtur në mënyrë të fshehtë. Ndërsa Ibn Arfes ka thënë: “*Vjedhësi është personi që hyn fshehurazi në vendin ku është ruajtur pasuria e dikujt tjetër dhe merr pres saj*”³⁴.

Duke u nisur për sa më lart, studiuesi i së drejtës islame Sejjid Sabik mendon se vjedhja përfshin tri aspekte: marrjen e pasurisë së dikujt tjetër, marrjen e pasurisë së tjetrit në mënyrë të fshehtë si dhe faktin që pasuria duhet të jetë e ruajtur në një vend të sigurt. Ajo çka kuptohet nga parashtrimi i kuptimit të vjedhjes është fakti se në rast se pasuria merret haptazi ose nuk është ruajtur në një vend të fshehtë, atëherë nuk

kemi të bëjmë me krimin e vjedhjes që detyron prerjen e dorës³⁵.

Lidhur me objektin e veprës penale të vjedhjes dhe cilësitë e tij, mund të themi se e drejta islame kërkon që malli, produkti, objekti i vjedhjes të jetë një mall i lejueshëm në qarkullimin civil sipas ligjit islam. Çka nënkupton faktin se objekti i cenuar është një mall që mund të përdoret si kapital, të konsiderohet pronë, që lejohet të shitet dhe mund të dëmshpërblehet. Pra, nga kjo arrijmë në përfundimin se nuk do të ndodhemi para vjedhjes nëse merren në mënyrë të kundërligjshme pije alkoolike, mish derri, mjete dëfrimi si violina, violinçeli etj., që janë të ndaluara, sipas shumicës së dijetarëve islam, si për shtetasit mysliman a jo, që jetojnë në territorin e një shteti islam³⁶.

Legjislacioni islam kërkon që objekti i cenuar, i vjedhur duhet të ketë një vlerë të caktuar dhe pronari duhet të dëmtohet nga humbja e tij³⁷. Në suren En-Nisa, ajetet 29-31, Zoti thotë: “*O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejueshme [...] kush e bën këtë që ndalon Zoti qëllimisht dhe tejkalon kufijtë Ne do ta hedhim në një zjarr të madh[...]*”³⁸.

35. Po aty.

36. Po aty, f. 574.

37. Po aty, f. 571.

38. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 271.

33. Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i dytë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011, f. 564-565.

34. Po aty, f. 565.

Ajo çka vërejmë qartë është thirrja e Zotit për të ndaluar nga fitimi i palejueshëm, që cilësohet si haram, diçka e kundërligjshme në terminologjinë e sotme juridike. Në çdo rast, sipas këtij ajeti kuranor, duhet që personi fajtor të ketë qenë i përgjegjshëm për qëllimin e përfitimit nga pasuria e tjetrit si dhe duke kaluar kufijtë e lejuar nga normat morale e ligjore të kohës. Kam përshtypjen se me tejkalim kufijsh, do të kuptohen rastet kur një person merr pasurinë e dikujt jo në masën e duhur për të ushqyer vetveten, sikurse ligji islam e lejon, apo sikurse thotë edhe tradita profetike për qëllime të mbijetesës dhe duke e përdorur me maturi, me kujdes, por kur e merr pasurinë e tjetrit dhe e shpërdoron atë. Po ashtu, në ajetin numër 161 të sures Nisa sanksionohet ndalimi i ushqimeve, pasurisë së fituar padrejtësisht. Kështu, Zoti thotë: “[...] *ata e kishin të ndaluar ngrënien e pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë*[...]”³⁹. Mendoj se Zoti nëpërmjet përsëritjes së shfaqur në forma të ndryshme, në disa ajete kuranore, sanksionon vlerën që ka paprekshmëria e pasurisë së njerëzve nga veprimet e padrejta. Nëpërmjet këtyre ajeteve, ligji islam bën me dije ndalimin e cenimit të pasurisë e të pronës personale.

39. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madhërisbëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 157-158.

Për sa i takon subjektin në figurën e veprës penale të vjedhjes duhen marrë në konsideratë disa cilësi të tij. Së pari, vjedhësi duhet të ketë zotësi juridike për të vepruar. Pra, duhet të ketë arritur moshën madhore dhe të jetë i shëndetshëm mendërisht. Kjo pasi fëmijët si dhe personat me aftësi të kufizuara, nuk mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Po ashtu, nuk është kusht që vjedhësi duhet të jetë mysliman ose të ketë kryer veprën ndaj besimtarëve myslimanë. Mjafton kryerja e veprës dhe nuk ka rëndësi fakti nëse objekt i cenimit është pasuria e një myslimani apo e një njeriu tjetër. Ligji ndëshkon njëlloj. Po ashtu, kërkohet që vjedhësi në çdo rast të jetë i përgjegjshëm për veprimin që kryen. Thënë ndryshe, vjedhësi duhet të ketë liri zgjedhjeje për të vepruar dhe jo të detyrohet për të vjedhur. Detyrimi me forcë e anulon lirinë e zgjedhjes së individit, kjo e fundit bën që të mos lindi përgjegjësia juridike penale për individin në fjalë për veprimet e kryera. Së treti, mund të themi se nuk lind përgjegjësia penale në rast të cenimit të pasurisë familjare. Çka nënkupton faktin se asnjë nga familjarët në kuptimin e anëtarëve të familjes nuk mban përgjegjësi për pakësimin a cenimin e pasurisë familjare, si për shembull, fëmijët me pasurinë e prindërve, gjyshërit a anasjelltas. Ndërsa në rast të cenimit të pasurisë familjare nga pjesëtarë të tjerë në kuptimin e gjerë

të familjes, si për shembull, halla, teze, etj., ligji islam thekson faktin se është e ndëshkueshme vepra penale, por ndaj tyre nuk mund të zbatohet dënimi me prerje të dorës, pasi një gjë e tillë do të çonte në prishjen e marrëdhënieve familjare që e drejta islame urdhëron për t'i ruajtur dhe forcuar⁴⁰.

Në kuadër të anës subjektive të veprës penale të vjedhjes, mendoj se kanë rëndësi motivet për të cilat kryhet vjedhja. Kështu, në rast se vjedhja nxitet nisur nga nevoja për të ushqyer veten a familjen për shkak të varfërisë ekstreme, mendoj se nuk kualifikohet si e tillë. Kjo, dhe po të kemi parasysh edhe traditën profetike sipas së cilës na vjen shembulli: *“A’bad in Sherhabil El-Gabrijun, e kapi skamja, thatësia e uria, e shkoi te një kopsht në Medinë, ku mori një kallë, ia nxori kokerrat dhe disa i hëngri e disa prej tyre i futi në teshat e tij t’i merrte me vete. Ndërkohë, erdhi pronari i kopshtit, i cili e goditi dhe i mori teshat ku kishte futur kokerrat e marra-të vjedhura. Më pas El-Gabrijun shkoi tek i Dërguari a.s. dhe ia tregon rastin. Pas kësaj, i Dërguari a.s. i thotë këtij personi: ‘As nuk e ke ushqyer kur ka qenë i uritur, por as nuk e ke mësuar kur nuk ka ditur’. Më pas e urdhëroi t’i kthente teshën e marrë El-Gabrijun së bashku me një racion apo gjysmë racioni ushqim. Po kështu,*

40. Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i dytë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011, f. 568.

*sipas traditës profetike legjitimohet ngrënia e frutave të varura jashtë kopshtit aty për aty për nevojtarët, por jo edhe t’i mbushin valixhet e veta[...]*⁴¹. Pra, në këtë rast mund të themi se e drejta islame legjitimon të drejtën për të marrë sende ushqimore për t’u ushqyer dhe për të bërë të mundur jetesën, por kurrsesi vetëgjyqësinë, si dhe veprimet kriminale përfshi këtu dhe vjedhjen e pasurisë private.

Lidhur me ndëshkimet që parashikohen për këtë figurë krimi mund të themi se në suren Nisa, në ajetet 38-40, sanksionohet në mënyrë të detyruar urdhri për prerjen e dorës së fajtorit, pa dallim qoftë femër a mashkull. Gjuha e ftohtë e ligjeve është tepër mbresëlënëse⁴².

Kështu, ligji islam thotë se: *“Vjedhësit dhe vjedhëses prijani duart, si shpajmim i veprës që bënë, kejo masë është dënim nga Zotit[...]*⁴³.

Tradita profetike është ajo që na vjen në ndihmë për të përcaktuar vlerën se kur zbatohen këto sanksione penale të rënda. Kështu, sipas një hadithi, i Dërguari i Zotit ka thënë:

41. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 422.

42. Le Goff, J., *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Botimet “TOENA”, Tiranë, 1998, f. 50.

43. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 548.

“Vjedhësit i pritet dora vetëm për vjedhje të çerek dinari e më tepër, a më lart”⁴⁴. Ky është një qëndrim që mbështetet edhe nga dijetarët e të drejtës islame. Për sa u takon dënimeve të ashpra si prerja e dorës mund të themi se është praktikuar edhe në legjislacione të ndryshme të vendeve të Evropës gjatë rrjedhës së historisë. Në zbutje të një ndëshkimi të tillë, legjislatura fetare islame miratoi edhe norma të reja që përbënin plotësimin e asaj që është në interes të njerëzve. (p.sh. pagesat , shpagimi i dëmit, dëmshpërblymi etj.) Në çdo rast, ligji islam njih dhe institucionin e faljes kur kishim shfaqjen e një pendimi të thellë nga fajtori për veprimin (vjedhjen) e kryer. Kështu, në ajetin kuranor thuhet se në çdo rast, Zoti fal shumë dhe është Mëshirues, duke pranuar pendimin.

Në Kur'an parashikohet edhe vepra penale e vjedhjes së pasurisë dhe e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Kështu, nëse i referohemi ajetit kuranor numër 188 të sures El-Bekare, shohim të sanksionuar se: “Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar e as mos u paraqitni me rryshfet te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini se pa të drejtë po e hani?”. Nga kjo dispozitë kuranore ne mund të shohim se pasuria, marrja dhe vjedhja e saj janë të ndaluara nga ligji islam.

44. Po aty, f. 548-549.

Po ashtu, edhe marrja e pronës së tjetrit në mënyrë të vetëdijshme, nga cilido person, me anë të rryshfetit, shpërdorimit të detyrës nga ana e gjykatësit, duke dhënë një vendim të padrejtë, të pabazuar në prova e fakte, është e ndaluar. Vetë ligji islam në këtë rast parashikon se edhe gjyqtari, si pjesë e një procesi të padrejtë, do të përthithet nga ndëshkimi me zjarr. Këto vepra penale gjejnë pasqyrimin e tyre edhe në legjislacionin tonë penal të brendshëm⁴⁵.

2.1.1.2 Vjedhja e pasurisë së lënë për ruajtje

Në suren Ali Imran Zoti udhëzon për largimin nga marrja pa të drejtë e pasurisë nga personi që i është lënë për ruajtje. Kështu, thuhet se: “[...] ndër ithtarët e librit ka të tillë që po u besove një sasi të madhe ari ai ta kthen ty atë, por ka të tillë që po ia besove një dinar, ai nuk ta kthen ty atë, përveç nëse gjithnjë i rri gati”.

Po ashtu, në këtë ajet uranor, Zoti ndëshkon gënjeshtren si një ndër llojet e mashtrimit, kur thotë se: “duke ditur të vërtetën ata bëjnë gënjeshtër ndaj Zotit”, me veprimet e tyre. Njëkohësisht, ajeti në fjalë, bën thirrje për t’u larguar nga mëkatet, veprimet e kundërligjshme, që mund të përfshijnë përse jo edhe vjedhjen, mashtrimet dhe shkatërrimet e ndryshme që mund t’i bëhen pasurisë së një individi⁴⁶.

45. Ligj, Nr. 7895, Dt. Aktit: 27.01.1995, Dt. Miratimit: 27.01.1995, Flet. Zyrtare Nr. 2, Faqe: 23, neni 134 dhe 245/1.

46. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e*

2.1.1.3 Vjedhja e fqinjtit

Në doktrinën e së drejtës islame vjedhja është e ndaluar, sepse është vetë Zoti Ai që e ndalon atë po ashtu edhe i Dërguari i tij a.s. Pasuria e fqinjtit merret në mbrojtje nga ligji islam. Kështu, nëse do t'i referohemi një thënieje të Profetit a.s., do të shohim se vjedhja e pronës, shtëpisë së fqinjtit është më e rëndë sesa vjedhja e dhjetë shtëpive prona të njerëzve të ndryshëm⁴⁷.

Me këtë parashikim nuk është se ligji islam ligjëron vjedhjen e banesave, apo pronave të tjera, por do të tregojë dhe sanksionojë rëndësinë që ka moscenimi i pronës së fqinjtit, duke motivuar politikën e fqinjësisë së mirë. Me anë të këtij hadithi, urdhërohet paprekshmëria e pasurisë së fqinjtit.

2.1.1.4 Vjedhja e varreve

Lidhur me vjedhjen e varreve Sejid Sabiku mendon se juristët islamë ndajnë mendime të ndryshme. Pjesa dërrmuese e juristëve mendojnë se vjedhja e varreve është veprë penale dhe si e tillë duhet të ndëshkohet me sanksionin përkatës atë të prerjes së dorës. Ndërsa disa juristë të tjerë, më të paktë në numër, mendojnë se varri nuk është një vend

shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit, Vol. II, Ali Imran-Maide, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor 2008, faqe 77.

47. Kethir, I., *Kandili Ndrifues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 287.

për ruajtjen e pasurisë, pasi i vdekuri nuk posedon pasuri. Në këto kushte, ata mendojnë se nuk ndodhemi para krimit të vjedhjes e aq më pak nuk zë vend sanksioni i parashikuar nga legjislacioni islam me prerje të dorës⁴⁸.

2.1.1.5 Grabitja

Ligji islam e ndalon grabitjen apo sikurse quhet ndryshe nga disa juristë të së drejtës islame “vjedhja e madhe”. Subjektet e këtij krimi quhen ndryshe edhe “plaçkitës të rrugës”, për shkak të frikës që krijon prania e tyre në publik. Në aspektin gjuhësor, fjala arabe “hirabeh” (vandalizëm) është derivat i fjalës “harb” (luftë) dhe nënkupton një grup të armatosur njerëzish që luftojnë kundër shoqërisë nga njëra anë, dhe kundër mësimëve islame, që synojnë realizimin e sigurisë publike si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga ana tjetër⁴⁹.

Veprimi kriminal i grabitjes ka për objekt cenimin e atyre marrëdhënieve që mbrojnë edhe pasurinë, kulturat bujqësore nga shkatërrimi apo vjedhja, si dhe pasurinë blegtorale apo fruti-kulturore të individëve, pavarësisht besimit fetar të tyre. Kjo veprë kryhet gjithnjë me anë të veprimeve aktive.

48. Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i dytë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011, f. 564-565.

49. Po aty, f. 539.

Në pikëpamje të anës objektive, elementet që paraqesin rëndësi për kryerjen e kësaj vepre penale janë mënyra, mjeti, si dhe vendi i kryerjes së veprës. Kështu, është kusht që subjekti apo subjektet në këtë veper penale të jenë të pajisur me armë dhe t'i përdorin ato. Si dhe, krimi të jetë kryer në mënyrë të hapët dhe të ketë ndodhur në një largësi nga vendet e banuara. Për këtë të fundit, juristët ndajnë mendime të ndryshme⁵⁰.

Subjekt i këtij krimi mund të jenë si shtetasit ashtu dhe grupet e armatosura të besimit islam apo jo, që veprojnë në territorin e një shteti islam, duke sfiduar parimet e fesë dhe të moralit, nga njëra anë, dhe sistemin shtetëror dhe ligjet e tij nga ana tjetër⁵¹.

Llojet e ndëshkimeve të caktuara për subjektet e këtij krimi janë vrasja, kryqëzimi, prerja e duarve dhe këmbëve në anë të kundërta si dhe dëbimi nga vendi⁵². Gjithsesi, për këtë veper, ashtu sikurse edhe për plaçkitjen a mashtrimin, në dallim nga vjedhja, doktrina islame ndan mendimin se, sanksionet penale të parashikuara janë më të buta. Kështu, ndonëse pranohet se, veprimet e fajtorit në rastin e grabitjes janë në kundërshtim me normat e së drejtës islame, fajtorët ndëshkohen për veprimet e tyre me qortim, rrahje, heqje lirie për një

kohë të gjatë, gjobitje por kurrsesi me prerje të dorës sikurse në rastin e vjedhjes. Një qëndrim i tillë vjen i arsytuar nga teoricienët e së drejtës islame. Në dukje mendimi i tyre është interesant, pasi në këndvështrimin e tyre argumentohet se në rastin e vjedhjes kemi të bëjmë me vjedhje në mënyrë të fshehtë të pasurisë, fajtori nuk dihet dhe mund të jetë e pamundur për ta zbuluar. Plaçkitësi e merr pasurinë e tjetrit në mënyrë të hapët duke u parë prej njerëzve. Dëshmitarët mund t'ia marrin pasurinë e plaçkitur nga dora (aty për aty me anë të vetëgjyqësisë e forcës) ose të dëshmojnë para gjykatësit për të vërtetuar plaçkitjen⁵³.

2.1.1.6 Vjedhja e pasurisë së jetimit

Nëse do t'i referohemi sures Nisa, do të shikojmë se Zoti me anë të fjalëve madhështore dhe rregullave universale të besimit të drejtë, dënon çdo veprim të kundërligjshëm që drejtohet kundër pasurisë së jetimëve, si një shtresë e pambrojtur dhe e dobët e shoqërisë njerëzore. Në një ajet kuranor thuhet se: “*Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë, ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e xhebenemil*”⁵⁴. Po ashtu, në ajetin 2-4 të sures Nisa

53 Po aty, f. 563.

54. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 424.

50. Po aty, f. 541-542.

51. Po aty, f. 539.

52. Po aty, f. 547.

theksohet se: “*Jetimëve jepuani (kur të rriten) pasurinë e tyre, dhe mos e ndërroni të pastrin (mallin tuaj që e keni hallall) me të ndytin (me haramin) edhe mos e hani pasurinë e tyre*”⁵⁵. Ndërsa në një ajet tjetër të kësaj sureje Zoti thotë se: “[...] *mos hani nga pasuria e jetimëve duke e shpërdoruar...*”⁵⁶. Ngrënia e pasurisë së jetimit legjitimohet vetëm në rast të varfërisë dhe gjithnjë duke e bërë këtë për shkak të mbijetesës, por gjithnjë me maturi.

Shohim se ligji themelor islam, Kur’ani, merr në mbrojtje në mënyrë ekskluzive, me anë të dispozitave të tij, si dhe i kushton një përkujdesje të veçantë mbrojtjes së pasurisë së jetimëve. Konkretisht, urdhërohet ruajtje e pasurisë së jetimëve nga cilido person deri në çastin që ata do të arrijnë moshën e pjekurisë dhe në rast cenimi të pasurisë të tyre, për fajtorët parashikohet dënimi me zjarr⁵⁷.

Po ashtu, pasuria e jetimëve gjen mbrojtje edhe në suren El-Bekare. Kështu, në dispozitat e saj parashikohet mbrojtja e pasurisë së jetimëve. Më saktësisht, në dispozitën numër 219-220 thuhet se: “*Po t’i*

ndihmoni në punët e tyre është më mirë, e nëse i përziëni (pasurinë e tyre me tuajën) ata janë vëllezërit tuaj. Allahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmiri”⁵⁸. Pra, nga interpretimi i kësaj norme kuranore, mund të themi se Zoti e di se cili e ka qëllim cenimin, shkatërrimin, dëmtimin apo vjedhjen e pasurisë së jetimit, si dhe po ashtu di se cili e ka për qëllim për të bërë gjëra pozitive në lidhje me pasurinë e tyre, kur thekson faktin se: “*Mos iu afroni pasurisë së jetimit vetëm në mënyrën më të mirë...*”⁵⁹.

Po ashtu, në një ajet tjetër kuranor shprehet qartë urdhërimi i Zotit për të mbrojtur pasurinë e jetimit nga abuzimet e ndryshme. Kështu, në të thuhet se: “*Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai ta arrijë pjekurinë, mund t’i afroheni veçse në mënyrën më të mirë, zbatojeni me drejtësi masën dhe peshoren, ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij*”⁶⁰.

Në suren El-Isra, ajetet 34-35, Zoti ndër të tjera thotë: “*Mos e përdorni pasurinë e jetimit ndryshe veçse në mënyrën më të mirë (për t’ia shtuar), derisa ai të arrijë pjekurinë e vet...*”⁶¹. Ky ajet ka për objekt mbrojtjen

55. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 221.

56. Po aty, f. 227.

57. Me dënimin me zjarr këtu nënkuptohet dënimi në ferr, pasi në jurisprudencën islame nuk lejohet në asnjë lloj rrethane ndëshkimi i fajtorit në këtë jetë me djege me zjarr (shënim i redaksisë).

58. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 528.

59. Po aty, f. 532.

60. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. III, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, dhjetor, 2008, f. 179.

61. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i

e pasurisë së jetimit nga veprimet ose mosveprimet kriminale të personave që kanë marrë përgjegjësinë të menaxhojnë pasurinë e jetimit. Ligji islam urdhëron mbajtjen në mënyrë të drejtë të pasurisë së jetimit nga personi që duhet të përkujdeset për të. Pra, subjekti në këtë ajet mendoj se është i posaçëm, kujdestari i tij.

2.1.1.7 Vjedhja e plaçkës së luftës

Vjedhja e plaçkës së luftës quhet *gulus*. Vjedhja e pasurisë së fituar ndër luftëra është e ndaluar⁶². Objekti i kësaj figure krimi është plaçka e luftës. Kështu thotë Zoti në Kur'an: “Është e pamundur që ndonjë profet të përvetësojë në mënyrë të pandershme prenë e luftës. Kushdo që bën një gjë të tillë, do të vijë i ngarkuar me të ditën e Kiametit”⁶³. Në ligjin islam parashikohet përgjegjësia e çdo personi për kryerjen e një krimi të tillë.

2.2 Mashtrimi

Në suren Ali Imran, ajetet 159-164, Zoti thotë se: “*Asnjë peygamberi nuk i takon të bëjë hile dhe kush bën hile*

Qytetërimin Islam, *KURANI i madhërisëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 317.

62. Sejid Sabik, Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s., Vëllimi i tretë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimin Islam, Tiranë, 2011, faqe, 166.

63. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimin Islam, *KURANI i madhërisëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 130.

(në ndarjen e plaçkës së luftës), ai në ditën e kiametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë[...]”⁶⁴. Nga ky ajet kuranor ne kuptojmë se Zoti e ndalon në mënyrë kategorike mashtrimin, hilen-gënjeshtren sikurse quhet ndryshe, dhe kuptohet se, kur është diçka e ndaluar për një peygamber, për kreun e bashkësisë së besimtarëve, atëherë si rrjedhojë ky veprim është i ndaluar për të gjithë pjesëtarët e këtij komuniteti. Po ashtu, parashikohet përgjegjësia për subjektin e kryerjes së një veprimi të ndaluar kur thuhet se: “[...]ai në ditën e kiametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë[...]”⁶⁵.

Në suren El-En'am ajetet 123-124, Zoti thotë: “[...]Në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari, në mënyrë që të bëjnë dredhi në të, por nuk mashtrojnë tjetërkënd pos veten e tyre dhe prapëseprapë nuk kuptojnë. [...] Ata që bëjnë krim do t'i godasë poshtërimi dhe dënimi i fortë tek Allahu për shkak se vazhdimisht bënin hile”⁶⁶. Edhe në këtë ajet kuranor vihet re thirrja e Zotit për të mos bërë mashtrime kundrejt njerëzve pasi fajtorët do të ndëshkohen.

Me mashtrime kuptohen edhe mashtrimet që mund t'i bëhen njerëzve pa të drejtë kundrejt

64. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 168.

65. Po aty.

66. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. III, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, dhjetor, 2008, f. 129.

pasurisë, pronës së tyre. Po ashtu sipas një thënie të Profetit a.s. gënjeshtria është një nga tri format dalluese të mosbesimtarit⁶⁷. Në një tjetër hadith thuhet se: “*Ruajuni prej gënjeshtres, sepse gënjeshtria, njëmend çon në mbrapshti, ndërkaq, përnjëmend mbrapshtinë çojnë në zjarr. Njeriu vazhdimisht do të gënjejë dhe do ta kërkojë gënjeshtren derisa të shkrubet tek Allahu gënjeshtar i madh*”⁶⁸.

Ligji islam, në kuadër të mbrojtjes së vlerave dhe dinjitetit njerëzor, sikurse dhe në mbrojtje të pasurisë së njerëzve nga mashtrimet e ndryshme që mund të dëmtojnë pasuritë e tyre, urdhëron në çdo rast për t’u larguar nga gënjeshtria. Në këtë kuptim, edhe shtënia në dorë e pasurisë së tjetrit me anë të mashtrimit, gënjeshtres, është një gabim i madh, për të cilin lind përgjegjësia dhe ndëshkimi. Në lidhje me marrjen e pasurisë ka një varg hadithesh që bëjnë me dije se Zoti dënon dhe ndëshkon marrjen pa të drejtë të pasurisë ndaj të tjerëve edhe me anë të mashtrimit si dhe parashikon se në ditën e kiametit të llogaridhënies do të dalin para Zotit të gjithë fajtorët së bashku me pasurinë e marrë padrejtësisht. Kjo gjë mbështetet jo vetëm nga

67. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 507.

68. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. III, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, dhjetor, 2008, f. 643.

tradita profetike por çka është më e rëndësishmja, edhe nga ajetet kuranore⁶⁹.

Po ashtu, i Dërguari i Zotit a.s. në një hadith tjetër të tij thekson se: “*Kush pohon diçka të rrejshme në mënyrë që të pasurohet, Allahu edhe më tepër do ta varfërojë atë*”⁷⁰. Pra, në mënyrë të prerë ndalohet përdorimi i gënjeshtres dhe mashtrimit me qëllim për t’u pasuar. Sipas traditës profetike, një ndër shtatë mëkatet, fajet shkatërruese të njeriut është dhe magjia-mashtrimi i njerëzve si dhe ngrënia e pasurisë së jetimit⁷¹.

I Dërguari i Zotit a.s. ka thënë: “Çdo mashtruesi do t’i vihet një flamur në shpinë, e do të thuhet: Ky është mashtrimi i filanit, birit të filanit”. Urtësia e këtij hadithi është se pasi mashtrimi është i fshehtë dhe njerëzit nuk e dinë, ditën e gjykimit kjo do të publikohet haptazi me qëllim që ta shohin të gjithë njerëzit se çka bërë personi përkatës⁷².

Gjykoj se vlera e kësaj tradite profetike qëndronte në efektin parandalues që mbart, pasi është një thirrje që i drejtohet njerëzve se të gjithë këta të fundit, pa dallim, do

69. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 168-173.

70. Po aty, f. 200.

71. Po aty, f. 275.

72. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. III, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, dhjetor, 2008, f. 135.

të merren në llogari për çdo vepër kriminale sikurse dhe për mashtrimet e bëra në mënyrë të fshehtë kundrejt pasurisë, pronës dhe njerëzve në përgjithësi.

2.2.1 Mashtrimi në peshë dhe në matje

“Zbatoheni me drejtësi masën dhe peshoren, Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij”⁷³. Në këtë ajet, ligji islam urdhëron për drejtësi gjatë shitjes së pasurisë (ku mund të përfshihen produkte të ndryshme ushqimore, bujqësore, blegtorale etj.), kur thotë: “Zbatoheni me drejtësi masën dhe peshoren...[...]

74. Po ashtu, ligji islam merr në mbrojtje pasurinë gjatë procesit të shitblerjes së produkteve të ndryshme, objekt i pasurisë së njerëzve. Në Kur’an thuhet se: “Të mjerët ata që matin e peshojnë mangët. Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë. E kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangët. A nuk e dinë të tillët se kanë për t’u ringjallur. Një ditë të madhe. Në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve”⁷⁵.

Për sa më lart, shikojmë se ligji islam mbron pasurinë ndaj veprimeve të fajtorit që vepron në çdo rast me dashje të drejtpërdrejtë. Ndërsa ndryshe qëndron puna kur personi vepron nga pakujdesia në shitblerje. Sipas ligjit islam, kur

73. Po aty, f. 179.

74. Po aty.

75. Po aty, f. 180.

personi gabon në peshë dhe në matje nga pakujdesia, jo me qëllim për të përfituar për vete a për të tjerë, nuk mban përgjegjësi. Kush mundohet që të blejë dhe të shesë pasuri me drejtësi, dhe, pasi ta ketë dhënë ndihmën, bën ndonjë lëshim, nuk është fajtor për të. Kjo ka lidhje me thënien e Zotit në Kur’an se: “Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij[...]

76. Po ashtu në Kur’an thuhet: “[...] mos matni as mos peshoni mangët[...]

Edhe në këtë ajet tjetër kuranor parashikohet nga ligji islam detyrimi i shitësve për të mos marrë pasurinë e blerësve në mënyrë të pandershme, duke mashtruar me anë të peshës. Kjo dispozitë ka për objekt vetëm mbrojtjen e pasurisë së blerësve. Subjekt i saj janë vetëm shitësit, në ndryshim nga ajeti më lart që kishte për objekt e subjekt edhe blerësit. Referuar ajetit, krimi i mashtrimit kundrejt pasurisë kryhet me anë të mashtrimit në peshë.

Po ashtu, në një tjetër ajet kuranor thuhet: “O populli im, veproni drejt gjatë matjes dhe peshimit, e mos dëmtoni njerëzit në asgjë dhe mos shkaktoni rrëmuje në tokë”⁷⁸. Sikurse shihet, ligji islam ndalon njerëzit nga matja mangët dhe urdhëron të

76. Po aty, f. 181.

77. Kethir, I., *Kandili Ndrichues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol.IV, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, maj, 2009, f. 166.

78. Po aty, f. 167..

jenë të drejtë gjatë matjes qoftë kur blejnë apo kur shesin pasurinë e tyre. Zoti në suren El-Isra, ajeti 35 thotë: “[...]Masën mbusheni kur matni (me enë) dhe peshoni me peshore të drejtë (të saktë)”⁷⁹. Është një tjetër përpjekje serioze që ligji islam ndërmerr për të bërë të mundur mbrojtjen e pasurisë së shtetasve të tij ndaj veprimeve kriminale. Në këtë dispozitë, gjykoj se, nuk janë subjekt i vetëm shitësit e blerësit, por çdo person që gjatë marrëdhënieve njerëzore kryen matje dhe peshon, sikurse mund të jenë marrëdhënia midis dy të njohurve, miqve, fqinjëve, në dhënie hua të produkteve ushqimore si grurë, miell, sheqer, vaj etj. Shohim se ligji islam përkujdeset në mënyrë të hollësishme për rregullimin e marrëdhënieve njerëzore dhe ndalimin nga veprimet kriminale kundrejt pasurisë së njerëzve.

Po ashtu, në suren Shuara Zoti thotë: “Plotësojeni matjen, e mos u bëni prej atyre që lënë mangët! Dhe matni me peshore të saktë. Dhe mos lini mangët sendet e njerëzve, e mos bëni shkatërrime në tokë”⁸⁰. Me anë të këtij ajeti kuranor, urdhërohet nga ligji islam përsëri fakti që shitësit

të mos mashtrojnë blerësit gjatë ushtrimit të veprimtarive tregtare si dhe procesit të shitblerjes midis marrëdhënieve njerëzore. Ajo që kuptojmë nga interpretimi literal i këtij ajeti kuranor është fakti se objekt i mashtrimit në peshë është pasuria, pavarësisht llojit të saj. Ligji islam urdhëron për të qenë të saktë në matje, ashtu sikur shesim apo blejmë. Pësha në çdo rast duhet të jetë e drejtë, e jo kur të blejmë të marrim sasinë e plotë, e kur t’u shesim njerëzve, t’ua lëmë të mangët atë. Çdokush sipas ligjit islam urdhërohet të mos u pakësojë pasurinë të tjerëve nëpërmjet veprimit të mashtrimit në matje a në peshë.

2.3 Shkatërrimet e pasurisë

Në suren El-Bekare, në një prej dispozitave të saj theksohet se: “Zoti nuk e dëshiron çrregullimin, si dhe personin që vepron të bëjë shkatërrime në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe gjallesat”⁸¹. Pra, në këtë normë kuranore sanksionohet dëshira e Zotit për rend e qetësi në tokë. Madje, janë të dënueshme dhe konsiderohen punëmëkat të kryera nga mosbesimtarët, çdo veprim që nxit shkatërrimin dhe cenon pasurinë. Në këtë rast, ligji islam mbron veçanërisht të mbjellat, pra, pasurinë bujqësore që përfshin kulturat bujqësore si dhe pasurinë blegtorale.

79. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madhërisëm, Kuptimet e tij në gjubën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 317.

80. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. V, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, mars, 2010, f. 651.

81. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 505.

Në ajetet kuranore numër 85-86 të Sures Hud, ligji islam parashikon ndalimin nga dëmtimet që mund t'u bëhet pasurisë së njerëzve nga shkatërrimet e ndryshme, kur thotë: "[...]mos i dëmtoni njerëzit në asgjë[...]"⁸². Mendoj se, në këtë rast, objekt i mbrojtjes nga normat e ligjit islam, përtej jetës dhe shëndetit të njerëzve, është edhe pasuria e tyre. Po ashtu, në ajetin kuranor të sures Shuara thuhet: "[...]mos bëni shkatërrime në tokë[...]"⁸³.

Mendoj se, ligji islam, në rastin konkret urdhëron mos cenimin e pasurive të njerëzve në tokë nëpërmjet veprimeve kriminale të shkatërrimit dhe dëmtimit. Në një hadith profetik thuhet se: "[...]Zoti urren shumë shkatërrimin e pasurisë"⁸⁴.

Normat kuranore sanksionojnë ndëshkimin e atyre që bëjnë shkatërrime në tokë, të çfarëdo forme qofshin. Ndëshkimi i parashikuar për këtë vepër është tepër i rëndë dhe i qartë. Kështu, ata dënoheshin me anë të prerjes së duarve dhe këmbëve në anë të kundërta, vrasjes,

gozhdimit të tyre si dhe me anë të dëbimit nga vendi. Kjo ishte forma e dënimit për ta në këtë jetë, ndërsa në botën tjetër për fajtorët që bënin shkatërrime parashikoheshin dënime të tjera të mëdha. Mendoj se, në këtë dispozitë kuranore, bëhet fjalë për shkatërrime që mund të drejtoheshin si kundër pronës private ashtu dhe asaj shoqërore. Madje, sipas traditës profetike, me shkatërrime në tokë duhej kuptuar edhe rasti i vjedhjes me dhunë me pasojë vdekjen, për të cilin zbatoheshin dënimet e parashikuara në këtë ajet kuaranor⁸⁵.

I Dërguari a.s. ka thënë: "*Ibrahimi a.s. kërkoi që Qabeja të jetë vend i shenjtë dhe i sigurt, e unë u luta që Medinën të jetë vend i shenjtë ndërmjet dy kodrave. Për këtë, nuk bën të bëhet gjueti brenda saj dhe nuk bën të priten drurët e saj*"⁸⁶. Sipas këtij hadithi të Profetit islam a.s., shohim se, merrret në mbrojtje vendi, qyteti i shenjtë i Medinës, nga veprimet e dëmshme, shkatërrimet e ndryshme që mund t'i bëhen atij. Më konkretisht, nga ky hadidh, kuptojmë edhe mbrojtjen që i bëhet një objekti të veçantë të këtij qyteti sikurse janë pemët, si pasuri e përbashkët e qytetit.

Në përfundim të këtij punimi, mund të them se gabimet janë të

82. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. IV, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, maj, 2009, f. 167.

83. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. V, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, mars, 2010, f. 651.

84. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 109.

85. Po aty, f. 540.

86. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007, f. 344.

miat, janë të një njeriu të thjeshtë, ndërsa Zotit i takojnë falënderimet. Si përmbyllje lidhur me këtë temë mund të them se: *“Dituria jonë në krahasim me diturinë Tënde është sikur të mos kishim aspak dituri, sepse Vërtet, Ti je që i di të gjitha të fshehta!”*⁸⁷ dhe se,

87. Kethir, I., *Kandili Ndriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II,

*“Falënderuar qoftë Zoti i botëve!”*⁸⁸

Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor, 2008, f. 650.

88. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madbërishëm, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja “Mileniumi i Ri”, Tiranë, 2012, f. 246.

Bibliografia

- El Gazali, *Komenti tematik i Kur'anit famëlartë, Tefsir*, shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2007.
- Fromont, M., *Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës*, shtëpia botuese "Papyrus", Tiranë, 2009.
- Gylen, F., *Dashuri dhe tolerancë*, shtëpia botuese "Prizmi, Tiranë, 2012.
- Gylen, F., *Lëkundjet që sollli shëkulli*, shtëpia botuese "Prizmi, Tiranë, 2012.
- Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *KURANI i madbërishëm, Kuptimet e tij në gjubën shqipe*, Botimi i dhjetë, shtypshkronja "Mileniumi i Ri", Tiranë, 2012.
- Kethir, I., *Kandili Ndrriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. I, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, gusht, 2007.
- Kethir, I., *Kandili Ndrriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. II, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, qershor 2008.
- Kethir, I., *Kandili Ndrriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. III, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, dhjetor, 2008.
- Kethir, I., *Kandili Ndrriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. VI, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, tetor, 2010.
- Kethir, I., *Kandili Ndrriçues, në versionin e shkurtuar të Tefsirit të Ibn Kethirit*, Vol. V, Botues Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, mars, 2010.
- Kur'an-i, Suretu El-Mudeththir, 38, faqe 802, I.R.C. Dubai, U.A.E.
- Ramadani, S., *E drejta islame, burimi dhe zhvillimi?*, shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2007.
- Le Goff, J., *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Botimet "TOENA", Tiranë, 1998.
- Ligj, Nr. 7895, Dt. Aktit: 27.01.1995, Dt. Miratimit: 27.01.1995, Flet. Zyrtare Nr. 2, Faqe: 23, neni 134 dhe 245/1.
- Llari, S., *Islami dhe civilizimi perëndimor*, shtëpia botuese "Drita e jetës", Prizren, 2004.
- Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i parë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011, Sistani, S., *Përmbledhje e ligjeve islame*, Tiranë, 2012.
- Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i dytë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011.
- Sabik, S., *Fikhus-Sunneh, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s.*, Vëllimi i tretë, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2011.
- Shegani, A., *E drejtë penale e krabasuar*, shtëpia botuese "Darmisa" Fier, 1999.
- Sytari, M., "Fanatizmi është një entuziazëm që djeg jo një e vërtetë që ndriçon", *Gazeta MAPO online*, datë 11.08.2014, Për më tepër shih: <http://mapo.al/2014/08/fanatizmi-eshte-nje-entuziazem-qe-djeg-jo-nje-e-vertete-qe-ndricon/> (aksesuar online datë 19.08.2014).
- Sulejmani, Sh., *E drejta penale islame*, pjesa e përgjithshme, Shkup, 2012.
- The Cairo Declaration on Human Rights in Islam, article 14. Për më tepër shih: <http://www.oic-oci.org/english/article/human.htm> (aksesuar më datë 07.06.2014).

Idetë pedagogjike në krijimtarinë letrare dhe veprimtarinë aplikative të Mehmet Akif Ersoj

Prof. dr. Musa Kraja


Abstrakt

Synimet edukative të Mehmet Akifit, në drejtim të moralit, të familjes, sidomos për virtytin etj., të kujtojnë edhe një nga fushat kryesore që synonte edhe pedagogu gjerman i nivelit botëror, Herbart, pikëpamjet pedagogjike të të cilit, edhe pse janë mbi dy shekuj përpara, depërtaun më vonë te ne, në Shqipëri, në vitet 1920-1937, kur u bënë edhe dominuese në arsimin tonë, sepse i sollën studentët tanë të atëhershëm, në Austri.

Duke ngulmuar për edukimin atdhetar të brezëve të reja, ai e shtronte çështjen më gjerë, të moralit, ruajtja e tij e shëndoshë dhe përmes tij, si pjesë shumë e rëndësishme, të nisëj nga themeli, familja. Funksionimi i mirë dhe i shëndoshë i kësaj qelize bazë të shoqërisë, do të na çojë patjetër tek atdhedashuria në vështrim më të gjerë e konkret. Mehmet Akifi e donte dhe ka luftuar për Atdheun e vet Turqinë, si edhe e ndjente dhe përpiqej në të gjitha mënyrat ta ushqente këtë edhe për Shqipërinë, dhe të qenët shqiptar e theksonte pa mëdyshje, me gojë e me shkrim, madje edhe në poemat e tij.

Në kohën kur jetoj e punoj Mehmet Akif Ersoj dhe më pas, mendimtarët e shquar të fushës së edukimit, idetë pedagogjike i kanë shfaqur në mënyra të ndryshme, por kryesore kanë qenë dhe janë veprat

e mirëfillta shkencore, produkte të kërkimeve e metodologjive shkencore. Por, këto punime përfundonin në duart e një numri të kufizuar mësuesish, pedagogësh dhe të studentëve të degëve të mësuesisë, e të ndonjë studiuesi.



Që këto ide pedagogjike të arrinin te masat, prej kohësh janë aplikuar vepra artistike, të shkruara thjeshtë, ku pasqyroheshin këto ide, me gjuhën e popullit. Sigurisht ka edhe mënyra të tjera, përmes ligjërimeve, të mbajtura në auditorë të ndryshëm. Zhan Zhak Ruso përdori veprën letrare tek “Emili-ose mbi edukatën”; Pestaloci, ndër 46 vepra të tija, i aplikoi të dy mënyrat, një pjesë me stilin e mirëfilltë shkencor, një pjesë me stilin e thjeshtë letrar, publicistik, etj. Sami Frashëri përdori mënyrën shkencore, kur botoi veprën e tij “Gratë”, si dhe kur paraqiti platformën e tij për arsimin në Shqipëri, përmes veprës “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë”, siç u mor edhe Naim Frashëri, duke i pasqyruar idetë e tija të edukimit përmes veprave letrare, por hartoi dhe botoi edhe 14 tekste

shkollore në gjuhën shqipe. Kanë vazhduar edhe të tjerë të huaj apo nga tanët, bie fjala Maksim Gorki me “Universitetet e mia”, apo “Për bukën e gojës”, shkrimtarja kiliane Alende, në një kapitull të romanit “Shtëpia e shpirtave”, ose shkrimtari Sterjo Spase, me “Afërdita”, roman me karakter pedagogjik, apo edhe “Pishtarët”, etj., duke vazhduar me brezin e viteve ‘30-të.

Veprimtaria e Mehmet Akif Ersoj është e shtrirë në një mori fushash, saqë çdo studiues i Historisë së Arsimit e të Mendimit Pedagogjik kombëtar apo botëror e ka të vështirë, madje të pamundur, që të krahasojë një shëmbëlltysë paralele të ngjashme, jo vetëm te ne, por edhe në rrafshin botëror. Është vërtet befasuese hapësira e gjerë e veprimtarive të këtij mësuesi të shkollave të mesme, më pas pedagogu të titulluar “Profesor”, që ligjëroi në disa universitete për Historinë, Gjuhën dhe Letërsinë Turko-Osmane dhe të huaj. Ai ishte poeti e shkrimtari me vepra dinjitoze, përkthyesi, i cili zotëronte gjuhët: turke, arabe, perse e franceze, gjuhët e mëdha të kohës, por që e zotëronte mirë edhe gjuhën shqipe, të vendit të origjinës. Ky sportist i vrapimeve të shkurtra e të gjata, ky mundës i pathyeshëm, hedhës i gjyles, notar që kaloi me not sipërfaqe të gjata në Bosfor, që njihje jo vetëm letërsinë, por edhe muzikën e lindjes e të perëndimit, të cilën edhe e këndonte,

duke filluar nga ilahitë (lirikat fetare) e pastaj nga gjinitë e tjera lirike dhe epike, ky drejtues fetar. Ky ishte profesori që luftoi në betejën e Çanakalasë nën komandën e Qemal Atatürkut, që luftoi për mbrojtjen e Atdheut, ky ishte nëpunësi dhe deputeti, prindi dhe familjari i mirë me gjashtë kalamaj, edukator i madh popullor.

Një model i tillë shembullor multidimensional, kaq i veçantë, ishte i admiruar nga masa e nxënësve dhe e studentëve, pra, ishte model dhe aplikues i veprave të botuara në poezi dhe në prozë, në rreshtat e të cilave qëndronin idetë e mëdha të edukimit për familjen, për dashurinë ndaj dijes, njohurive, për shkollën e Atdheut, pa harruar asnjëherë vëmendjen e madhe për punën, si burim jetese, mirëqenieje, dinjiteti e begatie.

Thuhet me të drejtë se ndikimi i Saadiut është i pranishëm te poetët turq të periudhës klasike dhe në atë të periudhës së letërsisë së re, duke vënë theksin tek Akifi, shqiptar nga Peja. Sigurisht, gjejmë ngjashmëri: që të dy ishin rritur jetimë dhe në varfëri. Që të dy, Saadiu dhe Mehmet Akifi, kishin në qendër të veprimtarisë së tyre, edhe pse në periudha kohe me diferencë disa shekuj, idenë e lartë humanitare, dashurinë për njeriun, çka përbën idetë qendrore të veprës së tyre. Saadiu çmohet shumë nga Gëte, e citon Pushkini, në një nga tregimet me subjekt nga Lindja,

Maksim Gorki e quan “Gojëmjalti Saadi”.

Mehmet Akif Ersoj njohu mirë Lindjen dhe Perëndimin. Kishte studiuar në Francë edhe Dekartin, Dideron, Volterin, siç njihte edhe autorët e mëdhenj Shekspirin, Viktor Hygoin, Emil Zolan, Zhan Zhak Ruson.

Ashtu si Saadiu edhe Mehmeti pati edhe krijime me karakter didaktik për masën e gjerë. Duke shkruar poezi, himne, kishte punuar edhe më herët për himnin shqiptar, por me poezinë “Marshi i Pavarësisë,” që e shkroi pas nëntë vitesh, u bë dhe mbeti tekst shkruar i Marshit të Pavarësisë që mbeti Himni Kombëtar Turk, duke u përzgjedhur e miratuar nga Parlamenti Turk . Këtë poezi nuk e përfshiu në përmbledhjen e tij poetike me idenë se teksti i Himnit Kombëtar shkoi te zemrat e të gjithë qytetarëve turq kudo ku jetonin e punonin.

E gjithë krijimtaria e Mehmet Akif Ersoj ka karakter të theksuar edukativ, çka e afirmoi atë si edukator të madh popullor. Ai u bë edukator profesionist si mësues në gjimnaze dhe si profesor përveç lëndëve që zhvilloi, edhe i përmbajtjes së veprave artistike që shkroi e botoi.

Didaktika u bë objekt në veprimtarinë krijuese dhe në zbatim të parimeve themelore të saj në procesin mësimor. Procesi i të mësuarit me disa parime themelore, që duhen zbatuar, por në mënyrë

krijuese, në varësi të moshës së nxënësve, me specifikat e tjera në auditorët universitarë, specifikave të zonës, të vendit, të lëndës, etj., siç janë aspektet e të mësuarit, por të mësuarit, si qëllimi kryesor i shkollës, nuk realizohet dot pa siguruar të lexuarit, teknikat e leximit, pra një mekanizëm që duhet respektuar. Prandaj Mehmet Akifi në botimin e tij “Librat”, thekson rëndësinë e veçante të të lexuarit. Shoqëria gjithnjë është e interesuar që leximi të fillojë sa më shpejt dhe sa më mirë, sepse njerëzit sa më shumë rriten e kanë shumë të nevojshme që të lexojnë. Vetë leximi ndikon ndjeshëm në zhvillimin mendor të nxënësve dhe të rriturve. Të lexuarit tregon shkallën e nivelit kulturor, gjuhësor, letrar, formues për atë që lexon, për vetë individin, sa e kupton atë që lexon dhe sa e përvetëson atë. Ndryshe niveli formues e kulturor është jo në nivelin e duhur. Sa keq duken ata që belbëzojnë, nuk përdorin theksin e duhur, theksin logjik, apo emocional, kur stonojnë, çka tregon se nuk kanë brumin e tyre, nuk e përcjellin drejtë emocionalisht përmbajtjen. Prandaj shkruan:

“Librat janë shkruar për t’i lexuar
Dhe kur të lexohen, duhen
kuptuar”

“Duhet të mësohemi që të
lexojmë

Duke lexuar, mund të mësojmë.”

Më tej Mehmet Akifi porositi që të njihet autori i pjesës, idetë e tija, koha kur është shkruar, pra baza historike.

“Kur të marrësh librin për të
lexuar

Mësoje atë libër kush e ka
shkruar.”

Më tej, autori porositi se në rastin kur personazhi apo personaliteti që trajtohet është simbol, atëherë “mos kërko tjetër”, domethënë, studioje! Gjithashtu orienton lexuesin që gjatë leximit “...mos e ndërprit hetimin”. Me të folurit e sotëm, zbato mendimin kritik, për atë që lexon, aq më shumë tani që të lexuarit jo me “ç’të dalë përpara”, por me respektimin e kohës së ngarkuar edhe nga burime të reja informacioni, përzgjedhja e materialeve me seleksionime.

Mehmet Akifi vetë ishte besimtar dhe porositi që orientues duhet të jetë Kur’ani dhe mësimet kuranore duhen trajtuar me gjuhën e kohës, apo me rrethanat në të cilat ndodhet vendi apo individi. Ai ishte dhe mbetet edhe për të mësuarit një model në zhvillimin e mendimit të kohëve moderne.

Veprimtaria aplikative e profesorit Mehmet Akif Ersoj e karakterizuar, siç u theksua më sipër, fillon nga njohja e thelluar e parimeve themelore didaktike, duke ruajtur vërtetësinë në përmbajtjen e lëndëve që zhvillonte, në optikën

shkencore të Historisë, Gjuhës dhe Letërsisë, me një logjikë dhe argument bindës për nxënësit e studentët. Edhe në veprimtaritë jashtë auditorëve universitarë, në ligjëratat që mbante edhe në tri xhamitë e mëdha të Stambollit, kishte parasysh veçoritë e dëgjuesve, zbatimin e një stili të bisedës në nivel të thjeshtë e popullor, me argumente, duke e bërë bisedën apo ligjërimin interesant, çka përbën edhe sot e kësaj dite një parim didaktik shumë të domosdoshëm, në përshtatje të kohës, të situatave që kalon vendi apo zona konkrete.

Synimet edukative të Mehmet Akifit, në drejtim të moralit, të familjes, sidomos për virtytin etj., të kujtojnë edhe një nga fushat kryesore që synonte edhe pedagogu gjerman i nivelit botëror, Herbart, pikëpamjet pedagogjike të të cilit, edhe pse janë mbi dy shekuj përpara, depërtuan më vonë te ne, në Shqipëri, në vitet 1920-1937, kur u bënë edhe dominuese në arsimin tonë, sepse i sollën studentët tanë të atëhershëm, në Austri. Sipas materialeve pedagogjike që më kishte dërguar nga Turqia, miku im, i ndjeri Profesor Nexhip Alban, kjo shërbeu si kolonë e fuqishme e punës për forcimin e karakterit edukativ të shkollës.

Duke ngulmuar për edukimin atdhetar të brezive të reja, e shtronte çështjen më gjerë, te morali, ruajtja e tij e shëndoshë dhe përmes tij, si pjesë shumë e rëndësishme, të nisej nga

themeli, familja. Funksionimi i mirë dhe i shëndoshë i kësaj qelize bazë të shoqërisë, do të na çojë patjetër tek atdhedashuria në vështrim më të gjerë e konkret. Ai e donte dhe ka luftuar për Atdheun e vet Turqinë, si edhe e ndjente dhe përpiquej në të gjitha mënyrat ta ushqente këtë edhe për Shqipërinë, dhe të qenët shqiptar e theksonte pa mëdyshje, me gojë e me shkrim, madje edhe në poemat e tij. Kuptohet si ndjeheshin nxënësit, studentët e tij, prindërit e tyre shqiptarë ose me origjinë të tillë, kur e deklaronte veten shqiptar. Në poemën “Jam shqiptar” përmendte Kosovën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën. Në poezinë e tij “A e njef Kosovën?”, shkruan:

“Po si mund ta njifje?

Po, edhe po pse s’e njef, ke të drejtë

S’ka lanë gur mbi gur egërsira e tërbuar

Mijra jetë priten, sikur të priteshin drujtë në pyll

Ç’hije e zezë ka rënë mbi atë Kosovë të blertë”

Në vitin 1913, në kohën kur shpallet vendimi makabër për copëtimin e trojeve shqiptare, Mehmet Akif Ersoj shkruan poemën “Unë jam Shqiptar”, duke iu drejtuar babait të tij të vdekur: “Baba, Ngrihu! Të gjallët nuk u erdhën në ndihmë, të paktën ti eja!... Shqipëria po digjet kësaj here...”

Më tutje i bën thirrje shqiptarëve të bashkohen, t'i dalin zot Atdheut”.

Një nga idetë e mëdha që trajton Mehmet Akif Ersoj është familja, por ne po e trajtojmë si shkencë, siç është “Pedagogjia familjare”. Themelet e kësaj disipline shkencore i hodhi Komenski, me veprën e tij “Shkolla Amnore”, ose “Shkolla e nënës”. Pas Komenskit, shkroi Pestaloci veprën “Nëna dhe fëmija”, etj. Edhe Mehmet Akif Ersoj e trajtoi krejtësisht me realizëm, në mënyrë origjinale këtë temë: “Nënave të mia fisnike”, të cilave u drejtohet:

“Ju jeni nëna të të gjithë dijetarëve gjeni

Pa pare e interesa me shpatë po shërbeni

Me mëshirën tuaj, s’mund të bëhet rivale”

Në këtë aspekt, Mehmet Akifi përmes veprave letrare trajton ruajtjen e familjes, rolin shumë të rëndësishëm të nënës në këtë fushë, si dhe të babait, si dy shtylla të forta që e mbajnë e zhvillojnë dhe e forcojnë familjen e rolin e saj për edukimin moral të pjesëtarëve. Trajtimin e kësaj teme nuk e trajton në mënyrë të njëanshme, por nisur nga jeta reale, e analizon në dy pamje: rolin e jashtëzakonshëm të nënës në familje dhe në funksionimin moral të saj, por ndalet edhe në anët negative, duke demaskuar babanë që nuk është në rolin e vet, një pijanec i degraduar,

që kërkon të jetojë në kurriz të një gruaje, të cilën e ka shfrytëzuar dhe e ka bërë të katandiset në një shkallë të tillë, që të shesë veten te klientët e saj. Në këtë poemë “Mejhaneja” paraqet skena kur gjithçka është kalbur, burri pijanec, i degraduar, që nuk do t’ia dijë për grua e familje, por edhe vajza që është në këtë mikromjedis familjar, denigrohet nga opiniononi se e bija e kujt është. Ky burrë i degraduar edhe gruan enkas e ka zgjedhur të tillë. Kështu, në mënyrë të qartë, nxjerr rolin e familjes, të nënës e të babait, të pjesëtarëve të saj, që përbëjnë një mikromjedis në degradim dhe pasqyrimin me vërtetësi të pamjeve nga të cilat distancimet dhe ballafaqimet e krahut tjetër, të prindërve idealë, ku secili kryen funksionin e vet.

Mehmet Akifi shkroi për njeriun, sjelljen e tij, për paqen, për familjen dhe mbrojtjen e saj, për parandalimin e shkatërrimit të saj. Ai vetë ishte një model, familjar shembullor, familjes dhe gruas së tij i drejtohet edhe me një nga poezitë që shkroi enkas.

I ftuar nga Universiteti El-Ez’her në Kajro, Mehmet Akifi shkoi atje dhe punoi dhjetë vite (1926-1936), profesor në Universitet, duke zhvilluar Gjuhën dhe letërsinë Turke dhe Turke Osmane. Nuk ishte rastësi që nuk e refuzoi ftesën sepse në Kajro, veç të tjerash, kishte edhe shumë shqiptarë. Pas ardhjes së Mehmet Ali Pashës në Egjipt, ishin afro 50000 shqiptarë vetëm

në rrethinat e Kajros. Diaspora shqiptare në Egjipt ishte shumë e shumë herë më e madhe, por shkoi drejt asimilimit. Atje kishte edhe personalitete të letërsisë, të artit, lojtarë me emër me origjinë shqiptare. Atje u krijua “Bleta Shqiptare”, doli “Valët e Detit” të Spiro Dines e Filip Shirokës, etj. Atje punuan figura të shquara të periudhës së pas pavarësisë së Shqipërisë. Fakti që Mehmet Akifi e fliste mirë gjuhën shqipe, prania e tij i bënte të ndjeheshin mirë intelektualë dhe qytetarë të thjeshtë që kishin emigruar atje, ose ishin me origjinë shqiptare.

Mjediset shqiptare në diasporën e Kajros kishin veprimtari, hapësira pune, e cila vazhdonte natyrshëm deri në ardhjen në pushtet të Naserit. Atëherë shqiptarët nuk u ndjenë si më parë dhe filluan të emigrojnë në ShBA, në Kanada, Argjentinë, etj.

Veprimtaria akademike, përvoja e pasur dhe potencialet multidimensionale të Mehmet Akifit, e vazhduan emrin e madh shumëplanësh. Mehmet Akifi u shqua edhe si pedagog i aftë, që e bënte për vete auditorin e studentëve me vizionet e gjera që kishte, aq i dashur dhe i adaptueshëm për studentët, duke e pasuruar kurrikulën e lëndëve që zhvillonte me informacione të reja, me interpretime interesante dhe vizionare. Ishte fatbardhësi për studentët që dëgjonin leksionet nga një profesor aq i gjerë e në shume fusha shkencore, politike, artistike, sportive e fetare, sa që e bënë edhe Mehmet Akifin të ndjehej mirë. Por, për arsye shëndetësore u largua për në Stamboll, pikërisht në vitin e dhjetë të punës në Universitet, duke lënë një emër të madh edhe në fushën e arsimit, të kulturës e të shkencës, jo vetëm turke, por edhe shqiptare e botërore.

Bibliografi

- Mehmet Akif Ersoj, “Safahat”, Stamboll, 1996.
- Vizitë në Muzeun Mehmet Akif Ersoj, Ankara, 1996.
- Saadi Shirazi: “Gjylistani dhe Bostani”, shqipëruar nga Vexhi Buharaja, Onufri.
- Gazmend Shpuza “Ataturku dhe Shqipëria”, Dituria, 1995.
- Musa Kraja: “Mësuesit për Kombin Shqiptar, Toena, 1993.
- Musa Kraja: “Nexhip Alban dhe Mendimi Pedagogjik i Tij”, Toena, 1992.
- Musa Kraja - Nexhip Alban: “Jonuz Emre, Edukator i Madh Popullor”, 2000.
- Mehmet Akif Ersoj “Safahat” (Fletët) botimi i tretë, Stamboll, 2000, ALSAR.

Aspekti fetar (me theks islam) në poezi. Poezia një rrugë drejt shpirtit.

Msc. Entela Hidri

Abstrakt

Poezia është një ndër llojet më të bukura të letërsisë dhe të artit të fjalës. Theksi në aspektin fetar, për mua, ka rëndësi të veçantë, sepse i jep një tjetër prioritet poezisë. Trajtesa e krijimit poetik si një krijim pasqyrues i krijimit të Zotit, i jep vlerën e mistikës dhe shpirtërores kësaj poezie. Cilësia e poezisë si tekst është, se ajo i prek të gjitha dimensionet e jetës. Pra poezia trajton çdo tematikë dhe çdo hapësirë të mendimit. Është një ndër llojet më të vështira e më të ngritura letrare.

Poezia gjen një rrugë për t'u qasur drejt shpirtit. Ajo, me anë të mistikës, përqaset me vetë krijimin e zotit, jo për t'u krabasuar, por për të lavdëruar Krijuesin dhe krijimin e Tij universal dhe unik. Bukuria e fjalës poetike nuk vjen nga vetja, e pikërisht këtu konsiston edhe mistikja. Kjo poezi i ka të gjitha elementet strukturore të llojit letrar të poezisë që nga figuracioni, ritmi, rima e çdo detaj... Elementi mistik i jep asaj një vlerë të shtuar. E pikërisht ajo rrymë letrare, e cila i dha prioritet trajtimit të tematikës dhe të elementit mistiko-fetar, ishte letërsia e bejtexhinjve.

Tematikat e kësaj poezie variojnë nga temat rreth Zotit, moralit, etikës, respektimit njerëzor, etj.

Mirëqenia e botës estetike të një poezie të mbështetur në elemente të mistikës-fetare islame, ka një vlerë të veçantë si në aspektin social, ashtu edhe në aspektin artistik. Mbeten për t'u shqyrtuar edhe krijimtari të tjera të cilat e vlerësojnë dhe e përdorin elementin fetar.

“Betohem në penën dhe në atë
çka shkruajnë”

Kur'an, 68:1.

1. Hyrje

Trajtimi i elementit mistik në poezi, është me vlerë, jo vetëm për elementin fetar, por në radhë të parë për vetë thelbin e poezisë. Poezia me element fetar ka një vlerë të veçantë, e cila u shqua dhe u paragjykua si e prapambetur në vitet e shembjes së kulteve, diktaturës. Ky studim ka si qëllim vëzhgimin e lidhjes dhe ndërthurjes së poezisë me elementet fetaro-mistike.

Objektivat e këtij punimi synojnë analizën e lidhjes së poezisë me lexuesin dhe botën e tij shpirtërore, trajtimin e ndërthurjes dhe depërtimit të elementit fetar në poezi, hedhjen e një vëzhgimi të shpejtë mbi letërsinë e bejtexhinjve, se dhe trajtohemi i mirëqenies së botës shpirtërore që trajtohet në poezi.

Ky punim është një fillesë e një punimi më të detajuar në lidhjen me poezinë me elemente fetare Islame, e cila u marxhinalizua dhe u etiketua si e prapambetur nga studimet për 50 vite me radhë, tezë e pa vërtetë e cila i humbet vlerën e paçmuar kësaj poezie.

2. Poezia dhe magjia e krijimit

Poezia është një mënyrë e drejtpërdrejtë për të arritur drejt

shpirtit, pra ka një lidhje mes shpirtërores dhe krijimtarisë. Letërsia shqipe në veçanti i ka fillesat te letërsia fetare. Le të themi që poezia shqipe ka lindur pakëz vonë krahasuar me vjetërsinë e popullit tonë, ose me krijimtarinë gojore në gjuhën shqipe.

Ne, në fakt, nuk duhet të na interesojë këndvështrimi besimtar i poetit, por ana fetare e poezisë, bota shpirtërore e vetë poezisë. Fetarja, ose mistikja, shfaqet te poezia në kohëra dhe vende të ndryshme. Ka periudha historike të cilat e diktojnë më së shumti krijimtarinë me prirje fetare dhe mistike.

Të gjitha llojet letrare janë në konkurrencë se cila të fitojë terren dhe vëmendje te lexuesi, por sot nuk ekziston një këndvështrim i tillë në vëmendjen tonë. Në fakt vitet e fundit poezia ka humbur terren, sepse ka shumë pak lexues që prirën drejt poezisë.

Zhan Pol Sartri shkruan në librin e tij *Ç'është letërsia?*: “... ‘Kohët Moderne’ botojnë gjithnjë e më pak poezi. Për t’u bindur mjafton t’u hedhim një sy prodhimeve bashkëkohore.”¹

Poezia është në fakt gjetja e një rrugë për të shkuar drejt shpirtit. Me anë të saj shpesh zbërthejmë dhimbjen shpirtërore, lumturinë, dashurinë, dashurinë për atdheun, luftën etj. Pra të gjitha ngjyrat e

1. Zhan – Pol Sartri, *Ç'është letërsia?*, DeaS, Tiranë, 1998, f. 9.

shpirtit. Poezia i prek të gjitha dimensionet e jetës, që nga ato personale e deri te ato kombëtare e universale. Poezia është një formë magjie. Me anë të lojës së fjalës, poeti tërheq dhe mahnit lexuesin.

Ashtu si hekurkthyesi laton dhe rregullon hekurin, ashtu edhe poeti ynë laton dhe rregullon fjalën poetike. Një galeri e tërë figuracioni vendoset në funksion të gjuhës poetike, të cilat me shije të hollë i përzgjedh secili lexues. Pra gjuhën poetike, poeti nuk e përdor vetëm si një kanal komunikimi vajtje-ardhje, por ai i përdor fjalët jo vetëm si koncepte, por edhe si kontekst dhe si sonoritet rimues.

3. Elementet mistiko-fetare në poezi

Le të themi se poezia shpesh ka përdorur edhe gjuhën e së shenjtës, ose elemente fetare në të. Madje, nga një këndvështrim, ne përdorim për një poet edhe termin 'krijues' i një poezie. Pra ai me anë të botës së fjalës, mundohet të krijojë dhe të argëtojë, informojë, apo edhe mësojë lexuesin. Le të themi që feja mundohet dhe shpjegon vizionin për botën, pra edhe poezia me përmbajtje fetare, e bën më të bukur dhe më të kuptueshme botën e poezisë. Poeti me anë të poezisë së tij e ka të vështirë të ndajë jetën e vërtetë nga realiteti i krijimit poetik. Në shumë poezi shohim krijime që s'kanë ekzistuar kurrë, ose forma e

tyre reale, është përsosur në botën e poezisë. Pra një krijues që e njeh Zotin, le të themi që nga kjo buron edhe krijimtaria e tij.

Nga "Divani" i Imam Shafiut, po shkëpusim këto vargje për të konkretizuar atë që thamë më lart:

Bëhu i devotsbëm ndaj zotit, në qoftë se je hutuar!

Të mirat t'i sjell nga diçka e pamenduar.

Pse vallë ke frikë varfërinë?,

Ka ushqyer zogun dhe peshkun kur noton.²

Bukuria e një poezie në thelb, në fakt, nuk është se vjen nga vetja, ajo është e ardhur edhe nga krijimi i të madhit Zot.

"Siç e përmendëm edhe në fillim, bukuria e trëndafilut nuk vjen nga vetvetja e as nga përjetimi yt, ajo është pasqyrimi ynë, ajo është pasqyrim i cilësisë hyjnore të bukurisë."³

Pra shpjegohet më së qarti se, aspekti shpirtëror ka të bëjë edhe me anën mistiko-fetare. Dashuria e poetit në krijim vjen nga krijuesi më suprem, që është Zoti.

Sidoqoftë, ky studim nuk synon poezinë fetare të mirëfilltë, po elementet fetare në poezinë letrare.

2. Divani i imam Shafiut, poezia Kujtesa.

3. Beshir, Ajvazoglu, Estetika Islame, LOGOS-A, Shkup, 2009, f. 51.

4. Si u paraqit fetarja te Bejtexhinjë

Pati shumë poetë dhe rryma letrare, ose periudha të cilat përdorën mistiken, qoftë kjo si një frymë që e ka përshkruar të gjithë krijimtarinë, por qoftë edhe për ndonjë krijim të veçantë, në të cilin u përdorën elemente fetare. Një tjetër letërsi e cila e ushtroi mistiken ishte edhe Alamiado, ose letërsia e bukur e bejtexhinjve, ku thelbi i tyre anonte herë-herë edhe nga fetarja. Divanet, si i Nezim Frakullës, i cili, si një pjesë e mirë e bejtexhinjve, u frymëzua nga autorët e lindjes nga të cilët edhe u huazua prej poetëve persian, turq e orientalistë dhe kanë të përzier në të, jo vetëm bukurinë e jetës dhe të vashës, por edhe mistiken dhe kënaqësinë me dhuratat e Zotit.

*Bismil-labi nisa divanë
Për sevda tënde ja Mevla,
Për Muhammed Mustafanë
Zemra rrate ja Mevlâ⁴*

Bejtet janë krijimtari në vargje, pra lidhen drejtpërsëdrejti me poezinë. Divanet janë forma poetike, ku përveç lartësimit të ndjenjës dhe qenies njerëzore, aty lartësohet edhe Zoti. Që një krijimtari e tërë, e cila u mor me pjesën mistike në forma të ndryshme. Poezia e bejtexhinjve vjen nga njerëz intelektualë e të ditur, pra kishte element fetar, por jo qorrazi. Elementet mistike lidhen me thirrje

4. Abdullah Hamiti, *Nezim Frakulla dhe divani i tij shqip*, Logos-A, 2008, f. 288.

për t'ju kthyer shpirtërores dhe mosdhënies pas botës materiale.

Shumë autorë të tjerë bejtexhinj folën dhe e trajtuan poezinë dhe mistiken në të, si për shembull: Sulejman Naibi, Muhamed Kyccuku, Zyber Hallulli, etj.

Poeti me elemente fetare, në fakt, ka një dallim, sepse nuk e kërkon bukurinë te bota fizike, por veçanërisht te bota e brendshme shpirtërore dhe pikërisht në këtë kupë merr frymëzim poezia e tij.

“...Profeti i ka dashur poetët, se i ka mbrojtur disa poetë...”⁵ pra edhe nga kjo rrjedh ligjshmëria ku poetët fetarët bazohen në lidhje me poezinë.

Poezia me elemente fetare, e bën njeriun të “komunikojë” me Zotin. “vetë adhurimi ndaj Krijuesit shprehet si një kombinim i komunikimit gjuhësor dhe i veprimt fizik të njeriut besimtar”⁶, ai edhe beson, por nga ana tjetër edhe komunikon me anë të poezisë së tij.

Le të themi se, poeti shkarkon në poezinë e tij zbrazëtinë shpirtërore, ose flet në të edhe për brengat mbarë njerëzore, duke përfshirë edhe boshllëkun e lexuesit. Çdo poezi përmban filozofinë e saj të brendshme dhe si pasojë ka një bosht mistik rreth të cilit duhet të sillet, gjë të cilën shpesh e shohim hapur, ose e gjejmë të fshehur mes vargjesh, në

5. Beshir, Ajvazoglu, *Estetika Islame, LOGOS-A, Shkup, 2009, f. 77.*

6. Milazim Krasniqi, *Letërsia dhe besimet fetare, LOGOS-A, Shkup, 2010, f. 29.*

kontekst. Në këto poezi me nuancë fetare, ne gjejmë moral dhe fisnikëri.

Poeti, i cili e mbështet mistiken, e kërkon atë në krijimet e tij duke i paralelizuar ato me natyrën dhe krijimin e Zotit. Pra çdo pjesë e natyrës në një poezi na sjell refleksione rreth mistikes. Zoti e krijoi natyrën, edhe poeti mundohet ta “rikrijojë” natyrën me fjalë, sepse e njeh dhe me anë të fjalës e përlligj unicitetin e krijimit të Zotit.

Poezisë me elemente mistike nuk i mungojnë elementet estetike. Ajo ka metër, rimë, ritëm, eufemi, stilistikë e semantikë, si çdo tekst tjetër poetik.

Edhe poeti i madh Naim Frashëri, një pjesë të mirë të krijimtarisë së tij ia adreson besimit ndaj Zotit, deri madje në vënien e vulës së Zotit në poezitë e tij, duke përlligjur faktin se krijimtaria vjen nga vetë Ai. Në vargjet e tij ai thotë:

*Se ngado që të kthej sytë,
Shoh atje Zot'n e vërtetë
Q'është një e s'ka të dytë.⁷*

Pra kjo lloj poezie nuk flet vetëm për njeriun, por edhe për mënyrën e tij të jetesës dhe në një farë mënyre është edhe didaktike.

5. Disa tema të poezive me elemente mistike.

Tema e trajtimit të Zotit si një fuqi e panjohur, por e ndjeshme, e

7. Naim Frashëri, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 76.

plotfuqishme, fuqi nga e cila vjen ekzistenca dhe forma e krijimit.

Në këto poezi gjejmë të flitet edhe për nisjen në *jetën e përtejme*, si një e panjohur si për poetin edhe për lexuesin.

Trajtimi i *moralit*, si një sistem njerëzor, i cili po të respektohet sjell rregull mbi jetën njerëzore në mbarë rruzullin tokësor.

Tema e *vdekjes* është një ndër temat dhe dilemat e kësaj poezie, etj.

6. Mirëqenia njerëzore dhe mirësjellja në aspektin human.

Poezia është munduar të mbajë qëndrime gjithnjë ndaj fetares, edhe në raste mbështetje apo kundërshtimi, përsëri ajo e mban prezent, mistiken. Një vështrim më i detajuar do të ishte një studim më rezultativ, sepse duhet të studioheshin të gjitha kahet e mistikes, në të gjitha poezitë e mbarë botës dhe te të gjitha religionet, për të bërë diferencën e një poezie me përmbajtje dhe njohje fetare nga ajo afetare.

“Një letërsi e krijuar mbi aksiomën e ndjeshmërisë së Zotit, të afirmimit të mësimëve e të udhëzimeve të shpalljeve hyjnore, të respektimit të mesazheve paqësore të profetëve, të të kuptuarit se ekziston edhe bota tjetër, do të pasuronte besimin dhe vizionin e njeriut për veten dhe për të ardhmen e tij.”⁸

Autorët mistikë, edhe talentin e tyre ia atribuojnë aspektit mistik të poezisë së tyre. Në fakt ka edhe një

8. Milazim Krasniqi, Letërsia dhe besimet fetare, LOGOS-A, Shkup 2010, f. 287.

cilësi të cilën nuk mund ta lëmë pa përmendur, që spikat në poezinë e poetëve fetarë. Fjala e tyre është e vërtetë. Pra ata nuk përdorin gënjeshtrenë në krijimtarinë e tyre, për shkak të fetares që e shoqëron këtë krijimtarinë. Kjo poezi është e drejtë edhe në planin njerëzor e social, pra trajton edhe probleme të shtresave të ulëta. Le të themi që poezia me elemente fetaro-mistike, e trajton Zotin si të vetmin udhëheqës, si rrjedhojë nuk njih nënshtrim njerëzor. Njeriu nuk ka funksion drejtues individual, por ka funksion zbatues të ligjeve hyjnore, qoftë edhe në poetizimin e tij. Kjo s'do të thotë që poetët me elemente fetare nuk kanë krijuar edhe letërsi me motive jo mistike dhe shembujt për këtë janë të shumtë.

7. Sugjerime.

Së fundmi, duke e theksuar se ky punim është vetëm fillimi i një studimi të thelluar të elementeve mistike në poezinë në përgjithësi dhe të poezisë shqipe në veçanti, mendoj se kësaj teme duhet t'i japim vlerën dhe rëndësinë e veçantë.

Theksoj faktin se elementeve mistike nuk i është dhënë vlera e duar në tekstet artistike e veçanërisht në poezi, sepse pikërisht elementi mistik është ai i cili mbush një hapësirë si ajo e boshllëkut shpirtëror. Andaj, ky element, duhet studiuar e vlerësuar.

Së fundmi, por jo më pak i rëndësishëm, them se besimi është drejtimi më i mirë për të pasur një drejtim artistik të drejtë, larg rrengjeve e pseudo artit, në emër të të cilit bëhen çudira.

Bibliografia

- A. Vinca, Teori letrare prej antikës deri te postmodernizmi, Libri shkollor, Prishtinë, 2012.
Anton N. Berisha, Veçanti ligjërimesh poetike, EuroLindja, 1996.
Behxhet Jashari, Vështrim ndaj orientalizmit dhe orientalistëve, U.C.O.F.O.S, Tiranë 2008.
Beshir Ajvazoglu, Estetika Islame, LOGOS-A, Shkup, 2009.
Milazim Krasniqi, Letërsia dhe besimet fetare, LOGOS-A, Shkup 2010.
Naim Frashëri, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1978.
Zhevad Karahasa, Divan lindor, Botime Alsar, 2015.
<https://www.doktoratura.unitir.edu.al> 2015/09/Doktoratura-Fabiola-Kadi-Muca-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Letersise.pdf
<https://www.zeriislam.com> Letërsia mistike islame dhe Mevlana Rumi Abdullah Rexhepi, 3 korrik 2011.
<https://www.ibnisisina-ks.com> Junus-Emre-dhe-poezia-e-tij-mistike, 10 Nëntor 2014.
<https://www.forumshqiptar.com> Poezitë dhe-divani-i-Imam-Shafiut, 8.04.2007.
<https://www.shqiperia.com> Besimet_fetare, 2008.

Kontributi i Piri Reisit dhe Evlija Çelebiut në zhvillimin e shkencës së gjeografisë

Msc. Artan S. Mehmeti

Abstrakt

Gjatë jetës së tij Piri Reis dha një kontribut të madh për shkencën e gjeografisë dhe hartografisë. Në kohët moderne ai është i njohur për hartat dhe grafikonet, të cilat i ka botuar në librin më titull “Kitab-ı Bahriye”. Ky libër gjithashtu përmban informacione të detajuara mbi navigacionin, si dhe grafikone shumë të sakta (për kohën e tyre), duke përsëkruar porte dhe qytete të rëndësishme në Detin Mesdhe. Ai fitoi famë si hartograf, ku një pjesë e vogël e hartës së tij për botën (të punuar më 1513), u zbulua në vitin 1932 në pallatin Topkapı në Stamboll. Harta e tij për botën, është harta më e vjetër në atlaset turke, e cila tregon Botën e Re. Kjo hartë gjithashtu është një nga hartat më të vjetra për Amerikën që akoma ekziston diku (hartat më të vjetra për Amerikën që ende ekziston është harta e punuar nga Juan de la Cosa në vitin 1500, e cila ruhet në Muzeun Detar (Museo Naval) të Madridit në Spanjë). Hartat e tij janë të përqendruar në Sahara dhe gjerësinë e tropikut të gaforres.

Ahmed Muhiddin Piri (Piri Reis) (1465/70 – 1554/55)

Vendi i saktë i lindjes së tij nuk dihet. Ai mendohet se ka lindur ose në pjesën evropiane të perandorisë osmane përkatësisht në qytetin Gelibul, që i takon Trakisë

Turke, ose në qytetin e vendlindjes së babait të tij Karaman që ndodhet në Anadollin Qendror, apo në pjesën jugore të Turqisë Qendrore. Edhe sa i përket origjinës së tij ka diskutime. Burimet e ndryshme i referohen idesë se të parët e tij mund të jenë të krishterë grekë, hebrej apo turq



Figura 1. Piri Reis.

etnikë. Piri ishte një gjeneral osman, gjeograf dhe hartograf.

Gjatë jetës së tij Piri Reis dha një kontribut të madh për shkencën e gjeografisë dhe hartografisë. Në kohët moderne ai është i njohur për hartat dhe grafikonet, të cilat i ka botuar në librin më titull “Kitab-ı Bahriye”. Ky libër gjithashtu përmban informacione të detajuara mbi navigacionin, si dhe grafikone shumë të sakta (për kohën e tyre), duke përsëritur porte dhe qytete të rëndësishme në Detin Mesdhe. Ai fitoi famë si hartograf, ku një pjesë e vogël e hartës së tij për botën (të punuar më 1513), u zbulua në vitin 1932 në pallatin Topkapi në Stamboll. Harta e tij për botën, është harta më e vjetër në atlaset turke, e cila tregon Botën e Re. Kjo hartë gjithashtu është një nga hartat më të vjetra për Amerikën që akoma ekziston diku (hartat më të vjetra për Amerikën që ende ekziston është harta e punuar

nga Juan de la Cosa në vitin 1500, e cila ruhet në Muzeun Detar (Museo Naval) të Madridit në Spanjë). Hartat e tij janë të përqendruar në Sahara dhe gjerësinë e tropikut të gaforres.

“Kitab-ı Bahriye” është një nga librat e parë modern që ka trajtuar metodat e lundrimit, duke përfshirë një hartë të botës. Në vitin 1513 Piri Reis punoi hartën para-moderne për tërë Botën e njohur deri atëherë. Gjysma e hartës së mbijetuar tregon brigjet e Evropës Perëndimore dhe Afrikës Veriore, kurse gjysma tjetër tregon me një saktësi të lartë brigjet e Brazilit, gjithashtu në këtë hartë ai paraqet edhe ishujt që ndodhen në hapësirën e Oqeanit Atlantik, siç janë Ishujt Azore, Kanaire, Ishulli Mitik i Antillasë, siç e quan Piri Reis, ndoshta edhe Japonia. Rëndësia e kësaj harte qëndron në demonstrimin e shtrirjes së eksplorimit të saj në Botën e Re në vitin 1510, ndoshta para të tjerave. Si bazë në përpilimin e kësaj harte, Piri Reis përdori 10 harta arabe, 4 harta indiane me burime nga portugezet dhe një hartë të Kolombit.

Në këtë tekst Piri Reis thekson se si burim ka përdorur “hartat të punuara në kohën e Aleksandrit të Madh”, por ka shumë të ngjarë që ai ta ketë ngatërruar me gjeografinë e lashtë greke të Ptolomeut të shek. II p.e.s. Harta e Piri Reis është e ngjashme me hartën e Aleksandrit të Madh të Ptolomeut (prej 6 shekujsh më parë), e riprodhuar nga Jan of Stobnica (Jan ze Stobnicy), e punuar më 1512.




Figura 2. Një pjesë e hartës së mbijetuar nga Harta e Botës, punuar nga Piri Reis në vitin 1513.

Në librin “Kitab-ı Bahriye”, Piri Reis përmirëson gabimin e dorëshkrimit të Kolombit (sikurse besonte Kolombi se Kuba ishte një gadishull Kontinental), e që nga viti i punimit të këtij dorëshkrimi, spanjollët kishin që dy vite që ishin vendosur në Meksikë. Përveç hartave, libri përmban informacione të detajuara mbi portet e mëdha, gjiret, humnerat detare, gadishujt, ishujt, ngushticat, strehimoret ideale të Detit Mesdhe, teknikat e lundrimit, si dhe informacione astronomike që kanë të bëjnë me lundrimin detar. Ai në këtë libër shkruan edhe për popullsinë lokale të çdo krahine dhe qyteti, ku më shumë ishte i interesuar të dinte rreth aspekteve kulturore të tyre. Ky libër ka gjithsej 30 legjenda për hartën e botës, prej tyre 29 legjenda janë në gjuhën turke dhe një në gjuhën arabe. Legjenda e fundit

përmban edhe kohën e punimit – muaji Muharrem viti 919 hixhri (që korrespondon me pranverën e vitit 1513). Shumica e studimeve janë të identifikuar me kohën e përfundimit si viti 1521, apo ky punim u rishikua më 1524-5, me informata shtesë dhe tabela të hartuara më mirë, më qëllim që t'i jepet si dhuratë Sulejmanit I. Botimi i korrigjuar kishte një vëllim prej 434 faqesh, që përmbanin rreth 290 harta.




Figura 3. Harta e Detit Egje, punuar nga Piri Reis.

“Kitab-ı Bahriye” përbehet prej dy pjesëve kryesore. Pjesa e parë është e dedikuar për njohuritë rreth llojeve të stuhive, teknikat e përdorimit të një busulle, listë të hartave detare të shoqëruara me grafikone për bregdetet dhe qytetet e tyre, metoda për orientim me anë të yjeve, si dhe disa veçori të oqeaneve të mëdhenj së bashku me tokat përreth tyre. Theks të veçantë në këtë pjesë i është dhënë zbulimit të Botës së Re nga Kristofor Kolombi dhe Vasco de Gama dhe detarëve të tjerë portugez, si dhe rrugëve të tyre për në Indi e në pjesët e tjera të Azisë. Pjesa e dytë e librit përbehet kryesisht nga një

listë e hartave detare dhe udhëzues të lundrimit. Çdo temë përmban hartën e bregdetit apo ishullit. Në librin e parë (1521), kjo pjesë ka gjithsej një listë prej 132 hartave detare, ndërsa në librin e dytë ka një listë prej 210 hartave detare. Pjesa e dytë fillon me përshkrimin e Ngushticës së Dardaneleve dhe vazhdon me ishujt e brigjeve të Detit Egje, Jon, Adriatik, Tirren, Ligurian, Rivierën Franceze, Ishujt Balerik, brigjet e Spanjës, Ngushticën e Gjibraltarit, Ishujt Kanare, brigjet e Afrikës Veriore, Egjiptit, Lumin Nil, bregdetin e Levantit (bregdetit lindor të Mesdheut) dhe bregdetin e Anadollit. Kjo pjesë gjithashtu përfshin edhe vizatime të ndërtesave dhe monumenteve të qyteteve të njohura, si dhe informacione biogeografike për çdo qytet. Piri Reis shpjegon arsyen se pse ka preferuar që të punojë një listë të hartave në këtë libër, në vend që të punojë një hartë të vetme, e cila nuk do të kishte mundur që në vetvete të përmbajë kaq shumë informata të detajuara.

Në vitin 1528, Piri Reis punoi hartën e dytë të botës (ku pasqyrohet

Groenlanda dhe Amerika e Veriut, duke filluar nga rajoni verior i quajtur Labrador, Floridën, Kubën dhe vazhdon me pjesën e Amerikës Qendrore), një pjesë e vogël e kësaj harte ka mbijetuar deri në ditët e sotme. Edhe pse Piri Reis nuk ishte një eksplorues dhe nuk lundroi kurrë në Oqeanin Atlantik, këtë hartë ai e punoi duke i bashkuar rreth 20 harta të autorëve arabë, spanjollë, portugezë, kinezë, indianë, si dhe harta të grekëve të vjetër.

Një shekull pas vdekjes së Piri Reis, si dhe gjatë gjysmës së dytë të shek. XVII, është botuar versioni i tretë i këtij libri, duke mos i prekur fare tekstin, e duke pasuruar pjesën hartografike. Ai përfshin harta të tjera të reja në shkallë të madhe (kryesisht kopje italiane nga Battista Agnese e Jacopo Gastaldi, dhe holandeze nga Abraham Ortelius, të punuara një shekull më parë. Këto harta që kanë përshkruar Detin e Zi, kanë qenë më të sakta e nuk janë përfshirë në origjinal.

Kopje të librit “Kitab-ı Bahriye” janë gjetur në shumë biblioteka dhe muze në mbarë botën.

Figura 4. a) Një kopje e hartës së Evropës së shekullit XVI e ndodhur në Kitab-ı Bahriye, b) Një pjesë e hartës së mbijetuar nga Harta e Botës, punuar nga Piri Reis në vitin 1528.



Evlija Çelebi (1611 – 1682)

U lind dhe u edukua në Stamboll, që në atë kohë ishte qendër e perandorisë osmane. Familja e tij kishte marrëdhënie të ngushta me oborrin mbretëror. Evlija Çelebi u bë i njohur për të dhënat e vëzhgimet që botoi rreth vendeve ku kishte udhëtuar. Ai njihet edhe për kontributin e dhënë në gjeografi dhe histori.




Figura 5. Piri Reis.

Pas Haxhi Kallfës, Evlia Çelebiu ishte padyshim gjeografi më i madh i perandorisë turke. Emri i tij i vërtetë ishte Muhamed Zil-li ibni Dervish, por në kohën e tij pseudonimet e vetësjauara ishin në modë dhe parapëlqeshin mjaft. Ishte njeri me kulturë të gjerë, ku me shënimet e tij nga udhëtimet e gjata e të shumta në treva të Azisë, Afrikës dhe Evropës shkroi shumë libra. Librat e tij përfshijnë një periudhë 40 vjeçare dhe përmbledhen në një vepër prej 10 vëllimesh, të titulluar “Seyahatname”. Ky libër

ka një rëndësi të veçantë, sepse nuk përmban vetëm përshkrim të thjeshtë të elementeve që autori has gjatë rrugëtimit, por jep informacione të rëndësishme mbi historinë dhe organizimin shtetëror të perandorisë osmane dhe të vendeve të tjera, si dhe pikëpamjen personale të autorit. Në këtë libër Çelebi përshkruan natyrën e vendeve që ai i viziton, organizimin urban dhe arkitekturën e ndërtesave të qyteteve nëpër të cilat kaloi, gjuhët dhe dialektet e popujve që i takoi dhe karakteristikat e tyre. Për sa i përket çështjeve gjuhësore, Çelebi flet për leksikun e këtyre gjuhëve, formën e tyre, sintaksën, si dhe përshkruan shqiptimin e tingujve. Përshkrimet e tij mbi organizimin urban, hapësirat e gjelbra, menaxhimin e ujit, formacionet mbrojtëse dhe arkitekturën e ndërtesave janë informacione të rëndësishme për historinë e arkitekturës. Machiel Kiel, autor i librit “Arkitektura Osmane në Shqipëri”, shkruan se vepra e Çelebisë është shumë e pasur dhe e vlerësueshme dhe ajo duhet të merret në konsideratë, veçanërisht për sa i përket arkitekturës fetare myslimane dhe ndërtimeve osmane. Ndërtesat e besimeve të tjera, ai i fut zakonisht në të njëjtin grup duke shfaqur kështu paragjykimet apo klishetë e kohës. Kurse sa i përket çështjeve ekonomike, autori na përcjell përshkrime mjaft interesante mbi organizimin e urdhrave të esnafëve, marrëdhëniet tregtare dhe aktivitetet

ekonomike të popujve të ndryshëm. Në rolin e antropologut, por dhe të historianit, Çelebi na ofron një libër, i cili mund të mos ketë saktësi shkencore, por është gjithsesi një minierë ari për studiues të fushave të ndryshme, të cilët, shpeshherë, e kanë analizuar pjesërisht për të nxjerrë të dhëna të vlefshme për çështjet që u interesonin.

“Seyahatname” konsiderohet si libri më i gjatë dhe më i plotë në llojin e vet, në perandorinë osmane dhe ndoshta në botë. Shkrimet e para të tij ishin në formë shënimesh të marra gjatë udhëtimeve nëpër Stamboll, në

të cilat përshkruheshin ndërtesat, tregjet, zakonet dhe kultura.

Udhëtimin e parë jashtë vendit Çelebi e bëri në vitin 1640. Mes rajoneve që ai vizitoi dhe përshkroi ishin Kaukazi, Lindja e Mesme, Bullgaria, Vllahia, Moldavia, Transilvania, Hungaria, Vjena, Serbia, Kroacia, Bosnja, Dalmacia, Shqipëria, Greqia, Rusia, Meka, Egjipti dhe Sudani. Në veprën e tij prej dhjetë volumesh, Shqipëria përmendet në volumnin e tetë ku ndër të tjera ai flet dhe për Greqinë, Stambollin dhe betejën e Kandias në Kretë ku Çelebi mori pjesë.



Figura 6. Harta e lumit Nil punuar nga Evlija Çelebi.

Literatura

Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<http://www.social-sciences-and-humanities.com/PDF/Biographies-of-Muslim-Scholars-and-Scientists.pdf>),

Dr. Muhammad Adil Afridi, Contribution of muslim scientists to the world: an overview of some selected fields

(http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution_of_Muslim_Scholars_to_the_world.pdf, <https://orientalizmi.wordpress.com/2011/12/21/evlija-celebi-ky-udhetar-i-madh-osman/>,

https://sq.wikipedia.org/wiki/Evliya_%C3%87elebiu,

<http://www.crystalinks.com/pirireis.html>),

Ibrahim YILMAZ, Turkey, The Kitab-ı Bahriye “Book of Navigation” of Piri Reis (https://www.fig.net/resources/proceedings/fig_proceedings/fig2012/papers/ts02k/TS02K_yilmaz_5687.pdf)

Profillet e Islam Dizdarit si pedagog, studiuues dhe qytetar shembullor

Prof. dr. Vehbi Hoti Prof. dr. Njazi Kazazi
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Ata ishin predikues dhe studiuues, hartues teksteesh dhe autorë botimesh, përkthyes, poetë e gjuhëtarë, leksikografë e etnografë, teologë e historianë të kulturës islame, mësues dhe edukatorë, organizatorë dhe drejtues të institucioneve fetare dhe arsimore. Secili është paraqitur me individualitetin e vet, por tre motive i bashkojnë në një synim e veprimtari të përbashkët: - besimi në Zot dhe devocioni e përkushtimi fetar, - dashuria e palëkundur për atdheun, - pasioni i thellë për dije dhe kulturë. Synimi madhor i jetës së tyre, siç e ka shprehur me shumë qartësi Sheuqet Muka, ka qenë që: “Myslimanet e Shqipërisë duhet të jenë ma të zhvilluemit e myslimanëve të botës, për arsye se janë të Europës. Prandaj ato duhet të shkojnë përpara për me u mbajtë si element i gjallë e perparimtarë në kërthizë të Europës”.

1. Hyrje:

Prof. Islam Dizdari (kështu e thërrisnin të gjithë) është një ndër “pionierët” e arsimit në rrethin e Shkodrës. Mësues, pedagog, drejtues shkolle dhe punonjës arsimit shembullor. **“Mësues i merituar”** (1993).

Nga të gjithë ata që e njohin,

ai vlerësohet si një shkodran me humor të hollë, për dashurinë ndaj profesionit dhe për shpirtin praktik të përhershëm, gjithnjë në kërkim të së mirës dhe të së resës.

2. Pak nga jeta:

U lind në qytetin e Shkodrës më 1934.

-Mbaroi shkollën pedagogjike “Shjenaze Juka” në vitet 1948-1952.

-Mbaroi Universitetin e Tiranës në Degën Gjuhë Shqipe-Letërsi në vitet 1954-1958.

Punësimi:

-Filloi punën në shkollën “10 Korriku” në vitin 1952 dhe vazhdoi si mësues e nëndrejtor në shkollën “7 Nëntori” (“Ismail Qemali”) në vitet 1952-1957.

-Zëvendësdrejtor në shkollën “Xheladin Fishta”, 1957-1961.

-Drejtor i Kabinetit Pedagogjik në Shkodër, 1961-1972.

-Pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik “Luigj Gurakuqi”, 1972-1984.

-Për shumë vite ka qenë anëtar i Këshillit Shkencor të ILP dhe sekretar i redaksisë së “Buletinit shkencor”, organ i këtij instituti.

-Mësues në shkollën pedagogjike “Shejnaze Juka”, 1984-1987.

-Pedagog i jashtëm në USH “Luigj Gurakuqi”, 1991-2005.

-Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, 1995-1999.

- Zëvendësdrejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Dega e Vajzave, 2004-2005.


-Gjatë viteve në drejtimin e Medresesë, të djemve dhe vajzave, ka udhëhequr me kompetencë shkencore punën mësimore- edukative në të gjitha drejtimet.

-Profesor Dizdari, i nderuar nga të gjithë, punoi me të njëjtin

përkushtim e devotshmëri dhe pati të njëjtin ritëm të lartë në punë në të gjitha klasat e shkollës 7-vjeçare, të mesme dhe deri në universitet.

3. Veprimtaria shkencore dhe botuese:

Profesor Dizdari është autor dhe bashkautor i shumë kumtimeve, referimeve e studimeve të botuara në organe të ndryshme (brenda dhe jashtë vendit); rreth 105 të tilla të botuara në organe të ndryshme si: “Arsimi popullor” (“Revista pedagogjike”), “Mësuesi” “Buletini shkencor i ILP” (Universiteti i Shkodrës “L. Gurakuqi”) “Shkolla fillore”, “Jeta e re”, “Pionieri”, “Zëri i rinisë”, almanaku “Shkodra”, “Shqiptarja e re”, “Nëntori”, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, “Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë”, “Drita e Dijes”, “Lemba”, “Univers”, Seminari Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj” (vite të ndryshme), “Perla”, “Edukata Islame”, “Etika” etj.



Duke kumtuar në Seminarin ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj” 2009

Po kështu është autor e bashkautor në shumë vepra , si më poshtë:

- **“Puna me ortografinë në shkollën fillore”** (së bashku me Faik Lulin). Tiranë, 1967.

- **“Këndimi dhe leximi në CU”** (Material metodik në ndihmë të mësuesve), në bashkëpunim me Faik Lulin, Tiranë, 1973.

- **“Gjuha shqipe”** (Material metodik në ndihmë të edukatoreve të kopshteve). Grup autorësh. Tiranë, 1973. U ribotua edhe më 1976.

- **“Gjuha shqipe-2”** (Libër ndihmës për mësuesit e CU të shkollës 8-vjeçare). (B/a. Faik Luli e Nimfa Jaço), Tiranë, 1986.

- Është bashkautor në botimin e librit: Universiteti i Tiranës **“Pedagogjia për shkollat e larta”**, Vëllimi I, 1985.

- Është bashkautor në botimin e librit: Universiteti i Tiranës **“Pedagogjia për shkollat e larta”** Vëllimi II, 1986.

- **“Metodika e gjuhës shqipe, Kl. I-IV të shkollës 8-vjeçare”**. (Grup autorësh: Safet Hoxha dhe Faik Luli). 1987, 106 faqe.

- Grup autorësh: **“Historia e arsimit në rrethin e Shkodrës”**, në dy vëllime, Shkodër, 1988.

- **“Metodologjia e mësimdhënies”** (Tekst universitar). Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2004. Faqe 200. (Në bashkëpunim me Prof. as. dr. Gëzim Dibrën).

4. Botime në fushën islame:


- **“Një jetë në shërbim të**

fesë”, (Për jetën dhe veprën e Haxhi Hafiz Sabri Koçit)- Monografi. (Me Faik Lulin). Tiranë, 1996, 351 faqe.

Pa u zgjatur autorët në pjesën e parë paraqesin jetën dhe veprimtarinë e H. Sabriut; në pjesën e dytë paraqiten intervistat që ka dhënë në organe të ndryshme; në pjesën e tretë fjalime, biseda, përshëndetje; në pjesën e katërt jepen vlerësime dhe përfundon me veprimtaritë që janë bërë për Hafiz Sabri Koçin.¹

Është redaktor dhe bashkautor në botimin **“Shefqet Muka-“Mësues i Popullit”, figurë e shquar atdhetare, arsimore dhe kulturore”** (Në bashkëpunim me Faik Lulin), Shkodër, 1997.

- **“Në kujtim të brezave”** (me bashkautorë: Faik Luli e Nexhmi Bushati). Shtypur në shtypshkronjën “Rozafat”, 688 faqe, Shkodër, 1997.



Me miqt e tij të punës Faik Luli, Nexhmi Bushati

Po paraqesim kumtimin e prof. dr. Vehbi Hotit mbajtur në

1. Marrë nga libri: “Faik Luli-Jeta dhe veprimtaria” i autorëve: I. Dizdari, Nj. Kazazi, I. Hoti, A. Mesi. Shkodër, 2006, f. 77-79.

veprimtarinë shkencore të organizuar në provimin e librit, maj 1998.

“Në kujtim të brezave” - (Një enciklopedi e kulturës islame dhe e jetës shpirtërore të popullit shqiptar), enciklopedi e cila duhet të ishte shkruar 50 vjet më parë, kur shumica e personazheve jetonin, kur librat dhe botimet e tyre mbushnin raftet e shtëpive të bibliotekave dhe institucionet fetare, që ato drejtonin, ishin ende në këmbë. Studimi “Në kujtim të brezave”, i përgatitur nga Faik Luli, Islam Dizdari dhe Nexhmi Bushati do të ishte quajtur rrjedhë e një pune normale në kushtet e normalitetit të jetës politike, qytetare dhe fetare.

Sot, për të arritur në këtë botim, për rrethanat që tashmë dihen, si dhe për shtrirjen kohore rreth 200 vjeçare të problemeve që trajtonin, mund të themi, pa e tepruar, se autorët kanë bërë një punë me të vërtetë shembullore, sa të bollshme e rraskapitëse, aq dhe dinjitoze e me vlera edukative e shkencore.

Të 40 personalitetet që paraqiten në këtë botim mishërojnë në mënyrë organike cilësitë atdhetare e fetare, shkencore e kulturore, arsimore e qytetare.

Ata ishin predikues dhe studiues, hartues tekstesh dhe autorë botimesh, përkthyes, poetë e gjuhëtarë, leksikografë e etnografë, teologë e historianë të kulturës islame, mësues dhe edukatorë, organizatorë dhe drejtues të institucioneve fetare

dhe arsimore. Secili është paraqitur me individualitetin e vet, por tre motive i bashkojnë në një synim e veprimtari të përbashkët: -besimi në Zot dhe devocioni e përkushtimi fetar, - dashuria e palëkundur për atdheun, - pasioni i thellë për dije dhe kulturë. Synimi madhor i jetës së tyre, siç e ka shprehur me shumë qartësi Sheuqet Muka, ka qenë që: *“Myslimanet e Shqipërisë duhet të jenë ma të zhvilluemit e myslimanëve të botës, për arsye se janë të Europës. Prandaj ato duhet të shkojnë përpara për me u mbajtë si element i gjallë e përparimtarë në kërthizë të Europës”*.

Secili nga intelektualët, klerik e jo klerik, që përfshihen në këtë botim, në mënyrën dhe stilin e vet, qe një krijues në prodhim, krijues në studim dhe në botim.

Parë në këndvështrimet e mësipërme, “Në kujtim të brezave” është një antologji e kulturës islame dhe e jetës shpirtërore të popullit shqiptar, veçanërisht të Shkodrës e të rrethinave të saj, me natyrën e një botimi enciklopedik të këtyre fushave. Njëherazi ai është edhe një bibliografi e pasur dhe një arkiv i gjallë ku studiues të fushave të ndryshme: të teologjisë, të historisë së kulturës islame e të historisë së arsimit, të gjuhësisë, të letërsisë e të folklorit, të tekstologjisë, të publicistikës, të historisë së Shqipërisë, etj., kanë një terren të gjerë e shumë të pasur studimi e hulumtimi.

Për këtë arsye, po ndalemi

në kontributet që kanë dhënë në fushën e studimeve, përkthimeve dhe botimeve për të përhapur fenë islame, si dhe për të zhvilluar kulturën e shkencën shqiptare, personalitete që me aq mjeshtëri na paraqiten nga autorët “Në kujtim të brezave”.

Një kontribut të shquar shënon zhvillimi në gjuhën shqipe i një letërsie me përmbajtje fetare islame, trajtimi i problemeve të filozofisë, të kulturës e të edukatës islame.

Një kolanë e plotë literature lindi dhe u frymëzua nga personaliteti i Profetit (a.s.), jeta, veprimtaria, këshillat e porositë e tij. Mbi këtë bazë u hartuan dhe u botuan mevlude, hadithe dhe ilahi.

Gurin e parë në krijimin e traditës shqiptare në këtë fushë e hodhi H. Ali Ulqinaku.

Në vitin 1873, duke përkthyer nga turqishtja në shqip me alfabet arab mevludin me titull “*Përkthimi i Mevludit në gjuhën shqipe*”, i cili, së bashku me përkthime të vargjeve filozofike e të disa njohurive fetare, u botua në një libër të vetëm në Stamboll në vitin 1887. Është një përkthim me mjaft shtesa, përpunime e vargje origjinale të H. Ali Ulqinakut, i ribotuar me alfabetin e sotëm të shqipes, në vitin 1936, me titull “*Mevludi Sherif*”, ai këndohej në xhami e në shtëpi. Mevludi i H. Ali Ulqinakut u përfshi në botimin “*Pesë Mevlude në gjuhën shqipe*”, botuar më 1991 në SHBA nga Imam Vehbi Ismaili. Edhe Sheh Ahmet Shkodra

botoi një Mevlud, fillimisht me alfabet arab, më 1926 e riboton me alfabet latin, duke u pasuar nga një botim i tretë i ripunuar dhe i lehtësuar nga orientalizmat, më 1980 në Nju Jork.

U bënë disa përkthime të Sures Jasin nga Kur’ani, në tre raste të caktuara edhe me komente (Sh. Muka, E. Myftia) si dhe disa botime të Haditheve të Pejgamberit (E. Myftia, V. Ismaili).

Në hartimin e Ilahive, vjersha me përmbajtje fetare, shpesh të gërshetuara edhe me tematika atdhetare e politiko-qytetare u shqua në mënyrë të veçantë Sheh A. Shkodra me botimet “Drita e gjithësisë”, “Zani i Dërvishëve”, “Këshilli i Atdheut”, etj. Ndër këto ilahi me ndenja të thella atdhetare bënte thirrje:

*“Pse nuk jena një me fe /
Jena vllazën për atdhe /
...Sille komvedin mbarë /
Banu atdhetare /
Puno për kombesi /
besim dhe liri /.*

Një vend qendror “Në kujtim të brezave” e zë kontributi i personaliteteve të shquara, me studime, botime origjinale e me përkthime, rreth filozofisë edhe bazave të Islamit, të historisë së fesë islame dhe të përhapjes së tij ndër shqiptarët.

Këtu mund të radhisim:

“Shkurtorja e historise islame marrur prej autoreve të përmendur” dhe “Shkodra dhe motet” (H. Bushati), “Shtyllat themelore të tarikatit Tixhani” (H. Tahsini), broshura polemizuese “A duhet feja? A e pengon bashkimin kombetar” (H. Ali Tari), 10 klerat e Imam Vehbi Ismailit “Islamizmi dhe lutjet”, “Muhamedi – Profeti islam”, “*Muhamedi – Profeti i fundit*”, “*Studime islame*”, “*Një tufë lule – tregime nga historia islame*”, “*Dritë nga Kur’an-i*”, “*Imeri pranon fenë islame*”, “*Bilali – muezini i Profetit a.s.*”, etj.

Apo botimet e H. Vehbi Gavoçit si “*Si dhe pse*”, “*Parimet e islamizmit*”, “*Jeta e Profetit Muhamed*”, “*Shtyllat e besimit*”, “*Hallalli dhe Harami*”, “*Ninimi i muajit të Ramazanit*”, “*Shtyllat e islamizmit*” etj.

Kësaj tematike iu kushtua një veprimtari shumë e gjerë me përkthime në gjuhën shqipe si përmbledhja: “*Njeriu islam*” (I. Bulaj), “*Një pyetje dijetareve myslimanë dhe përgjigjia e Abdullah Guilhamit*” (H. Bushati), broshurat e përkthyer nga V. Ismaili: “*Feja islame*”, “*Në skajet e historisë*”, “*Muhamedi – Profeti njeri*”, “*Banorët e shpellës*”, “*Tregime nga feja islame*”, “*Muhamedi (a.s.)*”, “*Mrekullia e madhe*”, vepra të përkthyer e të përgatitura për botim nga I. Muçej: “*Feja dhe misioni i saj*”, “*Pse përqafova islamit*”, “*Pobime të një spiuni anglez*”, “*Rendi i ri i historisë*” dhe “*Si arriti Kur’an-i deri në ditët tona*”.

Për t’i dhënë shtytje zhvillimit kulturor e arsimor të besimtarëve

dhe për t’i hapur udhë në mënyrë graduale futjes së shqipes në liturgjinë islame, personalitetet e përfaqësuara në “Në kujtim të brezave” punuan me shumë përkushtim për hartimin, përkthimin, apo përshtatjen e alfabeve, abetareve, gramatikave e teksteve mësimore.

Kësaj fushe i paraprin botimi më 1861 i veprës “*Alfabet shqip*” me shkronja turqishte nga Daut Boriçi me synimin që të ndihmonte shqiptarët për të mësuar gjuhën shqipe. Pas ribotimit në vitin 1869, D. Boriçi hartoi “*Abetare shqip*” të ndryshuar nga botimi i parë, ku u shpalos synimi i tij me fjalët: “*.. shqiptari, me menyren e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, brenda pak kohe mundet me shkruë në gjuhën e vet*”. Më 1881 D. Boriçi harton një version të ri të veprës “*Abetare shqipe*”, me mjaft ndryshime nga të mëparshmet. Gjithashtu ai la në dorëshkrim një “*Gramatikë shqipe*”, me njohuri të përgjithshme mbi emrin, numrin, gjininë, etj. Me këto synime edhe H. Ali Ulqinaku hartoi një abetare shqipe me shkronja arabe; mbi bazën e një alfabeti që e krijoi vetë me 40 shkronja nga të cilat 30 bashkëtingëllore dhe 10 zanore; të shoqëruara me ushtrime për praktikimin e tyre. Vite më vonë, më 1916, Sh. Muka do të na lejë në dorëshkrim “*Abetare për të vegjël*” me 30 mësimet për gjuhën shqipe, shkruar me alfabetin e Kongresit të Manastirit.

Pas shpalljes së Pavarësisë, me krijimin e strukturave të Komitetit Mysliman, lindi nevoja e hartimit të teksteve, të mësimit të besimit për nxënësit e shkollave.

Ndër të parët që hodhën hapin në këtë lëmë qe Sheuqet Muka, i cili në periudhën 1923-1927 hartoi e botoi tre tekste të tilla (Ilmihal). Njëri prej tyre “*Dijeni praktike besimtare*” ishte jo vetëm për nxënës të shkollës fillore, por edhe për mosha më të mëdha, që nuk ndiqnin shkollat. Vlerë të veçantë shkencore-pedagogjike ka punimi i tij, i bërë më 1920 “*Pasqyra e nxanesit*”, ku Sh. Muka, parashtron idetë e tij mbi rëndësinë e të mësuarit gjatë tërë jetës, mbi disiplinën shkollore, mbi rëndësinë e moralit dhe të formimit të ndërgjegjes së fëmijëve.

Me erudicionin e tij të njohur, Esat Efendi Myftia, hartoi tekstin shkollor “*Historia e shenjtë islame*”.

Mësimeve të arabishtes në shkollat fetare në vendin tonë i shërbeu botimi dhe ribotimi disa herë i “*Abetares se gjuhës arabe*” të hartuar nga H. Tahsini.

Një tjetër kontribut në drejtimin studimor e shkencor e përbën hartimi i fjalorëve dhe i metodave të studimit të gjuhëve të huaja. “*Fjalori turqisht-shqip*” me autor D. Boriçin, që ruhet në dorëshkrim në Arkivin e Shtetit, pasohet nga tre fjalorë të hartuar nga H. Ali Ulqinaku: të parin *turqisht-shqip* në vargje, të dytin *shqip-turqisht* me rend alfabetik dhe të tretin, po

me këtë kriter, *shqip-turqisht*.

Të tre fjalorët e H. Ali Ulqinakut kanë 1334 faqe ku vetëm fjalori i tretë ka 9021 fjalë. Kësaj fushe i kushtoi mjaft mund e djersë edhe Esat E. Myftia, i cili hartoi tre fjalorë doracakë arabisht-shqip, frëngjisht-arabisht dhe fjalë ndërkombëtare - shqip, përpiloi një metodë për mësimin e arabishtes dhe bëri studime për terma arabisht, turqisht e persisht, që kanë hyrë në gjuhën shqipe.

Me një punë këmbëngulëse, 20 vjeçare, Ismail H. Muçej ka hartuar dy fjalorë:

Arabisht-shqip me 45.000 fjalë e 20.000 shprehje, si dhe shqip-arabisht me 25.000 fjalë e 30.000 shprehje, të cilët po të gjejnë rrugën e botimit arrijnë në 3300 faqe libri.

Përveç këtyre dy fjalorëve, I. H. Muçej ka përkthyer nga gjermanishtja një metodë për të mësuar gjuhën arabe duke u mbështetur në kriteret didaktike e pedagogjike.

Kontribut me vlerë paraqesin publicistika dhe përkthimet me karakter fetar, politiko-shoqëror, historik, edukativ, gjuhësor, moral, etj. Në këtë kuadër, duhen vlerësuar në mënyrë të veçantë përpjekjet e bëra për t’i dhënë besimtarëve myslimanë Kur’an-in në gjuhën shqipe, për të cilin një meritë të veçantë kanë: H. H. Ibrahim Kaduku, Hasan Tahsini dhe Jonuz Bula(e)j.

Vlen të theksohet fakti se H. Sheh Shamia ka bërë një përkthim

në frëngjisht të KUR'AN-it, në vitet kur ai jetonte në Francë.

“Në kujtim të brezave” ka personalitete me kontribute aq të gjera e të shumanshme në fushën e studimeve, të përkthimeve, të krijimeve e të botimeve sa mund të themi se, puna e tyre, normalisht, mbulon veprimtarinë e një sektori shkencor. Mjafton të ndalemi pak më gjerë siç kemi thënë, te puna e realizuar nga *Hamdi Bushati* dhe *Tahir Dizdari*.

Krahas veprës madhore “Shkodra dhe motet” dhe mbi “Bushatllinjte”, H. Bushati la në dorëshkrim studimet: “Mbi zakonet e jetës shoqërore të tre besimeve në Shkodër”, “Gjendja arsimore e Shqipërisë nën pushtimin turk”, “Vështrim historik mbi përhapjen e feve e veçanërisht të islamizmit në Shqipëri”.

Ai ka realizuar edhe mjaft përkthime me tematika historike, kulturore e fetare si: Jetëshkrimet mbi vezirin Abedin P. Dibra e ministrin e luftës Rexhep P. Matja, materiale të panjohura për P. Vasën e I. Qemalin, një pjesë e mirë të krijimtarisë së S. Frashërit, ndër të cilat broshurat: “Gratë”, “Njeriu”, “Qytetërimi islam”, “Mithet”, “Qielli”, “Toka”, vepra “Psikologjia” e Hasan Tahsinit, punimet: “Ngjarje në Prizren”, “Shkaqet e ngjarjeve të Lumës”, “Kryengritja e malësorëve të Shkodrës”, “Dokumente mbi luftën e Ulqinit e mbrojtjen e

Shkodrës (1912 – 1913)”, “Kanunet e Malësisë”, etj.

Po kështu studiuesi Tahir N. Dizdari, pas studimeve të para mbi problemet e organizimit e të funksionimit të pushtetit lokal në periudhën e paraçlirimit dhe të angazhimeve në publicistikë, i hyri një pune të gjerë dhe të thellë studimi dhe botimi në fushat e etnografisë, leksikografisë, gjuhësisë, folklorit, etj., duke na lënë trashëgimi veprat madhore: “Orientalizmat në gjuhën shqipe” dhe “Fjalë të pa mbledhura nga fjalorët e deritanishëm”, “Studimet”, “Kraja” dhe “Katër Balet”, 800 faqe me këngë popullore, gjëegjëza, fjalë të urta, toponime të mbledhura me shumë kujdes për vite të tëra.

Siç shihet, autorët e zellshëm e të palodhur F. Luli, I. Dizdari dhe N. Bushati, nëpërmjet librit “Në kujtim të brezave” i japin jetë një trashëgimie shumë të çmuar në fushën e studimeve dhe të botimeve, të kulturës islame dhe të kulturës kombëtare shqiptare. Vepra e tyre na kumton një mesazh madhor. Intelektualët e shquar që ata na paraqesin me tërë jetën dhe veprimtarinë e tyre mishëruan porosinë profetike: **“Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr”**.

(Prof. dr. Vehbi HOTI, Dekani Fakulteti i Ciklit të Ulët, Universiteti i Shkodrës “L. Gurakuqi”)

- **“Vehbi Ismaili”**, SHBA, 1997. (Në bashkëpunim me Faik Lulin).

- **“Mevludet në gjuhën shqipe”**, Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002, 712 faqe. (Në bashkëpunim me Faik Lulin).

Prej kohësh lexuesit shqiptarë kanë në dorë një vepër enciklopedike të vëllimshme (rreth 700 faqesh), me vlera të gjithanshme: atdhetare, islame, kulturore, shkencore, historike dhe edukative. *“Mevludet në gjuhën shqipe”* është produkt i punës plot pasion, vullnetit të paepur dhe mendimit shkencor të dy autorëve, prej kohësh të njohur në fushën e shkencës, arsimit dhe kulturës shqiptare Faik Luli dhe Islam Dizdari. Pas një bashkëpunimi të frytshëm, dalin para auditorit shkencor dhe më gjerë me këtë botim gjithëpërfshirës, i pari në llojin e vet kaq i kompletuar, monografik-antologjik, me përmasa enciklopedike duke i bërë *“...një shërbim madhështor literaturës fetare islame në veçanti dhe asaj shqiptare në përgjithësi?”*. Nuk duam të zgjatemi, por theksojmë se në historikun e Mevludeve mësojmë se në *“...botën islame filluan të paraqiten që në shek. X theksojnë autorët në librin e tyre”*. Numri i mevludeve në turqisht e veprave në lidhje me to, arrin në rreth 200 dhe i autorëve 60 në gjuhën turke.

Në vazhdim paraqesim autorët e 20 mevludeve shqiptare, si: Hasan Zyko Kamberi, Ismail Floqi, Hafiz Ali Ulqinaku, Tahir Efendi Popova, Mevludi Çam, Hafiz Islam Çelebiu-Nekofci, Mehmet Ef. Saliu, Hafiz Ali Korça, Shefki Hoxha, Hafiz Abulla

Zëmbllaku, Sheh Ahmet Shkodra etj.²

Komisioni i Psikologjisë dhe i Pedagogjisë, ILP, Shkodër, 1974



- **“Hafiz Ali Ulqinaku” (Jeta dhe vepra)**. Prishtinë, 2005. 476 faqe. (Në bashkëpunim me Faik Lulin).

- **“Faik Luli - Jeta dhe veprimtaria” (Monografi)** Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”. 220 faqe. (B/a. me Njazi Kazazin, Irida Hotin, Anila Mesin). Shkodër, 2006.

4. Përfundime:

Prof. Dizdari ka zënë një vend të merituar në **“Fjalorin Enciklopedik të hapësirës Shkodrane-1”** të autores Dr. Zenepe Dibra³.

Profesor Islami ishte pedagog i shkëlqyer, *që hap pas hapi*, u shqua mes kolegësh duke arritur shkallë të larta të formimit gjuhësor dhe letrar të studentëve në të gjitha fushat e dijes. Ai përmendet si historian i

2. Shih më gjatë në revistën “UNIVERS”: Prof. dr. Njazi Kazazi në Nr. 11, 2009, f. 158-167.

3. Dr. Zenepe Dibra, EBP “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2015, f. 299-300.

arsimit në Shkodër, e më gjerë, por edhe bibliograf, redaktor, lektor, etj. Tek ai janë të kombinuara bukuria shpirtërore me atë fizike.

Po ta shohim punën e Prof. Dizdarit, (siç është theksuar edhe kur kemi botuar shkrimin për “Doctor Honoris Causa” dhe “Mësuesin e Popullit”⁴) ajo është e pandarë

nga bashkëpunimi me mikun dhe bashkëpunëtorin e tij Z. Luli, me të cilin duken kurdoherë bashkë “*si vëllezërit siamezë*” nga bashkëkohësia e vlerave, interesave intelektuale, studimore e shkencore dhe botuese.

Profesor Islami është njohës dhe vlerësues i kulturave të ndryshme të Lindjes dhe Perëndimit.

4. Faik Luli, botuar në revistën “Mësuesi”,

nr. 5, viti 2015, f. 28-29.

Zoti dhe Evoluzioni

Atheizma e thiesht, e cila mohon Zotin, asht një fenomen i rrallë edhe gjithmon ka me qenë kështu. Porse atheizma e asaj lloje, e cila e len Zotin jashta mejtimit të saj per boten, është shumë ma e zakonshme. Ka shumë teorina per gjithësin (universin) që e lanë jashta Zotin. Tashi un tue folun per atheizmen dhe teorin e saj per universin, due të them atë lloj atheizme, e cila në mënyren e mejtimit të saj len jasht edhe nuk njëf një *Qenie* sypreme e perfekte (e plotësue), e cila asht pa kufi e ditsheme, shenjte edhe e mirë; atë lloj atheizmi, i cili nuk di ndonji gja per një Zot personal i vehte-ditshem, i cili asht mbi të gjitha, neper të gjitha dhe në të gjitha, por se kujton një gja (Zot) që nuk asht as arbitrar, gjakmares, i keq, as indiferent më

të miren e krijatyrave të Tij; por se don gjith të mirët e të keqijt; të shenjtet e fajtoret; të mençëmit e të marët. Atheizmi duhet të kujtonj se universi ka ekzistue gjithmonë. Universi *ose ka qenë i krijuem* prej një qenjeje ma të madhe se vehtja e saj, *ose e ka ba vehten vet* ose *ka qenë gjithmonë kështu*. Tashi, tue qenë se atheisti mohon se universi është bā prej një qenjeje ma të madhe, atëhere pika e parë mbetet jashta pyetjes. Por se ai (universi) vehten s’ mundet t’ a ket bā, se per me e bā vehten lypset të ket eksistue edhe se per m’ u bā prej vehte-vehtes duhet të ket qenë e pa eksistueshme. Pra si kunder që shifet kjo teori kujton, në të njajten ças se bota qe edhe nuk qe e prandaj asht në kontradiksion (kundrshtim). Atëhere pra mbetet alternativa e tretë d. m. th. që bota gjithmonë ka

qenë edhe kete e mbesojnë (aq sa e di un) tanë atheistat. Kemi me pa se ç' riedh prej kësaj.

Atheisti, atëhere, shikon në gjithësin edhe thot «Nuk ka Zot» «Nuk ka fuqi sypreme; as presencë universale; as *Qenie* të plotësuese e të pa kufijshme që të jetë inteligjente, mirëdashës, vehte-ditshëm dhe e lirë. Ka shumë gjana që janë të caktueme (finiti), por nuk ka *Qenie* infinite. Ka një numur të math krijatyrash finite, por se as një plotësim (perfeksion) nuk duket kund. Bota nuk u krijue, ajo ka ekzistue gjithmonë. Zotni nuk e bani ate, ajo s' mund ta bante vehten e prandaj ka qenë gjithmonë». Kjo është teoria themelore e atheizmit.

Na shohim ndërime që po vashdojnë në gjithësin. Shikojme tokën edhe kete e gjemë shumë të ndryshme nga çka ka qenë miljona vjet perpara. Ka qenë një kohë kur kontinentet e sotme qenë nën oqeanet; koha tjera kur ata qenë të mbulueme prej sasinave të mëdha të akujve; koha, shumë ma perpara, globi i ynë qe një lang i ziartë edhe perpara ketyne kur ai qe një gaz djegës, mijra herë më e madhe në vëllim nga ç' asht sot. Atëhere, në qoftë se nuk ka Zot, ç' fuqi e pruni tokën nëpër gjith keto ndryshime?

Atheisti pergjigjet «Natyra». Po, natyra asht një fjalë, çdo me thanë ajo? Atheisti prap pergjigjet: «digi i shvillimit (evolusionit)». Toka asht shvillue, me anën e ligjeve të natyrës, prej gazit të ziartë në një

lang të shkrim, prej ketij në një trup të zhytun në fund të oqeanit të ujit, prej ketij në kontinente të ngrime edhe ma së fundi prej ndrimeve të ndryshme n' atë që na shofim sot d. m. th. shtazët bimët dhe mineralet edhe të gjitha këto, per ritjen e tyre, të pështatuna me klime, toke, ajr, uj dhe ushqime. «Gjith keto i bani shvillim» thotë atheisti.

Psalmisti pyet, «Ai që bani veshin, a nuk do të ndigjojë? Ai që formoj synin, a nuk do të shofi? Ai që mesojn njerin, a nuk do të dijë?» «As me no një mënyrë» pergjigjet Atheisti. «Në kete rasë më i vogëli ka prodhue më të madhin; ketu *shkak* asht më i vogël se *efekti*. Fuqija q' e bani njerin një qenie të vehte-dijsheme, racional dhe të zotin per dituni, ajo vet nuk di kurgja edhe se vepron verbenisht e me pa vet-dijshmeni. Fuqija q' e bani njerin të zotin per shpirtmadhesi (generozitet), dashuni, kurajoz, idealist, me besim dhe shpresë, ajo vet asht e pa zonja m'i marrë vesht keto ndjeshmenija (sentimente). Fuqija q' e bani njerin të lirë, dhe të zotin per virtyte; ajo vet është e lidhun fort me ligjet e natyrës dhe vepron prej një nevoje mekanike e kimike edhe prandaj nuk është e zonja per vitute dhe mirësi». Në rastet tjera, si kunder që dihet prej të gjithve ma i madhin bân më të voglin, por kurrë ma i vogli më të madhin. Njeriu mund të baje një maqinë që të kendojë pro si një zog, por një zog s' mund të baje një maqinë që të

këndoje si një njeri. Njeriu mund të bajë një çekiç që punon me avull i cili mung të baje një të goditur me 20 tone fuqi, por gjith ashtu mund të api një të goditur që të jet e miaftueshme për me thye një arë. Por çekiçi s' mund të baje njëriun. Atheisti thotë «Sa për veshin që është bënë me ndigjue dhe synin me pa, është krejt gabim, se ndermjet miljona kriatyrave, njera *ndodhi* të lindi me një nervë optike, damar i ndijshem për dritë edhe kjo i dha rasë asaj të ketë një avantazhe në *luftën për ekzistencë* (jetë), kështu që shtazët pa sy u zhduken kurse pjellat e saja mbetën. Gjith kështu edhe veshi është një pjesë famirësije. Psalmisti kur tha se Zoti bënë veshin dhe synin, ai nuk pat lezue teorinë e Darvinit (teorinë e evolucionit). Po ta kish lezue kete ai do ta dinte se veshi dhe syni nuk u bënë me qellim, por se u shvilluen aksidentalisht».

Kështu flet miku i yn, atheisti, tue thanë, ndersa ai imazhinon, fjalët e fundit të shqences. Por edhe në qoftë se pranojmë krejt ç' thotë teorija e Z. Darvinit, vendin e Krijusit as pak nuk mundemi me e zanë. Le të pranojmë se syni, veshi, dora dhe gjith organizacioni trupor, kanë qenë shvillue prej një selules (qelizës) orgjinale, po kush e bani ketë prej të ciles të tana do të shvillohen? Në nebulen e parë kush e vuri ligjin e evolucionit, kështu që prej saj nevoisht të shvillohet ky kosmos (qainat) i bukur, i çudishem dhe i fuqishmë? As një teori nga ato

qi tregojnë se qysh u bënë bota, nuk mundet t' i pergjigjet pyetjes, *kush e bëni ate?* Kjo mbet për m' u zgjidhë; është siç ka qenë përpara.

Zhvillimi nuk do të thotë një fuqi ose shkak; ai është vetem një proces. Na themi se në një bimë trupi i saj është çpulosun ose zhvillue prej farës, gjetet prej trupit, luleja prej burbuqes, dhe fruti prej lules. Ky është zhvillim d. m. th. mënyra në të cilën një pjesë është çpalue prej tjetrës aji nuk është një shkak, po është vetëm një method, një proces. Kur të kemi thënë se dhe është siç është sot, që zhvillue prej gazit, na nuk kemi thanë gjë për shkakun e këtij fenomeni por vetëm kemi përshkrue procesin. Një *shkak* i math dhe i mrekullushëm rrin prapa atij. Një fuqi e ka bënë tan ate, ç' është ajo Fuqi? Me thanë natyra, ligji ose evolucionit është thiesht përshkrimi si ndodhi dhe kjo nuk na aferon as një çap afer shkakut. Kur një njeri thotë se toka u bënë në gjendjen e sotme me anën e zhvillimit, ai flet pors kalamajtë, të cilët kujtojnë të kenë spjegue lëvizjet e kukllave – automaton tue thanë «ato punojnë si maqinat e sahatit».

Po le të pranojmë, për hatër të argumentit, se në gjithësinë ka një fuqi ose fuqina misterioze, të mshehuna në landën, që kanë shkaktue zhvillimin e gazit të zjartë në një botë të banushme. Këto fuqina lypse të kenë eksistue gjithmonë; se në qoftë se që një kohe, ku nuk pat të këtillë fuqije në landë, me qenë se

nuk qe ndonji fuqi me krijue ate, ajo lypset të ket krijue vet-vehten, gjà qi asht e pa mundshme. Porse ajo nuk ka eksistue gjithmonë, se zhvillimi, tue vazhdue për gjith here, më së fundi to të prodhonte një Qenie infinite e të plotësue, d. m. th. një Zot, gjà qi asht në kundërshtim me hipotezën e atheistit. Tashi Atheisti është i lidhun prej kësaj dilemes d. m. th. ai a lypse me mohue që ky *princip* (fill) aktiv i zhvillimit gjendet

brenda më gjithësin materjale; ose lypset të pranojë qi ka eksistue n' atë gjithnji. Në qoftë se thot ka qenë gjithmonë, ai duhet, në kohë infinit të ket zhvillue një qenie infinite dhe perfekt. Prandaj ai duhet të heqi dorë nga theoriya e evolusionit ose duhet të pranojë eksistencën e Zotit.¹

1. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 3, viti XI, mars 1936, f. 86-90.

Abstracts in English

Islamic Sciences

1. Soul diseases and their treatment according Ghazali

Dr. Milud Hamidat

Department of Psychology and Educational Sciences

Laghouat University – Algeria

Abstract

Among the fundamental causes of mental illnesses or heart diseases - as Ghazali calls them - is the conflict between the forces of good and those of evil; between reason and instinct; between the need for pleasure and of looking for it. Parallel to this, is the feeling of guilt when one obeys the body instinct and goes beyond the reason. Just from this point stress, tension, rage, aggression, fear and revenge arise. Behavior suffers disorder after the above emotions start to manifest. While repeating they become a habit and custom, which can lead to other types of behavior that many have a deeper impact in the human soul.

Studies

2. The Earliest Records in Albanian Folk Music (ca. 1650).

Prof. dr. Bardhyl Demiraj, Germany

Abstract

The subject of this paper are three Albanian folk songs as part of the script heritage of musicologist 'Alī Ufkī (1610-1677 ?), which the good-known researcher of oriental musical art Judith Haug has recently investigated and evaluated as not identifiable although for any of them she was convinced that had to be Albanian, due to the fact of the nomination of one song as such <ARNAV. TURKI.> (= /Arnaut. Turki./) The aim of our paper is as simple as significant. It is precisely the philological processing and the critical edition of the material in Albanian, indicated by Judith Haug, who was very interested in the content of these songs. The result of this chain reaction is very important: new memorials will now be added to the heritage of Albanian culture, because: a) these are the earliest records of the

Albanian Folk Music – (ca. 1650 !) and b) these three songs are brought with the relevant text in Albanian and musical notation.

3. Revealed message – exalted language

Fatos A. Kopliku MS/MA, Washington DC

Abstract

If we remember the Italian cliché traduttore traditore (translator traitor), it reminds us of the impossibility of the perfect translation of any text, let alone of a sacred text with layered meanings. The scholar A. J. Arberry did rightly call his translation of the Qur'an 'interpretation' - Koran Interpreted - and this is what he says in his introduction: "the rhetoric and rhythm of the Arabic of the Koran are so characteristic, so powerful, so highly emotive, that any version whatsoever is bound in the nature of things to be but a poor copy of the glittering splendour of the original." This doesn't mean that the Qur'an should be translated in other languages - actually quite the opposite - but it is a must that the translators should have impeccable knowledge of the language of the Qur'an and of the language that is being translated to, of the very rich tradition of the commentaries, of the nuances and context of words and verses, while one should always be mindful that "all translations are ultimately only approaches".

Islamic jurisprudence

4. A glance at Islamic legal family

Legal-juridical aspects on protection of property rights

Prof. asoc. doc. dr. Engjëll Likmeta

Qemal Likmeta

Abstract

Legislation is one of the most important foundations of the Islamic legal family. Islamic law has to do with putting into practice the message of Islam that aims justice and peace, regardless of place or time in which we live. The essence of the Islamic message is love and purity, building bridges of free and respectful dialogue among the messengers of God and their opposites in religion. Islam, in itself, is a free, moral and logical dialogue, which among other things commands for discontinuing the criminal actions in any aspect of life, by rightfully recognizing that "There is no compulsion in religion." Therefore, from a point of view is more difficult to be a Muslim; it requires much responsibility, as well as delicacy and elevation, because in addition to social principles such as respect, love and understanding, compassion and tenderness is needed; along with patience and tolerance are required knowledge, will, wisdom, balance and synthesis of creative skills.

Pedagogy

5. Pedagogical ideas in literary creativity and practical activity of Mehmet Akif Ersoy

Prof. dr. Musa Kraja

Abstract

Educational goals of Mehmet Akif on morality and family, especially in terms of virtue, etc., recall one of the main areas aimed by the well-known German teacher Herbart, whose pedagogical views although more than two centuries old, penetrated later to us in Albania, during the years 1920-1937, when his ideas became too dominant in our education system, because those were brought here by our students coming from Austria. Insisting at patriotic education of the new generations, he wider elaborated this issue stressing at morality, by maintaining it sound and through it, starting from the society foundations - the family - as its very important part. A sound and well-functioning of this basic cell of society, will definitely lead us to patriotism in a broader and concrete sense. Mehmet Akif loved and fought for his country Turkey, as well as he felt and tried in every way to feed this love for Albania, and he stated unequivocally being an Albanian, both orally and in his writing, especially in his poems.

Literature

6. Religious aspect (with Islamic emphasis) in poetry

Poetry - a path to the soul

Msc. Entela Hidri

Journalist / Institute of Islamic Studies, Peace TV

*“I swear by the pen and what they write”
Qur’an, 68:1*

Abstract

Poetry is one of the most beautiful kinds of literature and art of the word. The emphasis on the religious aspect is of particular importance to me, because it gives another priority to the poetry. Handling the poetic creation as a reflection of God’s creation, gives a mystic and spiritual value to this poetry. Quality of poetry as text lies on its effects in all dimensions of life. Therefore, poetry deals every subject and every area of thought. It is one of the most difficult types and elevating ranks of writing.

Poetry finds a way for accessing the soul. Through the mystics, it approaches to the creation of the Master Himself, not to compare with Him, but to glorify the Creator and His universal and unique creation. The beauty of the poetic word does not come by itself, and right here the mystic does consist. This kind of poetry has all the structural elements of poetry from literary figuration, rhythm; rhyme to every detail ... The mystical element gives

it an added value. And exactly this literary stream which gave priority to the addressing the thematic and mystic-religious element was the doggerelists literature. The themes of this kind of poetry range from topics about God, morality, ethics, human respect, etc.

Welfare of an aesthetic world of poetry based on elements of Islamic religious mysticism, had a special value both in social and artistic terms. Yet to be reviewed other types of creativities that evaluate and use the religious element.

History

7. The contribution of Piri Reis and Evliya Çelebi to the science of geography

Msc. Artan S. Mehmeti

Abstract

During his life Piri Reis gave a great contribution to the science of geography and cartography. In modern times he is known for his maps and graphs, which have been published in the book "Kitab-ı Bahriye." This book also contains detailed information on navigation, as well as many accurate graphics (for their time), describing the important ports and cities in the Mediterranean Sea. He gained fame as a cartographer, where a small part of his world map (work in 1513), was discovered in 1932 at the Topkapi Palace in Istanbul. His world map is the oldest map in Turkish atlases which displays the New World. This map is also one of the oldest maps of America which still exists somewhere (the oldest map of America that still exists today, is the map worked by Juan de la Cosa in 1500, which is stored in the Maritime Museum (Museo Naval) of Madrid, Spain). His maps are focused on Sahara desert and the Tropic of Cancer.

Personalities

8. Islam Dizdari profile as a lecturer, researcher and exemplary citizen

Prof. dr. Vehbi Hoti, Prof. dr. Njazi Kazazi

University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"

Abstract

They were preachers and scholars, texts drafters and publications authors, translators, poets and linguists, lexicographers and ethnographers, theologians and historians of Islamic culture, teachers and educators, organizers and leaders of religious and educational institutions. Each of them is presented with his own individuality, but three reasons unite them in a common goal of activities: - faith in God and devotion of religious commitment - unshakable love for their country - deep passion for knowledge and culture. The major goal of their life - as clearly expressed by Sheuqet Muka - was that: "Muslims of Albania should be the most developed Muslims of the world, because they are in Europe. Therefore,

they should go ahead in order to consider as a lively and progressive element in the heart of Europe.”

Retrospective

9. God and evolution

The mere atheism which denies God, it is a rare phenomenon and it always will be such. But that kind of atheism, which leaves God out of its view on the world, is far more common. There are many theories on universe which leave the God aside. Now, talking on atheism and its theory of universe, I would mention that type of atheism which in his viewpoint leaves aside and don't recognizes a supreme and perfect (complete) Being, which is unlimitedly knowledgeable, divine and good; that kind of atheism which don't recognizes anything as a all-knowing God which is above everything, at everything and in everything and don't remember something (a God) which is neither arbitrary, nor bloody, evil or indifferent to his creatures, but which loves all people: good and evil, saints and sinners, wise and fools. Atheists think that the universe has always existed. Universe either has been created by something greater than it, or has created itself, or has always been such. Now, giving that atheist deny that the universe has been created by a being greater than it, the first point of hypothesis remain out of discussion. But the universe either cannot have created itself, for it must have existed before in order to do this or it must have been non-existent. Thus, this theory asserts that the universe has existed and has not existed at the same time, which is a logical contradiction. Therefore, the third hypothesis according which the universe has always existed is considered the most reliable by the atheists (and as I know, all atheists learn this version). Let's see what stems from this idea.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtreron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.